



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Numër | 03  
Dhjetor 2012



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 3

**BOTUES** © Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike  
33 Garibaldi, Prishtinë 10 000  
Tel: ++381 38 222 055  
Fax: ++381 38 243 763

**Faqja e internetit** [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Adresa elektronike** [economicanalysis@bqk-kos.org](mailto:economicanalysis@bqk-kos.org)

**KRYEREDAKTOR** Gani GËRGURI

**REDAKTOR** Arben MUSTAFA

**AUTORËT** Zana GJOCAJ  
Albulenë KASTRATI  
Bejtush KIÇMARI  
Krenare MALOKU  
Mimoza MUSTAFA

**REDAKTOR TEKNIK** Butrint BOJAJ

**SHKURTESAT:**

AJN	Asetet e Jashtme Neto
ATM	Bankomatë (anglisht: Automated Teller Machines)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (anglisht: Capital Adequacy Ratio)
CIS	Commonwealth of Independent States
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (anglisht: European Bank for Reconstruction and Development)
ECB	Banka Qendrore Evropiane (anglisht: European Central Bank)
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MEF	Ministria e Financave
NIM	Margjina Neto e Interesit (anglisht: Net Interest Margin: NIM)
NPL	Kreditë joperformuese (anglisht: Non-Performing Loans)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
pp	Pikë Përqindje
POS	Pika të Shitjes (anglisht: Point of Sales)
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
OECD	Organizata për Bashkpunim Ekonomik dhe Zhvillim (anglisht: Organization for Economic Cooperation and Development)
OJSHEF	Organizatrat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit (anglisht: Rule of Law Index)
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (anglisht: Return on Average Assets)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (anglisht: Return on Average Equity)
ROE	Kthimi Mesatar në Kapital (anglisht: Return on Average Equity)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (anglisht: Risk Weighted Assets)
SDR	Të Drejtat Speciale të Tirazhit (anglisht: Special Drawing Rights)
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

**Vërejtje:**

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.

Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2012), Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 3, Prishtinë: BQK.

Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.



## PËRMBAJTJA:

<b>1. Parathënie</b>	<b>11</b>
<b>2. Përmbledhje Ekzekutive</b>	<b>13</b>
<b>3. Ekonomia Botërore</b>	<b>18</b>
3.1. Evropa Juglindore	24
<b>4. Ekonomia e Kosovës</b>	<b>26</b>
4.1. Sektori real	27
<b>5. Sektori Financiar i Kosovës</b>	<b>31</b>
5.1. Karakteristikat e përgjithshme	31
<b>6. Sistemi Bankar i Kosovës</b>	<b>33</b>
6.1. Karakteristikat e përgjithshme të sistemit bankar	33
6.2. Bilanci i gjendjes së sistemit bankar	33
6.3. Performanca dhe rreziqet e sistemit bankar	43
6.4. Rreziqet e sistemit bankar	47
6.5. Analiza Stres-test	59
6.6. Sistemi i pagesave dhe infrastruktura bankare	64
<b>7. Institucionet Tjera Financiare</b>	<b>68</b>
7.1. Kompanitë e sigurimit	68
7.2. Fondet pensionale	70
7.3. Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiarë	71
<b>Tema Specifike</b>	<b>73</b>
8. Relacioni në mes të Konkurrencës së Sistemit Bankar dhe Provizioneve të Humbjeve nga Kreditë	75
Arben Mustafa	
9. Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike në Kosovë	83
Albulenë Kastrati	
<b>9. Shtojcë Statistike</b>	<b>93</b>
<b>10. Referencat</b>	<b>113</b>

<b>LISTA E FIGURAVE</b>	<b>18</b>
Figura 1. Inflacioni në vendet e eurozonës	19
Figura 2. Papunësia në vendet e zgjedhura të eurozonës	19
Figura 3. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave	20
Figura 4. Kthimi në kapital	21
Figura 5. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitlait	22
Figura 6. Norma e kredive jopërformuese në vende të zgjedhura të eurozonës	23
Figura 7. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në vende të zgjedhura të eurozonës	23
Figura 8. Norma e rritjes së PBB-së reale në EJL	24
Figura 9. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL	24
Figura 10. Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJL	25
Figura 11. Harta makroekonomike	27
Figura 12. Bilanci i llogarisë rrjedhëse	28
Figura 13. Dërgesat e emigrantëve	28
Figura 14. Bilanci i llogarisë financiare dhe kapitale	29
Figura 15. Norma vjetore e çmimeve të konsumit	30
Figura 16. Norma reale efektive e këmbimit	30
Figura 17. Struktura e asetëve të sektorit financiar	31
Figura 18. Asetet e jashtme neto	31
Figura 19. HHI për asetet, kreditë dhe depozitat	33
Figura 20. Kontributi në rritjen e asetëve të sistemit bankar sipas kategorive	34
Figura 21. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë	35
Figura 22. Normat e interesit dhe shuma e zbritur në emër të interesit	35
Figura 23. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve	36
Figura 24. Struktura e kredive	36
Figura 25. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike	37
Figura 26. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik	37
Figura 27. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit	37
Figura 28. Trendi i rritjes së kredive sipas maturitetit	38
Figura 29. Trendi i rritjes së depozitave	39
Figura 30. Struktura e depozitave sipas sektorëve	40
Figura 31. Mesatarja gjashtëmujore e normave të interesit	40
Figura 32. Ex-post kosto e financimit, operacionale dhe e rrezikut	42
Figura 33. Raporti ndërmjet provizioneve për humbje nga kreditë dhe bruto kredive	43
Figura 34. Harta e stabilitetit financiar	43
Figura 35. Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve	44
Figura 36. Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve	44
Figura 37. Struktura e të hyrave dhe shpenzimeve sipas kategorive	44



Figura 38. Norma vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive	45
Figura 39. Rritja e shpenzimeve sipas kategorive	45
Figura 40. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive	45
Figura 41. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive	46
Figura 42. Treguesit e profitabilitetit	46
Figura 43. Raporti shpenzime të hyra	46
Figura 44. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar	48
Figura 45. Raporti asete likuide “broad”/detyrime	48
Figura 46. Struktura e letrave me vlerë	49
Figura 47. Rezervat e sistemit bankar	50
Figura 48. Hendeku i likuiditetit	50
Figura 49. Struktura e kredive sipas klsifikimit	51
Figura 50. Raporti NPL/gjithsej kreditë	51
Figura 51. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve	52
Figura 52. Struktura e NPL-ve	52
Figura 53. NPL-të sipas sektorëve	53
Figura 54. NPL-të dhe provizionet	53
Figura 55. Koncentrimi i rrezikut kreditor	56
Figura 56. Kapitalizimi i sistemit bankar	56
Figura 57. Gjithsej kapitali dhe kapitali rregullativ	57
Figura 58. Gjithsej kapitali dhe norma vjetore e rritjes	57
Figura 59. Struktura e kapitalit të sistemit bankar	58
Figura 60. Struktura e kapitalit të klasit të parë	58
Figura 61. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut	59
Figura 62. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit	68
Figura 63. Struktura e detyrimeve të kompanive të sigurimit	68
Figura 64. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara	69
Figura 65. Struktura e primeve të pranuar të kompanive të sigurimit	69
Figura 66. Struktura e dëmeve të paguara të kompanive të sigurimit	70
Figura 67. Çmimi i aksionit të TKPK-së dhe indeksi DJI	70
Figura 68. Struktura e investimeve të Trustit	71
Figura 69. HHI për asetet e OMF-ve	71
Figura 70. Asetet e IMF-ve sipas madhësisë	72
Figura 71. Kreditë e leshura nga IMF-të	72

**LISTA E TABELAVE ----- 18**

Tabela 1. Indikatorët kryesor makroekonomik -----	18
Tabela 2. Borxhi publik dhe bilanci buxhetor në shtetet e zgjedhura të euozonës -----	19
Tabela 3. Rritja mesatare vjetore e kredive dhe depozitave për gjashtëmujorin e parë -----	26
Tabela 4. Numri i institucioneve financiare -----	32
Tabela 5. Struktura e aseteve të sistemit bankar -----	34
Tabela 6. Struktura e detyrimeve të sistemit bankar -----	39
Tabela 7. Zbërthimi i kostos së ndërmjetësimit -----	42
Tabela 8. Tregusit e efikasitetit të sistemit bankar -----	47
Tabela 9. Përmbledhja e rezultateve të stres-testit: Rreziku i likuiditetit -----	63
Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN -----	66
Tabela 11. Rrjeti i sistemit bankar -----	67

**LISTA E KUTIVE ----- 20**

Kutia 1. Performanca e grupeve të huaja bankare të cilat operojnë në Kosovë -----	20
Kutia 2. Tregu i Bonove të Thesarit në Republikën e Kosovës -----	35
Kutia 3. Zbërthimi i kostos së ndërmjetësimit <i>ex-post</i> në sistemin bankar të Kosovës -----	41
Kutia 4. Ngarkesa me Borxh dhe Performanca e Kredive të Klientëve Mikrokreditor në Kosovë-- -----	54





## 1. Parathënie

Ekonomia e Kosovës vazhdon të gjenerojë rritje dhe stabilitet solid makroekonomik, në veçanti në rrafshin fiskal dhe atë financiar. Përkundër rreziqeve në rritje nga sektori i jashtëm, ekonomia e Kosovës edhe në vitin 2012 pritet të shënojë normë pozitive të rritjes. Megjithatë, si një ekonomi e hapur, ekonomia e Kosovës nuk ka shpëtuar pa u prekur nga efektet e krizës me të cilat po ballafaqohen disa nga shtetet e zhvilluara e sidomos ato të Eurozonës, të cilat kanë bërë që norma e rritjes, përkundër që është pozitive, të jetë më e ulët se sa në periudhat e kaluara. Këto rreziqe po shprehen kryesisht përmes ndikimit negativ të krizës në kërkesën e jashtme për produktet e Kosovës (me gjithë nivelin edhe ashtu të ulët të eksportit), si dhe përmes ndikimit negativ të lehtë në dërgesat e emigrantëve dhe ndikimit më të theksuar në investimet e huaja direkte.

Sektori financiar i Kosovës ka vazhduar të zgjerojë aktivitetin dhe të reflektojë nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjitha pjesët përbërëse të tij. Sistemi bankar, si komponenti kryesor i sektorit financiar të Kosovës, ka vazhduar me likuiditet të kënaqshëm, nivel të lartë të kapitalizimit dhe cilësi të mirë të portofolit kreditor, përkundër rritjes së lehtë të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive. Aktiviteti i sistemit bankar ka vazhduar të zgjerohet, por me një ritëm më të ngadalshëm të rritjes si në kontekst të kredive ashtu edhe të depozitave. Ky ngadalësim i aktivitetit ndërlihet me ngadalësimin e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në vend si dhe me masat shtrënguese të ndërmarra nga bankat kundrejt rritjes së rreziqeve në nivel të ekonomisë globale.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vazhdon të ndjekë për së afërmi zhvillimet në sektorin financiar, duke siguruar arritjen e objektivit të saj primar, gjegjësisht duke siguruar ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Gjatë kësaj periudhe kemi përshtatur aktivitetin mbikëqyrës në pajtueshmëri me zhvillimet në sektorin financiar dhe në ekonominë e vendit në përgjithësi si dhe i kemi kushtuar kujdes të veçantë analizës së rreziqeve me të cilat mund të ballafaqohet ekonomia e vendit dhe rrjedhimisht edhe sektori financiar. Aktiviteti në avancimin e infrastrukturës financiare ka vazhduar të jetë prioritet i rëndësishëm i institucionit tonë, duke avancuar kështu kushtet për një sektor edhe më efikas dhe më të qëndrueshëm. Programi i Vlerësimit të Sektorit Financiar i realizuar bashkarisht me FMN-në dhe Bankën Botërore janë bazë e fortë për të konstatuar gjendjen e shëndoshë të sistemit tonë financiar si dhe për të hartuar rrugën e avancimit të mëtejshëm të këtij sektori. Aprovimi i Ligjit mbi bankat dhe institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare ka ndikuar në ngritjen e parimeve të qeverisjes korporative në këto institucione, ndërsa operacionalizimi i skemës së sigurimit të depozitave gjatë këtij viti vetëm sa ka sforcuar edhe më tepër besimin e qytetarëve në sistemin bankar të Kosovës.

Duke pasur parasysh nivelin e lartë të qëndrueshmërisë që ka sektori financiar i Kosovës, prospektet pozitive për aktivitetin e përgjithshëm ekonomik në vend si dhe nevojën e ekonomisë për përkrahje edhe më të madhe nga sektori financiar, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës inkurajon të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë, e posaçërisht institucionet kredidhënëse, që të përshtatin strategjitë e tyre në përputhje me kushtet brenda ekonomisë së Kosovës dhe në këtë mënyrë të vazhdojnë së zgjeruari aktivitetin e tyre gjithmonë duke bazuar në parimet e afarizimit të shëndoshë financiar.

Gani Gërguri  
Guvernator



## 2. Përmbledhje Ekzekutive

Sektori financiar i Kosovës vazhdon të karakterizohet me qëndrueshmëri të lartë. Treguesit kyç të stabilitetit të sektorit financiar, si shkalla e likuiditetit dhe kapitalizimit, si dhe cilësia e portofolit kreditor mbeten në nivel të kënaqshëm, ndërsa niveli i zgjerimit të këtij sektorit përmes aktivitetit kreditor ka shënuar ngadalësim të lehtë. Përderisa rreziqet e drejtpërdrejta që i kanosen sektorit financiar në vend janë menaxhuar mirë dhe mbesin në nivel të ulët, zhvillimet negative në sektorin real dhe atë fiskal në nivel global kanë pasur implikime në ekonominë e Kosovës dhe rrjedhën e zhvillimit në sektorin financiar.

Perspektiva e zhvillimit ekonomik global për vitin 2012 është përkeqësuar dhe si rrjedhojë ekonomia botërore pritet të vazhdojë trendin e saj të ngadalësimit të rritjes. SHBA-të janë ekonomia e vetme që parashihet të ketë përsheptim të rritjes ekonomike. Vendet në zhvillim, megjithëse vazhdojnë të kenë normë të lartë të rritjes, pritet që të kenë zhvillimin më të ngadalshëm gjatë vitit 2012. Ekonomia e eurozonës, e cila po vazhdon të përballet me krizë të thellë të borxheve publike, pritet të ketë zhvillim negativ ekonomik dhe rritje të papunësisë. Zhvillimet e tilla në sektorin real në eurozonë kanë reflektuar në ngritjen e pasigurisë në tregjet financiare dhe sistemit bankar, kryesisht në vendet me borxh të lartë publik, duke ndikuar kështu në përkeqësimin e portofolit kreditor dhe hezitimin e bankave për zgjerim të aktivitetit kreditor.

Evropa Juglindore shënoi normë negative të rritjes ekonomike gjatë gjysmës së parë të vitit 2012, dhe parashikimet për vitin 2012 sugjerojnë që disa nga vendet e rajonit do të shënojnë ngadalësim të rritjes krahasuar me vitin 2011, ndërsa Kroacia dhe Serbia pritet të ballafaqohen me recesion. Në përpjekje për të rritur kërkesën e brendshme, shumë nga vendet e rajonit kanë rritur shpenzimet buxhetore më shpejtë se të hyrat, duke përkeqësuar kështu bilancin buxhetor. Niveli i papunësisë, që përbën një nga problemet më të mëdha në të rajon, ka shënuar ngritje si pasojë e rënies së aktivitetit ekonomik, ndërsa presionet inflacioniste janë zvogëluar duke reflektuar rënien e çmimeve të ushqimit dhe naftës në nivel global. Megjithatë, kreditë dhe depozitat në sistemet bankare të vendeve të EJ-së vazhduan zgjerimin, ku kreditë shënuan trend mesatarisht më të ngadalshëm të rritjes, ndërsa rritja e depozitave u përsheptua. Në anën tjetër, të gjitha vendet e rajonit shënuan përkeqësim të cilësisë së portofolit kreditor dhe rrjedhimisht rritje të normës së kredive joperformuese.

Zhvillimet e pafavorshme në eurozonë reflektuan në zhvillimet në ekonominë e Kosovës dhe sektorin financiar të saj, megjithëse niveli i ulët i integritetit të Kosovës në ekonominë globale zvogëlon në nivel të konsiderueshëm efektin e këtyre rreziqeve. Ekonomia e Kosovës pritet të ketë normën më të lartë të rritjes në rajon, sidoqoftë, norma e rritjes në 2012 është parashikuar të jetë më e ngadalshme se në vitin paraprak. Parashikimet për vitin 2012 janë që rritja reale ekonomike të jetë nën 4 përqind, krahasuar me 4.5 përqind në vitin 2011. Faktorët kryesorë në ngadalësimin e zhvillimit ekonomik janë rënia e nivelit të eksporteve, rënia e investimeve të huaja direkte, si dhe dërgesave të emigrantëve. Ngadalësimi i rritjes së kreditimit për sektorin privat ka ndikuar gjithashtu në rënien e kërkesës për konsum dhe investime, ndërsa rritja e shpenzimeve dhe investimet e vazhdueshme të sektorit publik kanë pasur efekt pozitiv në rritjen ekonomike.

Ekonomia e Kosovës vazhdon të karakterizohet me probleme strukturore që reflektohen në bilanc tregtar negativ si rezultat i nivelit të lartë të importeve kundrejt eksporteve. Niveli i lartë i deficitit tregtar vazhdon të kontribuojë në nivel të lartë të deficit të llogarisë

rrjedhëse, që pjesërisht zbutet falë transfereve rrjedhëse. Megjithatë, në gjysmën e parë të vitit 2012, dërgesat e emigrantëve shënuan rënie të lehtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rënie mjaft të theksuar gjatë kësaj periudhe shënuan Investimet e Huaja Direkte (IHD), të cilat u zvogëluan për 53.3 përqind, duke ndikuar negativisht në bilancin e llogarisë financiare. Për dallim nga viti 2011, çmimet gjatë gjysmës së parë të vitit 2012 u rritën më ngadalë. Norma e inflacioni ishte 1.5 përqind krahasuar me 9.6 përqind në vitin paraprak.

Ndërlidhja e ngushtë në mes të sektorit real dhe atij financiar në ekonominë e Kosovës reflektohet në faktin se sektori financiar gjithashtu pësoi ngadalësim të rritjes gjatë gjysmës së parë të vitit 2012. Problemet në sektorin real paraqesin rrezik të shtuar për sektorin financiar, i cili ndërmjet tjerash reflektohet me ngadalësim të aktivitetit kreditor. Megjithatë, sektori financiar ka vazhduar të ketë nivel të lartë të qëndrueshmërisë. Asetet e sektori financiar të Kosovës, të cilat vazhdojnë të kenë strukturë të ngjashme me periudhat paraprake, ngadalësuan trendin e rritjes në 4.8 përqind nga 13.2 përqind sa u rritën në qershor të vitit 2011, duke arritur vlerën prej 4.8 miliardë. Struktura e këtyre aseteve vazhdon të dominohet nga sistemi bankar që në qershor të vitit 2012 përbënte 74.6 përqind të gjithsej aseteve. Shkalla e koncentrimit të sistemit bankar vazhdon të jetë e lartë, mirëpo me trend të lehtë rënës si pasojë e rritjes së presioneve konkurruese nga bankat e vogla. Në nëntor të vitit 2012, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës licencoi operimin e degës së një banke turke, duke kontribuar kështu në rritjen mëtejshme të konkurrencës në vend.

Konform ngadalësimit të trendit rritës të aseteve të sistemit bankar, u ngadalësua edhe trendi i rritjes së aktivitetit kreditues. Në qershor të vitit 2012, vlera e kredive të sistemit bankar u rritë për 9.3 përqind, krahasuar me rritjen prej 15.7 përqind në qershor të vitit 2011. Si rezultat, vlera e gjithsej kredive të lëshuara nga sistemi bankar arriti në 1.77 miliardë euro, që paraqet 36.2 përqind të PBB-së. Struktura e kredive të dhëna në Kosovë vazhdon të dominohet nga kreditë për ndërmarrje që në qershor 2012 përbënin 76 përqind të portofolit kreditor, dhe ngadalësimi i tyre kishte peshën kryesore në ngadalësimin e rritjes së gjithsej kredive. Arsyet kryesore për ngadalësimin e kreditimit për ndërmarrjet, sipas anketës së realizuar me bankat në Kosovë nga BQK, janë shtrëngimi i procedurave dhe standardeve për kredidhënie nga ana e bankave, që erdhi si pasojë e perceptimeve negative mbi sektorin real dhe ndjeshmërinë e lartë të industrive të caktuara ndaj këtyre ndryshimeve. Struktura e kredive për ndërmarrje vazhdon të dominohet nga kreditë për sektorin e tregtisë, ndërsa sektori i bujqësisë vazhdon të mbetet sektori me kreditimin më të ulët. Sipas afatit të maturimit, vazhdojnë të dominojnë kreditë me afat më të gjatë se dy vite, të cilat shënuan rritje të pjesëmarrjes për dallim nga viti paraprak.

Kredidhënia e sistemit bankar është e koncentruar brenda Kosovës dhe si e tillë, në njërin anë rritë rrezikun e ekspozimit në një ekonomi të vetme, mirëpo në anën tjetër zvogëlon rrezikun potencial nga ekspozimi në tregje të jashtme. Divesifikimi i aseteve dhe kredive në sektorë dhe nënsektorë të ndryshëm brenda ekonomisë minimizon rrezikun nga ekspozimi në ekonominë vendore, ndërsa fillimi i tregtimit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës ka kontribuar në këtë diversifikim dhe ulje të rrezikut. Ndërsa, ekspozimi ndaj rreziqeve të jashtme kufizohet kryesisht në investimet në formë të letrave me vlerë dhe plasmaneve në bankat jashtë vendit, pjesëmarrja e të cilave shënoi rënie.

Burim kryesor i financimit të aktivitetit bankar të Kosovës vazhdojnë të jenë depozitat e mbledhura brenda vendit, të cilat kanë pësuar ngadalësim të rritjes në periudhën e fundit. Në qershor të vitit 2012, vlera e depozitave në sistemin bankar të Kosovës arriti në 2.1



miliardë euro, duke shënuar rritje prej 7.7 përqind krahasuar me 11.8 përqind në vitin paraprak. Struktura e depozitave dominohet nga depozitat e ekonomive familjare me pjesëmarrje 72.1 përqind, pasuar nga depozitat e ndërmarrjeve private me 19.6 përqind. Ngadalësimi i rritjes së gjithsej depozitave erdhi si pasojë e gati përgjysmimit të depozitave të ndërmarrjeve publike, si dhe ngadalësimit të rritjes së depozitave të ekonomive familjare, ndërmarrjeve private dhe depozitave të jorezidentëve, që është reflektim i ngadalësimit të aktivitetit global ekonomik. Ngadalësimi i rritjes së burimeve të brendshme të financimit në një anë, dhe stabiliteti i vazhdueshëm i sektorit financiar në Kosovë, kanë ndikuar që bankat të shfrytëzojnë dhe të kenë mundësi qasjeje në burime të jashtme të financimit. Sidoqoftë, burimet e jashtme të financimit vazhdojnë të kenë pjesëmarrje shumë të ulët krahasuar me burimet e brendshme, që është avantazh i konsiderueshëm për stabilitetin e sektorit financiar në raste të lëkundjeve dhe rënies së besueshmërisë në tregjet e jashtme financiare.

Normat e interesit në sistemin bankar mbeten në nivel të lartë, megjithëse kanë vazhduar të shënojnë rënie. Norma mesatare për kredi në gjysmën e parë të vitit 2012 shënoi rënie, duke zbritur në 13.7 përqind nga 14.3 përqind sa ishte në qershor 2011. Ndërsa, mesatarja e interesit për depozita nuk pësoi ndryshim, duke qëndruar kështu në 3.4 përqind. Rrjedhimisht, margjina e interesit u zvogëlua në 10.2 përqind nga 10.9 përqind sa ishte në qershor 2011. Profitabiliteti i sistemit bankar pësoi rënie, ku profiti neto u zvogëlua për 28.5 përqind, ndërsa kthimi në kapital zbriti në 8.1 nga 12.9 përqind sa ishte në qershor të vitit 2011. Përkeqësimi i treguesve të profitabilitetit kryesisht erdhi si pasojë e ngadalësimit të rritjes së të hyrave, që rezultoi nga ngadalësimi i aktivitetit kreditor, si dhe rritjes së shpenzimeve, veçanërisht atyre për provizione të humbjeve nga kreditë .

Sistemi bankar i Kosovës, megjithë përkeqësimin e ambientit të jashtëm makroekonomik dhe rënien e profitabilitetit, ka arritur të bëjë menaxhim të mirë të tre rreziqeve direkte me të cilat ballafaqohet sistemi bankar i Kosovës: rrezikun e likuiditetit, atë kreditor dhe rrezikun e solvencës. Përkundër rënies së lehtë të treguesve kryesorë të likuiditetit, sistemi bankar i Kosovës vazhdon të ketë shkallë të lartë të likuiditetit, kryesisht si pasojë e strukturës së detyrimeve që dominohen nga burime më të qëndrueshme të financimit siç janë depozitat, si dhe menaxhimit të mirë të strukturës së aseteve likuide. Në qershor të vitit 2012, raporti kredi/depozita është rritur në 83.2 përqind, që është në nivel të përafërt me normën prej 80 përqind të rekomanduar nga BQK. Trendi i vazhdueshëm i rritjes së depozitave, që reflekton besim e vazhdueshëm të qytetarëve në sistemin bankar, koncentrimi i ulët i depozitave, mbajtja në vazhdimësi e rezervave të likuiditetit në nivel më të lartë se minimumi i kërkuar, vlera e kënaqshme aktuale e treguesve të likuiditetit, si dhe mundësitë e mira që bankat vendore kanë në qasje të fondeve afatshkurtra në bankat jashtë vendit sugjerojnë që sistemi bankar i Kosovës vazhdon të ketë ekspozim të ulët ndaj rrezikut të likuiditetit.

Rreziku kreditor në sistemin bankar të Kosovës vazhdon të jetë i ulët, megjithëse ka shënuar rritje të lehtë. Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në qershor të vitit 2012 u rritë në normën 6.5 përqind nga 5.9 përqind sa ishte në qershor të vitit 2011. Sidoqoftë, duhet të theksohet se kjo rritje është kryesisht pasojë e ngadalësimit të normës së rritjes së kredive dhe jo si pasojë e ndonjë përsheptimi të theksuar të rritjes së kredive joperformuese, vlera e të cilave ka shënuar trend të rritjes të ngjashëm me vitet e kaluara. Përkundër rritjes, norma e kredive joperformuese në sektorin bankar të Kosovës vazhdon të mbetet në nivelin më të ulët në rajon, dhe rreziku i shtuar kreditor si pasojë e përkeqësimit të cilësisë së portofolit të kredive relativizohet edhe më tej nga shkalla e lartë

e provizioneve të ndara në vazhdimësi për mbulimin e humbjeve nga kreditë, që në qershor të vitit 2012 arriti në 117.3 përqind, ngjashëm me 117.2 përqind në qershor 2011. Vlera e ekspozimeve të mëdha kreditore ka shënuar rritje krahasuar me periudhën paraprake, mirëpo koncentrimi i rrezikut kreditor është diversifikuar përmes shtimit të numrit të kredimarrësve të mëdhenj.

Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të karakterizohet me shkallë të lartë të kapitalizimit dhe cilësisë së kapitalit. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit mbetet në 17.2 përqind, që tejkalon dukshëm minimumin prej 12 përqind të kërkuar nga BQK. Për më tepër, 60 përqind e gjithëj kapitalit përbëhet nga kapitali aksionar. Niveli i tillë i kapitalizimit si dhe cilësia e mirë e kapitalit janë tregues të qëndrueshmërisë së lartë të sistemit bankar në Kosovë, dhe aftësisë për mbulimin e humbjeve në rast të tronditjeve të mundshme. Qëndrueshmëria e lartë e sistemit vërtetohet edhe me anë të analizës stres-test, rezultatet e së cilës tregojnë se sistemi bankar i Kosovës, në përgjithësi, do të mund të përballonte situata “ekstreme” të paraqitjes së rrezikut të likuiditetit, rrezikut kreditor dhe atij nga normat e këmbimit valutor dhe normat e interesit. Më konkretisht, rezultatet sugjerojnë që ky sistem bankar mund të përballojë shkallë të lartë të supozuar të tërheqjes së menjëhershme të depozitave, me nivelin aktual të likuiditetit. Gjithashtu, falë nivelit të lartë të kapitalizimit, sistemi bankar i Kosovës rezultoi të jetë i aftë në përballimin e rritjes së konsiderueshme të nivelit të kredive joperformuese, me ç’rast nevoja për rikapitalizim do të ishte e koncentruar vetëm në disa banka individuale. Ndërsa, ekspozimi i sistemit tonë bankar ndaj rrezikut valutor dhe atij të interesit vazhdon të jetë minimal, si pasojë e prezencës tejet të vogël të depozitave dhe kredive në valutë të huaj dhe me norma interesi fleksibile.

Infrastruktura e bankave ekzistuese në vend, ndonëse me trend më të ngadalësuar të rritjes në kuptimin e shtimit të degëve dhe nëndegëve, ka vazhduar zgjerimin duke lehtësuar dhe rritur shfrytëzimin e shërbimeve bankare nga qytetarët dhe bizneset. Kontribut në rritjen e shkallës dhe efektivitetit të shërbimeve bankare ka shënuar gjithashtu rritja e vazhdueshme e rrjetit të bankomatëve dhe paisjeve POS të cilat lehtësojnë sistemin e pagesave. Ndonëse këto shërbime po rriten me ritëm të shpejtë, Kosova vazhdon të qëndron në nivel të ulët të zhvillimit dhe përdorimit të shërbimeve elektronike bankare në krahasim me rajonin. Zhvillimi i sistemit të pagesave ka avancuar si në aspektin e rritjes së sigurisë dhe qëndrueshmërisë së tij, ashtu edhe në rritjen e efikasitetit. Numri dhe vlera e transaksioneve të kryera përmes sistemit të pagesave është rritur, krahas rritjes së masave vëzhguese për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e pagesave. Në rritjen e numrit të transaksioneve ka pasur ndikim të madh edhe fillimi i tregtimit të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku BQK si agjent fiskal i qeverisë filloi emetimin e tyre nga janari i vitit 2012, duke ndikuar kështu në rritjen e stabilitetit dhe efikasitetit financiar dhe vendosjen e bazave për zhvillim të tregut të kapitalit në vend. BQK është gjithashtu në fazën e fundit të zhvillimit të një sistemi më të avancuar të pagesave (sistemi RTGS) që mundëson shlyerjen në kohë reale të pagesave me vlerë sistemike dhe urgjente midis bankave vendore dhe institucioneve qeveritare, duke zvogëluar kështu rrezikun potencial nga vonesat në shlyerje.

Institucionet tjera financiare, që në qershor të vitit 2012 përbënin 25.4 përqind të gjithëj aseteve të sektorit financiar, përbëhen nga fondet pensionale, kompanitë e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar. Asetet e sistemit pensional të Kosovës, që kryesisht menaxhohen nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), shënuan rritje vjetore prej 19.5 përqind, duke arritur vlerën 659.1 milion euro. Pjesa më e

madhe e këtyre asetëve përbëhet nga investimet në aksione jashtë vendit, çmimi i të cilave shënoi rritje, si dhe investime në letra me vlerë jashtë vendit, të cilat gjithashtu kanë pjesëmarrje të madhe. Në vitin 2012, TKPK ka investuar 5 përqind të asetëve të saj në tregun vendor kryesisht përmes depozitave në bankat komerciale, duke rritur kështu ofertën e parave në treg. Asetet e kompanive të sigurimit gjithashtu shënuan rritje të konsiderueshme prej 16.3 përqind, ku në qershor të vitit 2012 arritën vlerën 120.2 milion euro. Megjithatë, profiti i tyre u përgjysmua, duke rënë në 0.6 milion krahasuar me 1.2 milion në qershor të vitit 2011. Pjesëmarrësit në industrinë mikrofinanciare u shtuan gjatë kësaj periudhe, duke arritur në 19 institucione mikrofinanciare nga 17 sa ishin në qershor 2011. Përkundër këtij fakti, vlera e gjithsej asetëve të sektorit u zvogëlua për 4.1 përqind, kryesisht për shkak të zvogëlimit të numrit të kredive. Performanca e sektorit u përkeqësua gjithashtu, ku në qershor të vitit 2012 IMF-të shënuan humbje prej 2.4 milion euro.

Edhe në këtë numër të Raportit të Stabilitetit Financiar vazhdon praktika e përfshirjes së analizave që trajtojnë tema specifike me interes për sektorin financiar dhe ekonomik në vend dhe rajon. Temat e analizuara kësaj radhe janë si në vijim: 1. Relacioni në mes të Konkurrencës së Sektorit Bankar dhe Provizioneve të Humbjeve nga Kreditë, dhe 2. Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike në Kosovë.

### 3. Ekonomia Botërore

Aktiviteti ekonomik global po përballlet me ngadalësim të rritjes në vitin 2012. Rritja ekonomike në nivel global vlerësohet të jetë ngadalësuar duke arritur normën prej rreth 3.3 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 3.8 përqind në vitin 2011. Ky ngadalësim ishte më i theksuar në vendet evropiane, ku rënia e kërkesës së brendshme si dhe pasiguria e shkaktuar nga sektori fiskal gjatë vitit 2012 kanë ndikuar në rënien e konsumit dhe investimeve. Edhe vendet në zhvillim pritet të karakterizohen me ngadalësim të rritjes ekonomike, pasi që rritja e kërkesës së brendshme pritet të frenohet nga politikat më të shtrënguara monetare. Sipas projeksioneve të FMN-së, gjatë vitit 2012, SHBA-të pritet të zgjerojnë aktivitetin ekonomik me rritje të PBB-së reale prej 2.2 përqind krahasuar me 1.8 përqind sa ishte në vitin 2011. Kontributin kryesor në këtë rritje pritet ta kenë investimet të cilat pritet të jenë 4.6 përqind më të larta se në vitin e kaluar (Tabela 1).

Ekonomia e eurozonës pritet të shënojë rënie prej 0.4 përqind në vitin 2012 krahasuar me rritjen prej 1.4 përqind në vitin 2011. Ndryshe nga SHBA-të, në eurozonë shkaktari kryesor i recesionit pritet të jetë rënia e investimeve, të cilat parashihet të bien me 1.5 përqind krahasuar me vitin e kaluar. Në mesin e vendeve të eurozonës, pothuajse të gjitha vendet parashihet të shënojë rënie apo normë më të ulët të rritjes ekonomike krahasuar me vitin 2011, me përjashtim të Gjermanisë e cila pritet të ketë normë pozitive të rritjes prej 1.9 përqind krahasuar me 1.3 përqind në vitin e kaluar. Tkurrja ekonomike në eurozonë pritet të bartë pasojat në sektorin fiskal dhe financiar në periudhat në vijim, gjë që do ta vështirësojë tejkalimin e krizës së borxheve publike, e cila është reflektuar në rënien e shkallës së besueshmërisë në tregje si dhe ka ndikuar në rritjen e kostos së financimit dhe rritjen e kredive joperformuese në institucionet financiare.

**Tabela 1. Indikatorët kryesorë makroekonomik**

Përshkrimi	PBB		Inflacioni		Llogaria rrjedhëse (% e PBB-së)	
	2011	2012	2011	2012	2011	2012
Ekonomia botërore	3.8	3.3	6.9	6.2	0.6	0.3
SHBA	1.8	2.2	3.1	2.0	-3.1	-3.1
Eurozona	1.4	-0.4	2.7	2.3	0.4	1.1
Vendet në zhvillim	6.2	5.3	7.2	6.1	1.9	1.3
Evropa Qendrore dhe Lindore	5.3	2.0	5.3	5.6	-6.1	-5.0

Burimi: FMN (2012)

Kriza e fundit financiare globale u pasqyrua në rritjen e vazhdueshme të borxhit publik në vendet e zhvilluara. Ndërkohë, parashikimet për një performancë më të dobët të sektorit real në shumicën e vendeve të zhvilluara, kanë ndikuar në rritjen e mëtejme të pasigurisë së pjesëmarrësve të tregut lidhur me qëndrueshmërinë e politikave fiskale dhe borxheve publike. Rrjedhimisht, në fund të vitit 2011, shkalla e borxhit publik në eurozonë arriti në 87.3 përqind të PBB-së (27.3pp mbi kriterin e Maastricht-it) krahasuar me shkallën prej 85.3 përqind të PBB-së të regjistruar në vitin 2010. Të dhënat për fundin e gjashtëmuajorit të parë të vitit 2012 tregojnë për një rritje të mëtejme të borxhit publik i cili arriti në 90.0 përqind të PBB-së. Pothuajse të gjitha shtete e eurozonës e thelluan nivelin e borxhit publik në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012, veçanërisht shtetet të cilat cilësohen me nivel

të lartë të borxhit publik. Në anën tjetër, Greqia e cila ka nivelin më të lartë të borxhit publik në eurozonë, arriti ta reduktoj atë për 21.0pp (Tabela 2).

**Tabela 2. Borxhi publik dhe bilanci buxhetor në shtetet e zgjedhura të eurozonës**

Përshkrimi	Greqia			Italia			Portugalia			Irlanda			Belgjika		
	2010	2011	Qer 2012	2010	2011	Qer 2012	2010	2011	Qer 2012	2010	2011	Qer 2012	2010	2011	Qer 2012
Borxhi publik	145.0	165.3	144.3	118.6	120.1	126.1	93.3	107.8	117.5	92.5	108.2	111.5	96.0	98.0	102.5
Bilanci buxhetor	-10.6	-9.1	-8.8	-4.4	-3.8	-5.0	-9.8	-4.4	-6.8	-31.1	-13.3	-9.3	-4.1	-4.0	-3.2

Burimi: Eurostat


Borxhi publik në eurozonë u thellua edhe pse deficitit buxhetor shënoi rënie nga 6.3 përqind e PBB-së në vitin 2010 në 4.2 përqind në vitin 2011. Edhe të dhënat për gjysmën e parë të vitit 2012 tregojnë për një rënie të deficitit buxhetor (3.7 përqind të PBB-së). Përkundër rënies së deficitit buxhetor, duke pasur parasysh mungesën e rritjes ekonomike, ruajta e qëndrueshmëria së borxheve në eurozonë konsiderohet të mbetet sfiduese.

Ekonomia botërore është karakterizuar me rënie të shkallës së inflacionit në gjysmën e parë të vitit 2012. Deri në fund të vitit 2012, FMN-ja ka parashikuar që shkalla mesatare e inflacionit në nivel global të jetë 6.2 përqind (6.9 përqind në vitin 2011). Rënia e çmimit të naftës dhe si rrjedhojë edhe rënia e çmimeve të ushqimit dhe energjisë pritet të jenë kontribuuesit kryesor për rënieve inflacioniste si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në vendet në zhvillim.

Inflacioni në vendet e zhvilluara për vitin 2012 pritet të jetë 2.3 përqind (3.0 përqind në vitin 2011), ndërkohë që në vendet në zhvillim inflacioni pritet të jetë 6.1 përqind (7.2 përqind në vitin 2011). Sipas të dhënave aktuale, mesatarja e inflacionit në SHBA në gjysmën e parë të këtij viti ka rënë në 2.0 përqind (3.1 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2011), kurse në eurozonë ka rënë në 2.5 përqind (2.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2011). Për shkak të krizës


së borxheve e cila ka shkaktuar rënie të kërkesës së përgjithshme, vërehet një rënie më e theksuar e shkallës së inflacionit në Greqi dhe Spanjë (Figura 1).

**Figura 1. Inflacioni në vendet e zgjedhura të eurozonës**



Burimi: Eurostat (2012)

**Figura 2. Papunësia në vendet e zgjedhura të eurozonës**



Burimi: Eurostat (2012)

Sa i përket papunësisë, të dhënat aktuale tregojnë për zvogëlim të normës në shumicën e ekonomive të fuqishme botërore. Në SHBA norma e papunësisë është zvogëluar në 8.2 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2012 (8.7 përqind në fund të vitit 2011), 4.4 përqind në Japoni (4.5 përqind në vitin 2011), 4.0 përqind në Kinë (4.0 përqind në vitin 2011) dhe 6.0 përqind në Rusi (6.5 përqind në vitin 2011). Ndërsa, shkalla e papunësisë në vendet e eurozonës ka vazhduar të rritet si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në vitin 2012 duke shënuar ngritje nga 10.6 sa ishte në tremujorin e fundit të vitit 2011 në 11.3 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2012. Spanja, Greqia, dhe Portugalia përveç se janë vendet që i prijnë listës për sa i përket shkallës së papunësisë, gjithashtu paraqesin vende në të cilat papunësia është rritur më së shumti në gjysmën e parë të vitit 2012 krahasuar me vitin 2011 (Figura 2). Në anën tjetër vendet si Gjermania dhe Austria përveç se kanë shkallën më të ulët të papunësisë, janë ndër vendet që kanë arritur të ulin akoma më tej papunësinë në gjysmën e parë të vitit 2012.

Ngadalësimi i rritjes së eksporteve në nivel global gjatë vitit 2012 pritet të ndikoj në përkeqësimin e llogarisë rrjedhëse. Eksporti i mallrave në nivel global pritet të rritet me 7.3 përqind në vitin 2012 krahasuar me rritjen prej 7.9 përqind në vitin 2011. Rritja e eksporteve pritet të shënojë ngadalësim më të madh në vendet e eurozonës (nga 6.1 përqind sa ishte rritja në vitin 2011 në 1.4 përqind në vitin 2012) dhe SHBA (nga 7.4 përqind në vitin 2011 në 4.2 përqind në vitin 2012), ndërsa mesatarja e rritjes së eksporteve në të gjitha vendet tjera të botës pritet të ketë një rënie të lehtë (nga 8.0 përqind në vitin 2011 në 7.8 përqind në vitin 2012). Përkundër kësaj, eurozona pritet ta rrisë shkallën e suficitit të llogarisë rrjedhëse nga 0.4 përqind në vitin 2011 në 1.1 përqind e PBB-së në vitin 2012, SHBA-të pritet të kenë shkallën e njëjtë të deficitit të llogarisë rrjedhëse me vitin e kaluar prej 3.1 përqind e PBB-së, ndërsa suficiti i llogarisë rrjedhëse pritet të ulet në vendet në zhvillim nga 1.9 përqind në vitin 2011 në 1.3 përqind të PBB-së në vitin 2012.


## Kutia 1. Performanca e grupeve të huaja bankare të cilat operojnë në Kosovë<sup>1</sup>

### ProCredit Holding – PCH (Gjermani)

Treguesit kryesorë financiar të Procredit Holding kanë shënuar ngritje të dukshme gjatë vitit 2011, përkundër faktit që shkalla e rritjes së ekonomisë botërore ishte më e ngadalshme, ndërsa shumica e vendeve të eurozonës u ballafaquan me recesion. Vlera e gjithsej aseteve të PCH në fund të vitit 2011 arriti në 5.49 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 5.9 përqind në krahasim me fundin e vitit 2010.

Kreditë bruto për sektorin jo-financiar, të cilat përbëjnë pjesën kryesore të aseteve të PCH-së, arritën vlerën prej 4 miliardë euro si rezultat i rritjes vjetore prej 10.3 përqind, ndërsa vlera e depozitave arriti në 3.4 miliardë euro, rritje kjo prej 5.9 përqind në krahasim me vitin paraprak.

Figura 3. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të grupeve bankare përkatëse

<sup>1</sup> Në analizë do të përfshihen vetëm grupet bankare në të cilat bëjnë pjesë tri bankat më të mëdha që operojnë në Kosovë

PCH gjithashtu shënoi përmirësim të raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave operative. Në vitin 2011, ky raport zbriti në 74.6 përqind, duke shënuar rënie prej 6.7 pikë të përqindjes (Figura 3). Ky përmirësim ishte pasojë e rritjes së vëllimit të biznesit në një anë, dhe masave të ndërmarra për përmirësim të efikasitetit në anën tjetër, të cilat rezultuan në rritjen e të hyrave operative në vlerën 405.9 milion euro (rritje prej 7.11 përqind) si dhe zvogëlimin e shpenzimeve operative në vlerën 348.6 milion euro (2.11 përqind rënie në krahasim me vitin 2010).

Profiti neto i konsoliduar për vitin 2011 u përmirësua dukshëm. Vlera e tij arriti në 46.8 milion euro krahasuar me 12.5 milion euro sa ishte në vitin paraprak. Një rritje e tillë e profitabilitetit u reflektua me rritjen e normës së kthimit në kapital (ROE) që arriti në 10.35 përqind krahasuar me 3.79 përqind në vitin 2010 (Figura 4). Përkundër rritjes së fitimit dhe kthimit në kapital, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (*angl. Capital Adequacy Ratio: CAR*) shënoi një rënie prej 1.5pp, duke zbritur në 15 përqind (Figura 5). Sidoqoftë, kjo normë mbetet mjaft mbi minimumin e kërkuar, duke siguruar kështu kapitalizim të kënaqshëm të PCH-së.

Shkalla e aftësisë kreditore (Credit rating) të PCH për vitin 2011 mbetet e njejtë me atë të vitit 2010, përkatësisht BBB-, sipas vlerësimit nga agjensioni Fitch.

Trendi rritës i treguesve financiar për PCH vazhdoi edhe në gjysmën e parë të vitit 2012. Vlera e gjithsej asetëve në fund të qershorit të vitit 2012 arriti në 5.8 miliardë euro (rritje prej 4.8 përqind në krahasim me qershor 2011). Raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave u zvogëlua për 4.1pp, ndërsa fitimi neto i konsoliduar shënoi rritje të konsiderueshme prej 54.2 përqind në krahasim me periudhën e njejtë të vitit paraprak, duke arritur vlerën prej 27.6 milion euro. Në fund të qershorit 2012, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit u zvogëlua në 14.8 përqind (15% në qershor 2011). Asetet e Bankës ProCredit në Kosovë kishin vlerën prej 766.9 milion euro në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, dukë përbërë kështu 13.3 përqind të gjithsej asetëve të PCH.

#### Raiffeisen Bank International –RBI (Austri)

Në fund të vitit 2011, asetet e Raiffeisen Bank International arritën vlerën prej 146.9 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 12.1 përqind në krahasim me fundin e vitit 2010. Vlera e kredive për sektorin jo-financiar arriti në 81.6 miliardë (rritje vjetore prej 7.8%), ndërsa vlera e depozitave të konsumatorëve arriti në 66.7 miliardë (rritje vjetore prej 15.8%).


Gjatë vitit 2011, të hyrat operative shënuan rritje prej 1.3 përqind, duke arritur në 5.5 milion. Megjithatë,

shpenzimet operative shënuan rritje edhe më të lartë, prej 4.7 përqind (gjithsej vlerë prej 3.12 milion euro), duke ndikuar kështu në rritjen e raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave operative në 57 përqind nga 55.2 përqind sa ishte në vitin 2010 (Figura 3). Kjo rritje ishte kryesisht pasojë e rritjes së shpenzimeve të stafit dhe zhvlerësimit të asetëve të paprekshme.

Fitimi neto i konsoliduar i RBI për vitin 2011 shënoi vlerën 968 milion euro, një rënie prej 11 përqind në krahasim me vitin 2010. Kjo rënie u reflektua në rënien e normës së kthimit në kapital (ROE) në 9.7 përqind, që paraqet rënie vjetore prej 2.8pp (Figura 4). Megjithatë, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) shënoi rritje. Në fund të vitit 2011, CAR arriti në 13.5 përqind, krahasuar me 13.3 përqind në vitin 2010 (Figura 5).

RBI është e vetmja nga tri grupet bankare të tri bankave më të mëdha që operojnë në Kosovë që tregton aksionet e saj në bursë. Në fund të vitit 2011, çmimi i aksioneve të RBI në bursën e Vienës

Figura 4. Kthimi në kapital (ROE), në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të grupeve

ishte 20.07 euro, duke shënuar rënie prej 51 përqind gjatë vitit<sup>2</sup>. Në vitin 2011, RBI u vlerësua me shkallën A të aftësisë kreditore nga agjensioni Fitch, ngjashëm me atë të vitit paraprak.

Asetet e RBI vazhduan trendin rritës edhe në gjysmën e parë të vitit 2012. Në qershor 2012, gjithsej vlera e asetëve arriti në 152.7 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 11 përqind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave operative arriti në 58.1 përqind, 3pp më i lartë se në qershor 2011. Megjithatë, fitimi neto i konsoliduar shënoi rritje. Në qershor 2012 fitimi arriti në 701 milion euro, 14 përqind më i lartë se në qershor të vitit 2011. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit gjithashtu u rritë në 14.8 përqind, krahasuar me 13.5 përqind sa ishte në qershor të vitit 2011.

Në qershor të vitit 2012, banka Raiffeisen në Kosovë përbënte 0.4 përqind të gjithsej asetëve të Raiffeisen Bank International.

### NLB Group (Slloveni)

Rënia ekonomike dhe destabiliteti i tregjeve financiare në Evropë në vitin 2011 reflektuan negativisht në performancën financiare të NLB Group, e cila shënoi rënie në shumicën e treguesve financiarë në këtë periudhë. Gjithsej asetet e grupit shënuan rënie prej 8.1 përqind, duke rënë në vlerën 16.4 miliardë euro. Kreditë bruto për sektorin jo-financiar gjatë vitit 2011 u zvogëluan për 5.7 përqind (gjithsej vlera në dhjetor 2011 shënoi 12.3 miliardë euro) si pasojë e politikës më konservative të kreditimit që NLB Group implementoi si reagim ndaj krizës, ndërsa depozitat u zvogëluan për 1.8 përqind (gjithsej vlera zbriti në 10.2 miliardë euro).


NLB Group arriti të rrisë efikasitetin operativ gjatë vitit 2011. Të hyrat operative u zvogëluan për 0.5 përqind në krahasim me vitin paraprak, ndërsa shpenzimet u zvogëluan për 3.3 përqind. Rrjedhimisht, raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave zbriti në 59.8 përqind, që paraqet rënie prej 1.75 pp në krahasim me vitin 2010 (Figura 5).

Megjithë rritjen e efikasitetit operativ, fitimi neto i konsoliduar shënoi rënie prej 18 përqind në krahasim me vitin paraprak. Kjo rënie e fitimit i atribuohet kryesisht përkeqësimit të cilësisë së kredive, gjë që ndikoi në rritjen e provizioneve për humbje nga kreditë. Norma e kthimit në kapital (ROE) gjithashtu shënoi rënie në -22.2 përqind, krahasuar me -17.5 përqind në vitin 2010 (Figura 4). Si rezultat i kërkesave nga Banka e Sllovenisë për përmirësim të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR), NLB Group shtoi kapitalin në vitin 2011 dhe, rrjedhimisht, CAR arriti në 11.1 përqind krahasuar me 10.2 përqind në vitin 2010 (Figura 5).

Rënia e treguesve të profitabilitetit u reflektua në zvogëlimin e shkallës së aftësisë kreditore nga agjensioni Fitch, i cili uli vlerësimin e NLB Group në shkallën BBB për vitin 2011, në krahasim me atë A- në vitin 2010.

Në pjesën e parë të vitit 2012, NLB Group vazhdoi trendin rënës të asetëve, ku vlera e tyre arriti në 16.3 miliardë euro, 6.5 përqind më pak në krahasim me qershor 2011. Megjithatë, raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave shënoi përmirësim të dukshëm ku nga 59.8 përqind sa ishte në qershor 2010, u zvogëlua në 45 përqind. Fitimi neto i konsoliduar gjithashtu shënoi rritje të dukshme.

Figura 5. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR)



Burimi: Raportet vjetore të grupeve bankare përkatëse


<sup>2</sup> Indeksset ATX dhe EURO STOXX Banks, në të cilat RBI është e përfshirë, shënuan rënie prej 35 dhe 38 përqind respektivisht.



Nga 0.9 milion euro sa ishte në qershor 2011, fitimi neto i konsoliduar në fund të qershorit 2012 arriti vlerën prej 32.3 milion euro. Ky përmirësim i fitimit erdhi kryesisht si rezultat i efektit të njehershëm pozitiv të blerjes së instrumenteve të kapitalit të ndërvarur. Në fund të qershorit 2012, norma e kthimit në kapital (ROE) u përmirësua në 6.5 përqind, prej 0.2 përqind sa ishte në periudhën e njejtë të vitit paraprak. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) të NLB group qëndroi në 12.1 përqind, që paraqet nivel të njejtë me atë të periudhës paraprake. Në fund të gjashtëmuorit të parë të vitit 2012, Banka NLB në Kosovë përbënte 2.4 përqind të gjithë asetëve të NLB Group.

Kreditimi në shumicën e vendeve të zhvilluara vazhdon të jetë në nivele të ulëta, sidomos në vendet që po përballen me krizë buxhetore. Kjo pasi që kriza buxhetore ka rritur pasigurinë e bankave për të lëshuar kredi. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe, bankat në shumicën e vendeve të Evropës shënuan përqendrim të cilësisë së portofolit kreditor (Figura 6). Në anën tjetër, në shumicën e vendeve të eurozonës, bankat raportuan përmirësim në treguesin e

Figura 6. Norma e kredive jopërfomuese në vende të zgjedhura të eurozonës



Burimi: FMN (2012)

mjaftueshmërisë së kapitalit (Figura 7). Mirëpo, në vendet si Irlanda, Spanja, Greqia dhe Portugalia edhe pse është regjistruar përmirësim në nivelin e kapitalizimit, ende janë duke u përballur me vështirësi duke marrë parasysh se kanë investuar mjete të shumta në fletëobligacionet qeveritare si dhe në kredi për shtëpi.

Norma bazë e interesit u ndryshua disa herë gjatë vitit 2011. Si pasojë e presioneve të shtuara inflacioniste në pjesën e parë të vitit 2011, BQE-ja vendosi ta rrisë normën bazë të interesit për dy herë me nga 0.25pp ndërsa në pjesën tjetër të vitit sërish zvogëloi normën bazë për dy herë radhazi me nga 0.25pp në nëntor dhe dhjetor. Në korrik 2011, Banka Qendrore Evropiane (BQE) vendosi ta ulë normën bazë të interesit për 0.25pp në 0.75 përqind.

Figura 7. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në vende të zgjedhura të eurozonës



Burimi: FMN (2012)

Sa i përket kursit të këmbimit, euro është zhvlerësuar ndaj shumicës së valutave kryesore gjatë gjysmës së parë të vitit 2012. Zhvlerësimin më të theksuar e regjistroi ndaj dollarit amerikan me 13.0 përqind, pastaj ndaj funtës britanike me 9.5 përqind, si dhe frankës zvicerane me 0.7 përqind. Lëvizjet e valutës euro kundrejt valutave tjera të mëdha kryesisht reflektojnë ndryshimet e perceptimeve të tregut për perspektivën ekonomike dhe fiskale të vendeve të eurozonës. Zhvlerësimi i euros ishte kryesisht pasojë e pasigurisë për

shkak të rritjes së rrezikut nga vështirësitë fiskale me të cilat u ballafaquan disa nga vendet e eurozonës.

### 3.1. Evropa Juglindore

Në gjysmën e parë të vitit 2012, vendet e Evropës Juglindore (EJL) u karakterizuan me rënie të aktivitetit ekonomik. Sipas vlerësimeve të Komisionit Evropian, PBB reale e vendeve të EJL-së u karakterizua me recesion prej 1.2 përqind, rënie kjo e ndikuar nga rënia e kërkesës së përgjithshme. Kroacia shënoi nivelin më të thellë të recesionit në gjysmën e parë të vitit 2012 (1.8 përqind), pasuar nga Serbia (1.7 përqind) dhe Maqedonia e Mali i Zi (me nga 1.1 përqind). Shqipëria e cila kishte rritje pozitive gjatë viteve të kaluara, shënoi rënie ekonomike në tremujorin e parë të vitit 2012 (0.2 përqind), përderisa Kosova vlerësohet të ketë pasur normë pozitive të rritjes ekonomike në gjysmën e parë të vitit 2012. Kjo rënie e aktivitetit ekonomik i adresohet faktit që vendet e rajonit vazhdojnë të jenë të ndjeshme ndaj zhvillimeve në ekonominë e eurozonës në aspektin e tregtisë, investimeve të huaja direkte (IHD-ve), pjesëmarrjes së lartë të bankave të huaja dhe dërgesave të emigrantëve. Në anën tjetër parashikimet e FMN-së për aktivitetin ekonomik në EJL për tërë vitin 2012 tregojnë për një ngritje të lehtë të PBB-së prej 0.5 përqind (Figura 8). Të gjitha vendet parashihet të kenë rritje ekonomike deri në fund të vitit me përjashtim të Kroacisë dhe Serbisë të cilat parashihen të kenë rënie ekonomike. Në anën tjetër, viti 2013 pritet të jetë vit i rikuperimit të aktivitetit ekonomik për të gjitha vendet e rajonit pasi që norma mesatare e rritjes së PBB-së pritet të arrijë në 1.9 përqind.

Rënia e aktivitetit ekonomik në vendet e rajonit ka ndikuar edhe në përkeqësimin e gjendjes në tregun e punës. Vlerësimet e fundit tregojnë për një shkallë mesatare të papunësisë në EJL prej 26.8 përqind, që është për 0.9pp më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Recesioni që vazhdoi të karakterizojë ekonominë e Serbisë bëri që ky vend të regjistrojë rritjen më të madhe të papunësisë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (2.9pp), pasuar nga Kroacia dhe Mali i Zi (1.6, përkatësisht 1.3pp).

Figura 8. Norma e rritjes së PBB-së reale në EJL





Figura 9. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL, në përqindje




Norma mesatare e deficitit të llogarisë rrjedhëse për vendet e EJL-së në gjysmën e parë të vitit 2012 ishte 10.6 përqind e PBB-së, që është nivel pothuajse i njëjtë me vitin e kaluar. Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina, dhe Serbia u karakterizuan me rritje të shkallës së deficitit të llogarisë rrjedhëse krahasuar me vitin 2011, ndërsa vendet tjera shënuan zvogëlim të deficitit (Figura 9). Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina dhe Kosova vazhdojnë të raportojnë normat më të larta të deficitit të llogarisë rrjedhëse, ndërsa Kroacia dhe Maqedonia vazhdojnë të jenë vendet me normat më të ulëta të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Sipas parashikimeve të FMN-së për vitin 2012, në pothuajse të gjitha vendet e EJL-së, parashihet trend më i ngadalësuar i rritjes së eksporteve ndërkohë që importet parashihet të shënojnë rënie. Rritja e eksporteve pritet të jetë 0.4 përqind apo 9.8pp më e ulët se sa rritja e shënuar në vitin 2011. Ndërsa, rënia e importeve pritet të jetë 2.1 përqind ndërkohë që në vitin 2011 kishte rritje të importeve prej 6.9 përqind. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në vendet e rajonit u përkeqësua edhe si pasojë e zvogëlimit të transfereve rrjedhëse në shumicën e vendeve të rajonit. Në anën tjetër, është përkeqësuar edhe bilanci i Investimeve të Huaja Direkte (IHD), i cili paraqet një komponentë shumë të rëndësishme për financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Norma mesatare e neto IHD-ve në raport me PBB-në ishte 5.0 përqind, krahasuar me 5.8 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit 2011. Sa i përket shteteve individuale, Mali i Zi, Kosova, dhe Maqedonia shënuan rënie të raportit ndërmjet IHD-ve dhe PBB-së (4.5, 4.2, përkatësisht 1.6pp), ndërsa Kroacia, Serbia, Bosnja e Hercegovina, dhe Shqipëria shënuan rritje (mesatarisht 1.2pp).

Aktiviteti ekonomik në rënie ka shtyrë disa nga qeveritë e vendeve të rajonit të rrisin shpenzimet qeveritare për të stimuluar kërkesën e përgjithshme në ekonomitë e tyre, gjë e cila është reflektuar në përkeqësime të bilancit të tyre buxhetor. Serbia, Mali i Zi, dhe Shqipëria u karakterizuan me rritje më të shpejtë të shpenzimeve krahasuar me të hyrat buxhetore, gjë që ndikoi në zgjerimin e deficitit të tyre buxhetor. Norma mesatare e deficitit buxhetor në EJL shënoi ngritje nga 1.8 përqind e PBB-së në gjysmën e parë të vitit 2011 në 2.4 përqind të PBB-së në gjysmën e parë të vitit 2012. Në qershor 2012, shkallën më të lartë të deficitit buxhetor e shënoi Serbia (6.4 përqind të PBB-së), pasuar nga Mali i Zi (3.7 përqind e PBB-së), Maqedonia (2.2 përqind e PBB-së) dhe Shqipëria (1.6 përqind e PBB-së). Përrjashtim bën Kosova, që në qershor 2012 shënoi suficit prej 0.5 përqind të PBB-së. Si rezultat, në këtë periudhë është thelluar edhe shkalla mesatare e borxhit publik në EJL, e cila arriti në 38.5 përqind të PBB-së krahasuar me normën prej 37.0 përqind të PBB-së të regjistruar në fund të vitit të kaluar. Shqipëria dhe Serbia raportuan shkallën më të lartë të borxhit publik prej 59.4 përkatësisht 53.2 përqind të PBB-së, përderisa Kosova vazhdon të ketë shkallën më të ulët të borxhit publik në rajon me vetëm 6.9 përqind të PBB-së.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2012, shumica e vendeve në EJL u përballën me rënie të presioneve inflacioniste që kryesisht ishin reflektim i rënies së çmimeve të naftës dhe ushqimit në nivel global. Mesatarja e inflacionit për gjashtëmuorin e parë të

Figura 10. Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJL



Burimi: Komisioni Europian (2012)

vitit 2012 ishte 2.5 përqind krahasuar me mesataren prej 5.8 përqind që ishte shënuar në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Serbia, Mali i Zi, dhe Kroacia raportuan normat më të larta të inflacionit (4.4, 3.4, përkatësisht 2.5 përqind), Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina raportuan nivel të inflacionit prej 2.4 përkatësisht 2.2 përqind, ndërkaq Kosova dhe Shqipëria raportuan nivelin më të ulët të inflacionit prej rreth 1.5 përqind (Figura 10).

Sa i përket kursit të këmbimit ndërmjet euros dhe valutave të vendeve të EJL-së, në qershor 2011 krahasuar me periudhën e njëjtë në vitin paraprak, euro u zhvlerësua ndaj lekut shqiptar me 0.8 përqind (138.51 ALL/EUR), përderisa u vlerësua ndaj shumicës së valutave të vendeve tjera të EJL-së. Vlerësimin më të madh e shënoi ndaj dinarit serb me 16.8 përqind (115.8 RSD/EUR), pastaj ndaj kunas kroate me 1.8 përqind (7.54 HRK/EUR), si dhe ndaj denarit maqedonas me 0.9 përqind (61.52 MKD/EUR).

Aktiviteti kreditues është karakterizuar me një rënie të lehtë të trendit të rritjes, përderisa depozitat vazhduan të karakterizohen me normë më të lartë të rritjes krahasuar me gjysmën e parë të vitit të kaluar. Të dhënat për gjysmën e parë të vitit 2012 tregojnë se, me përjashtim të Malit të Zi, ku kreditimi shënoi rënie, të gjitha vendet e EJL-së kanë shënuar rritje të kreditimit, por te shumica e tyre norma e rritjes ishte më e ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sipas të dhënave të Komisionit Evropian, rritja më e lartë e normës së kreditimit është regjistruar në Serbi (15.2 përqind), Shqipëri (10.2 përqind), Kosovë (9.3 përqind), Maqedoni (8.2 përqind), Bosnje e Hercegovinë (5.1 përqind), dhe Kroaci (3.4 përqind), përderisa Mali i Zi raportoi rënie prej 5.2 përqind të kredive.

**Tabela 3. Rritja mesatare vjetore e kredive dhe depozitave për gjashtëmuajorin e parë**

Përshkrimi	Shqipëria		BIH		Kroacia		Maqedonia		Mali i Zi		Serbia		Kosova	
	Qer 2011	Qer 2012	Qer 2011	Qer 2012	Qer 2011	Qer 2012	Qer 2011	Qer 2012	Qer 2011	Qer 2012	Qer 2011	Qer 2012	Qer 2011	Qer 2012
Kreditë	10.3	10.2	4.8	5.1	6.5	3.4	7.8	8.2	-11.8	-5.2	17.3	15.2	15.7	9.3
Depozitat	15.8	10.6	2.7	2.8	1.5	13.9	11.0	8.9	1.3	0.4	7.1	15.0	11.8	7.7

Burimi: Komisioni Evropian, Raporti i tremujorit të tretë 2012; për Kosovën të dhënat e BQK-së.  
Shënim: si për kredi ashtu edhe për depozita është paraqitur mesatarja e tremujorit të parë dhe të dytë.

Sa i përket normës së rritjes së depozitave, Shqipëria, Maqedonia, Kosova, dhe Mali i Zi raportuan ngadalësim të rritjes, përderisa Serbia dhe Kroacia raportuan normat më të larta të rritjes (Tabela 3). Sistemet bankare në EJL u karakterizua me përkeqësim të cilësisë së portofolit kreditor gjatë kësaj periudhe. Në pjesën e parë të vitit 2012, Shqipëria, Serbia, Mali i Zi, dhe Bosnja e Hercegovina raportuan normat më të larta të kredive jo-performuese në rajon, me 21.2, 19.5, 17.1 përkatësisht 12.6 përqind. Shkallën më të ulët të kredive jo-performuese vazhdon ta ketë Kosova, me vetëm 6.5 përqind në qershor 2012.

## 4. Ekonomia e Kosovës


Ekonomia e Kosovës vazhdon të jetë njëra ndër ekonomitë me normën më të lartë të rritjes në rajon përkundër ngadalësimit të rritjes krahasuar me vitin e kaluar. Burimet kryesore të financimit për aktivitetin ekonomik në vend gjatë gjysmës së parë të vitit kanë treguar performancë më të dobët, duke qenë kështu shkaktar i ngadalësimit të rritjes ekonomike (Figura 11). Në këtë kontekst, përkeqësimi i performancës së ekonomisë globale bëri që eksportet dhe investimet e huaja direkte të shënojnë rënie, përderisa edhe dërgesat e emigrantëve shënuan rënie të lehtë. Aktiviteti i sektorit privat vazhdoi të përkrahet nga

kreditë e sistemit bankar, të cilat po ashtu u karakterizuan me ritëm më të ngadalshëm të rritjes. Në anën tjetër, sektori publik vazhdon të jetë bartës i aktivitetit ekonomik në vend nëpërmjet shpenzimeve publike, veçanërisht atyre kapitale, të cilat po shënojnë rritje të vazhdueshme.

Si rezultat i mbështetjes së lartë në importin e mallrave nga jashtë, ekonomia e Kosovës vazhdon të karakterizohet me deficit të lartë

tregtar, i cili paraqet shkaktarin kryesor për shkallën e lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse në vend. Rënia e eksporteve si dhe vazhdimi i rritjes së importeve ka bërë që deficitin e llogarisë rrjedhëse të vazhdojë të rritet gjatë vitit 2012. Ekonomia e Kosovës gjatë këtij viti po ballafaqohet me zbutje të presioneve inflacioniste në krahasim me vitin e kaluar. Inflacioni në Kosovë është treguar mjaft i luhatshëm në vitet e fundit, duke pasqyruar në masë të madhe zhvillimet e çmimeve në tregjet e jashtme, lidhshmëri kjo që rrjedhë nga shkalla e lartë e mbështetjes së ekonomisë së vendit në mallrat e importuara nga jashtë. Përkundër problemeve në sektorin e jashtëm, ekonomia e Kosovës vazhdon të ketë qëndrueshmëri fiskale. Kjo qëndrueshmëri fiskale shpjegohet nga niveli i ulët i borxhit publik (5.8 përqind e PBB-së në qershor 2012) si dhe bilancit buxhetor, i cili deri në qershor të vitit 2012 u karakterizua me suficit (0.5 përqind e PBB-së).

Figura 11. Harta Makroekonomike



## 4.1. Sektori real

### 4.1.1. Produkti i brendshëm bruto

Zhvillimet ekonomike në gjashtë muajt e parë të vitit 2012 sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në Kosovë po zgjerohet por me një ritëm më të ngadalshëm se sa në vitin e kaluar. Ngadalësimi të rritjes ekonomike në masë më të madhe po i kontribuojnë zhvillimet në sektorin e jashtëm, të cilat po ndikojnë negativisht nivelin e eksporteve, investimet e huaja direkte si dhe dërgesat e emigrantëve. Gjithashtu, rritja më e ngadalshme e kreditimit nga sistemi bankar po i kontribuon ngadalësimi të rritjes së konsumit dhe investimeve të sektorit privat. Ndërsa, zgjerimi i vazhdueshëm i shpenzimeve publike paraqet një kontribuues të rëndësishëm në zgjerim të aktivitetit ekonomik në vend. Rritja reale ekonomike për vitin 2012 parashikohet të jetë nën 4 përqind (4.5 përqind në vitin 2011). Në terma nominal, PBB gjatë vitit 2012 pritet të tejkalojë shumë prej 4.9 miliardë euro.

Zgjerimi i vazhdueshëm i kredidhënies nga sistemi bankar i Kosovës paraqet burim të rëndësishëm të financimit në ekonominë vendore. Deri në qershor të vitit 2012, kreditë e lëshuara nga sistemi bankar shënuan rritje vjetore prej 9.3 përqind, duke arritur në vlerën prej 1.77 miliardë euro. Kreditë e lëshuara nga sistemi bankar për ndërmarrje shënuan rritje vjetore prej 6.3 përqind ndërsa kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 13.0 përqind. Burimi kryesor i financimit për bankat në Kosovë mbeten depozitat e


mbledhura brenda vendit, të cilat gjithashtu vazhduan të shënojnë rritje dhe deri në qershor arritën vlerën prej 2.1 miliardë euro (rritje vjetore prej 7.7 përqind). Sistemi bankar i Kosovës ka vazhduar të ruaj nivelin e lartë të qëndrueshmërisë, duke u karakterizuar me shkallë të lartë të kapitalizimit, cilësi të mirë të portofolit kreditor dhe pozicion të kënaqshëm të likuiditetit.

Zhvillime pozitive gjatë kësaj periudhe vlerësohet të ketë pasur edhe në sektorin fiskal. Vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore deri në fund të qershorit 2012 arriti në 625.6 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 18.5 përqind. Përkundër rritjes së shpenzimeve buxhetore, buxheti i Kosovës deri në muajin qershor 2012 regjistroi suficit prej 24.2 milionë euro. Kjo ndodhi pasi që edhe niveli i të hyrave prej 649.8 milion euro në këtë periudhë shënoi rritje vjetore prej 12.2 përqind. Investimet publike në periudhën referuese kanë dhënë kontribut mjaft të rëndësishëm në rritjen ekonomike kur merren parasysh projektet e investimeve kapitale të cilat po shënojnë rritje të vazhdueshme. Shpenzimet qeveritare për investime kapitale deri në qershor të vitit 2012 shënuan normë vjetore të rritjes prej 32.4 përqind. Shpenzimet kapitale paraqesin kategorinë kryesore në kuadër të shpenzimeve buxhetore, me pjesëmarrje prej 35.9 përqind të gjithsej shpenzimeve (224.8 milionë euro). Po ashtu, deri në muajin qershor, shpenzimet qeveritare për konsum të mallrave dhe shërbimeve si dhe shpenzimet për paga dhe mëditje kanë shënuar rritje vjetore prej 33.5 përkatësisht 13.7 përqind, duke arritur në 78.5 përkatësisht 169.1 milion euro.

Efekt negativ në PBB-në e Kosovës vazhdon të ketë bilanci tregtar, i cili në vazhdimësi po karakterizohet me shkallë të lartë të deficitit (Figura 12). Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012, deficitit tregtar në Kosovë arriti në 988.5 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 6.4 përqind. Rritja e deficitit i adresohet rritjes së importeve prej 2.6 përqind dhe rënies së eksporteve prej 18.4 përqind. Kjo ka ndikuar që niveli i mbulueshmërisë së importeve me eksporte të zvogëlohet nga 15.0 përqind, sa ishte në gjashtëmuajorin e parë 2011, në 11.9 përqind në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012.


Niveli i lartë i deficitit tregtar bën që ekonomia e Kosovës të karakterizohet me një normë të lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Në qershor 2012, deficitit i llogarisë rrjedhëse u thellua për 5.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe arriti vlerën prej 216.5 milionë euro. Komponenti

Figura 12. Bilanci i llogarisë rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Figura 13. Dërgesat e emigrantëve, në milionë euro




Burimi: BQK (2012)

me peshën më të madhe në llogarinë rrjedhëse vazhdon të jetë llogaria e mallrave, e cila në vazhdimësi është karakterizuar me shpërputhje mjaft të madhe ndërmjet vlerës së importeve dhe eksporteve. Ndërsa, një kategori tjetër me peshë mjaft të madhe në llogarinë rrjedhëse është llogaria e transfereve rrjedhëse, e cila dominohet nga dërgesat e emigrantëve. Kjo kategori vazhdimisht është karakterizuar me bilanc pozitiv dhe ka kontribuar dukshëm në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Sidoqoftë, deri në qershor të vitit 2012 dërgesat e emigrantëve arritën vlerën prej 261.5 milion euro që është për 0.7 përqind më pak se periudha e njëjtë e vitit paraprak (Figura 13). Rënia e dërgesave të emigrantëve prej 4.8 përqind në tremujorin e parë të vitit 2012 pothuajse u rikuperua në tremujorin e dytë të vitit 2012 me një rritje prej 3.1 përqind dhe në këtë mënyrë janë shtuar gjasat për një rrjedhje të qëndrueshme të tyre përkundër vështirësive me të cilat janë duke u ballafaquar ekonomitë e zhvilluara.

Llogaria kapitale dhe financiare e bilancit të pagesave vazhdon të karakterizohet me bilanc pozitiv, që rrjedh kryesisht nga Investimet e Huaja Direkte (IHD) dhe investimet tjera (Figura 14). Bilanci i llogarisë financiare, edhe pse pozitiv, është reduktuar me 56.7 përqind në gjysmën e parë të vitit 2012 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Këtij reduktimi i kanë kontribuar më së shumti IHD-të dhe investimet tjera. Bilanci i IHD-ve (IHD-të në

Figura 14. Bilanci i llogarisë kapitale dhe financiare si dhe komponentet e llogarisë financiare, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Kosovë minus IHD-të e rezidentëve kosovar jashtë vendit) gjatë gjysmës së parë të vitit 2012 arriti vlerën prej 78.5 milionë euro, që paraqet një rënie mjaft të lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur ky bilanc kishte shënuar vlerën prej 180.3 milionë euro. IHD-të e pranuar në Kosovë, të cilat paraqesin një komponentë të rëndësishëm në kuadër të investimeve të sektorit privat, shënuan rënie vjetore prej 53.3 përqind duke arritur vlerën prej 86.6 milionë euro. Bilanci i investimeve tjera është përgjysmuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, nga 161.7 milion euro ka rënë në 79.8 milion euro.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2012 janë regjistruar 5,279 ndërmarrje të reja, që paraqet një rritje prej 24.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa janë shuar 483 ndërmarrje apo 5.7 përqind më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Aktivitetet ekonomike më të preferuara për regjistrimin e ndërmarrjeve të reja ishin tregtia (31.8 përqind të gjithsej ndërmarrjeve), pasuar nga industria përpunuese (10.7 përqind), hotelet dhe restorantet (10.3 përqind), ndërtimtaria (9.9 përqind), pasuritë e patundshme (9.6 përqind), etj. Për më tepër, ndërmarrjet e reja të regjistruara kryesisht janë mikrondërmarrje<sup>3</sup> (99.01 përqind e gjithsej ndërmarrjeve të reja), ndërsa pjesa e mbetur përbëhet nga ndërmarrjet e vogla (0.84 përqind), ndërmarrjet e mesme (0.11 përqind), dhe ndërmarrjet e mëdha (0.04 përqind).

<sup>3</sup> Klasifikimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë është bërë në bazë të numrit të punëtorëve, dhe atë: mikrondërmarrje (1-9 punëtor), ndërmarrje të vogla (10-49 punëtor), ndërmarrje të mesme (50-249 punëtor), dhe ndërmarrje të mëdha (250 e më shumë punëtor).


### 4.1.2. Çmimet

Presionet inflacioniste të cilat arritën kulmin në mars të vitit 2011 filluan të zbuten në muajt vijues duke arritur nivelin më të ulët në mars të vitit 2012. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (*angl. Consumer Price Index: CPI*) për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012 shënoi rritje mesatare vjetore prej 1.5 përqind, që paraqet një normë relativisht më të ulët të inflacionit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kur inflacioni shënoi një normë mesatare vjetore prej 9.6 përqind (Figura 15). Zbutja e presioneve inflacioniste gjatë vitit 2012 kryesisht i adresohet dobësimit të kërkesës si dhe zhvillimeve të përgjithshme të çmimeve në nivel global. Çmimet e produkteve si buka dhe drithërat, perimet si dhe vajrat dhe yndyrat kishin ndikimin kryesor në zbutjen e inflacionit. Ndërsa, çmimet e naftës vazhduan edhe më tutje të kenë ndikim pozitiv në rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve në vend.

Ndryshimi i çmimeve në Kosovë në masë të madhe është pasojë e ndryshimit të çmimeve në tregjet e jashtme, të cilat reflektohen nëpërmjet Indeksit të Çmimeve të Importit (*angl. Imports Price Index: IPI*). Në pjesën e parë të vitit 2012, norma mesatare vjetore e rritjes së IPI-së ishte 6.0 përqind. Ndjeshmëria e lartë e nivelit të çmimeve në Kosovë nga lëvizjet e çmimeve në tregjet globale vërehet edhe në Figurën 15, ku shihet se trendi i CPI-së dhe Indeksit të Çmimeve të Prodhimit (*angl. Producer Price Index: PPI*) kanë ndjekur trend shumë të ngjashëm me IPI-në. Trendi i ngjashëm i çmimeve të importit dhe çmimeve të prodhimit tregon për një mbështetje njaft të madhe të prodhimit vendor në importin e lëndës së parë nga jashtë. Për kundër kësaj, në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012, norma vjetore e ndryshimit të CPI-së ka qenë dukshëm më e ulët se sa norma vjetore e ndryshimit të IPI-së (4.8pp diferencë). Kësaj diference i ka kontribuar PPI-ja që në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012 ka shënuar normën mesatare të deflacionit prej 0.1 përqind. Kjo rënie e çmimeve të prodhimit është manifestuar kryesisht te nxjerrja e mineraleve metalike, prodhimi i metaleve, prodhimi i mobileve, etj.


Si rezultat i zbutjes së inflacionit, në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012, norma reale efektive e këmbimit (NREK) u zhvlerësua ndaj valutave të partnerëve tregtar, që paraqet një zhvillim pozitiv për ekonominë e Kosovës, duke inkurajuar prodhuesit vendor në rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve të tyre në tregjet e jashtme (Figura 16). NREK u zhvlerësua me normë

Figura 15. Norma vjetore e çmimeve të konsumit, importit dhe prodhimit



Burimi: ASK (2012); Kalkulimet e BQK-së

Figura 16. Norma Reale Efektive e Këmbimit



Burimi: BQK (2012)



mesatare vjetore prej rreth 0.9 përqind. Faktori kryesor i cili ndikon në nivelin e NREK-ut në Kosovë kundrejt partnerëve tregtarë është niveli i inflacionit, i cili në gjashtëmuajorin e parë ishte më i ulët krahasuar me vendet e CEFTA-s dhe BE-së për mesatarisht 1.3, përkatësisht 1.2pp.

## 5. Sektori Financiar i Kosovës


### 5.1. Karakteristikat e përgjithshme

Sektori financiar në Kosovë vazhdoi të karakterizohet me nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë edhe në vitin 2012, edhe pse gjithsej asetet e sektorit financiar u rritën me trend më të ngadalshëm. Deri në qershor 2012, vlera e përgjithshme e asetëve të sektorit financiar arriti në 4.8 miliard euro, që tregon për një ngadalësim të rritjes nga 13.2 përqind në qershor 2011 në 4.8 përqind në qershor 2012. Përderisa asetet e bankave komerciale vazhduan të dominojnë strukturën e asetëve të sektorit financiar me 74.6 përqind të gjithsej asetëve në qershor 2012, ngadalësimi i trendit të rritjes së tyre ka përcaktuar edhe trendin e rritjes së gjithsej asetëve të sektorit financiar. Asetet e sistemit bankar në qershor 2012 shënuan rritje vjetore prej 6.0 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 12.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sektori i dytë për nga madhësia e pjesëmarrjes në gjithsej asetet e sektorit financiar janë fondet pensionale të cilat në qershor 2012 përfaqësuan 18.6 përqind të gjithsej asetëve (16.7 përqind në qershor 2011) (Figura 17).

Numri i institucioneve financiare në sektorin financiar të Kosovës nuk ka shënuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm gjatë periudhës së fundit. Numri i bankave


komerciale ka mbetur i pandryshuar duke qëndruar në tetë (8) banka, përderisa industrisë së sigurimeve i janë shtuar edhe 2 kompani të reja gjë që kanë ngritë numrin e gjithsej kompanive të sigurimeve në 13. Duke përfshirë edhe 19 institucionet mikrofinanciare, 36 ndihmësit financiar dhe 2 fondet pensionale, sektori financiar në vend numëron gjithsej 78 institucione financiare (Tabela 4).

Figura 17. Struktura e asetëve të sistemit financiar sipas sektorëve



Burimi: BQK (2012)

Figura 18. Asetet e jashtme neto sipas institucioneve, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Tabela 4. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	Qershor 2009	Qershor 2010	Qershor 2011	Qershor 2012
Bankat komerciale	8	8	8	8
Kompanitë e sigurimeve	11	11	11	13
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	28	29	32	36
Institucionet mikrofinanciare	19	17	17	19

Burimi: BQK (2012)

Vlera e Aseteve të Jashtme Neto (AJN)<sup>4</sup> të sektorit financiar të Kosovës vazhdoi të rritet edhe gjatë vitit 2012, mirëpo rritja ishte më e ngadalshme krahasuar me vitin 2011. Deri në qershor 2012, vlera e AJN-ve arriti në 2.08 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.7 përqind (14.7 përqind në qershor 2011). Në qershor 2012, AJN e BQK-së arritën vlerën 1.1 milion euro, përderisa AJN-të e bankave komerciale dhe institucioneve tjera financiare arritën në 434.5, përkatësisht 532.4 milionë euro (Figura 18).

Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm arritën vlerën prej 2.45 miliardë euro në qershor 2012, ku pjesëmarrjen më të lartë vazhdojnë të kenë investimet në depozita (51.4 përqind) dhe letra me vlerë (9.8 përqind). Ngjashëm me vitin paraprak, BQK ka rritur investimet në depozita kundrejt investimeve në letra me vlerë, ndërsa bankat komerciale kanë rritur investimet në letra me vlerë kundrejt investimeve në depozita. Në qershor 2012, rreth 81.6 përqind e kërkesave të BQK-së ndaj sektorit të jashtëm përbëheshin nga investimet në depozita (68.5 përqind në qershor 2011), ndërkaq 4.0 përqind ishin investime në letra me vlerë (18.8 përqind në qershor 2011). Në të njëjtën kohë, rreth 39.2 përqind e investimeve të bankave komerciale në sektorin e jashtëm ishin investime në depozita (44.2 përqind në qershor 2011), ndërkaq 32.0 përqind e këtyre investimeve përbëheshin nga letrat me vlerë (32.4 përqind në qershor 2011).

Detyrimet e sektorit financiar ndaj sektorit të jashtëm arritën vlerën prej 363.9 milion euro në qershor 2012, një rënie vjetore prej 16.0 përqind krahasuar me vitin paraprak. Duke qenë se detyrimet ndaj sektorit të jashtëm kryesisht përbëhen nga kreditë që institucionet financiare që operojnë në Kosovë kanë pranuar nga institucionet financiare që operojnë jashtë vendit dhe nga depozitat e jorezidentëve në bankat që operojnë në Kosovë, rënia e shkallës së këtyre kredive prej 32.8 përqind dhe në të njëjtën kohë, rënia e depozitave të jorezidentëve për 24.2 përqind ndikuan në rënien e përgjithshme të detyrimeve të sektorit financiar ndaj sektorit të jashtëm.

Në qershor 2012, kërkesat neto ndaj sektorit të brendshëm arritën vlerën prej 1.1 miliard euro, që paraqet një rritje prej 25.8 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë në vitin paraprak. Rritja e kërkesave neto ndaj sektorit të brendshëm kryesisht rezultoi nga zvogëlimi i depozitave të qeverise prej 8.2 përqind në këtë periudhë, si dhe rritja e kërkesave ndaj sektorit privat për rreth 6.5 përqind.

<sup>4</sup> Në këtë kontekst, sektori financiar përfshinë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë.

## 6. Sistemi Bankar i Kosovës

### 6.1. Karakteristikat e përgjithshme të sistemit bankar

Sistemi bankar në vend nuk ndryshoi nga vitet paraprake as për nga numri i bankave pjesëmarrëse në sistem dhe as për nga struktura. Në qershor 2012, në tregun bankar në Kosovë operuan 8 banka komerciale, prej të cilave gjashtë kishin pronësi të huaj dhe dominuan asetet e tregut bankar me rreth 89.0 përqind të gjithsej aseteve, ndërkaq dy kishin pronësi vendore dhe kishin një pjesëmarrje prej 11.0 përqind në gjithsej asetet.

Tregu bankar vazhdon të karakterizohet me shkallë relativisht të lartë të koncentrimit, megjithëse rritja e vazhdueshme e aktivitetit të bankave më të vogla ka ndikuar që shkalla e koncentrimit të ndjekë trend rënës në vitet e fundit. Në qershor 2012, tri bankat më të mëdha në vend

menaxhuan rreth 71.8 përqind të gjithsej aseteve të sistemit bankar, që paraqet rënie krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur menaxhuan 74.5 përqind të gjithsej aseteve. Edhe Indeksi Herfindahl-Hirschman (IHH) tregon për një rënie të shkallës së koncentrimit në tregun bankar të vendit. Sipas IHH për gjithsej asetet, tregu bankar u karakterizua me një shkallë koncentrimi prej 1,972 pikë në qershor 2012, që paraqet një rënie të shkallës së koncentrimit për 129 pikë të IHH krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjithashtu, IHH për gjithsej kreditë dhe depozitat e sistemit bankar tregon për rënie të vazhdueshme të koncentrimit këto vitet e fundit (Figura 19).


Infrastruktura bankare vazhdoi të karakterizohet me një trend më të ngadalshëm sa i përket zgjerimit edhe gjatë vitit 2012. Numri i degëve dhe nëndegëve të bankave komerciale në vend arriti në 312 në qershor 2012, që paraqet një rritje vjetore prej 3 njësi (5 njësi në vitin 2011). Gjithashtu, numri i të punësuarve në bankat komerciale shënoi rritje në 3,713 punëtor deri në qershor 2012 krahasuar me 3,654 punëtor sa kishte në qershor 2011.

### 6.2. Bilanci i gjendjes së sistemit bankar

#### 6.2.1 Asetet

Sistemi bankar i Kosovës ka vazhduar të zgjerojë aktivitetin edhe gjatë periudhës së fundit, duke shërbyer si një ndër promotorët kryesor të aktivitetit ekonomik në vend. Duke arritur vlerën prej 2.65 miliardë euro (54 përqind e PBB-së) gjithsej asetet e sistemit bankar të Kosovës shënuan rritje vjetore prej 6.1 përqind në qershor të vitit 2012 (rritje vjetore 12.7 përqind në qershor 2011). Ndryshe nga periudhat paraprake kur investimet e bankave në letrat me vlerë ishin një ndër kontribuuesit thelbësor në rritjen e gjithsej aseteve, në

Figura 19. HHI për asetet, kreditë dhe depozitat



Burimi: BQK (2012)


gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012, letrat me vlerë kontribuuan me vetëm 0.4pp. Kontribuues kryesor në rritjen e aseteve të sistemit bankar në gjashtëmuajorin e parë të viti 2012 ishin kreditë dhe paraja e gatshme e bilanci me BQK-në, të cilat kontribuan me 6.1pp, përkatësisht 1.3pp (Figura 20). Në anën tjetër, bilanci me bankat komerciale në dy vitet e fundit ka kontribuar negativisht në rritjen e gjithsej aseteve të sistemit bankar (rënie për 2.2pp në qershor 2012 dhe rënie për 1.4pp në qershor 2011).

Përkundër faktit se rritja ekonomike vazhdon të jetë

pozitive, në vitin 2012 në Kosovë vërehen shenja të ngadalsimit të aktivitetit ekonomik, kryesisht si pasojë e rënies ekonomike që ka karakterizuar disa vende të eurozonës. Situata e ngjashme po karakterizon edhe vendet fqinje, ku disa prej tyre po shënojnë edhe rënie ekonomike. Duke gjykyar nga ngadalësimi edhe i indikatorëve të sektorëve tjerë të ekonomisë së Kosovës, si rënia e eksporteve, ngadalësimi i importeve si dhe rënia e investimeve të huaja direkte dhe dërgesave të emigrantëve, deri diku situatë e ngjashme e ka përcjellë edhe sistemin bankar i cili ka shënuar ngadalësim të trendit të kreditimit.

Norma vjetore e rritjes së kredive në qershor 2012 ishte 9.3 përqind, krahasuar me normën prej 15.7 përqind të regjistruar në qershor të vitit 2011. Ngadalësim më të theksuar në normën e rritjes shënuan investimet në letra me vlerë, të cilat shënuan një rritje vjetore prej 4.8 përqind në qershor 2012, krahasuar me rritjen vjetore prej 80.4 përqind në qershor 2011. Një ndër arsyt kryesore për ngadalësimin e investimeve në letra me vlerë ishin problemet me borxhin publik në disa nga vendet e Eurozonës dhe rrjedhimisht pasiguritë e shkaktuara rreth performancës së këtyre ekonomive.

Figura 20. Kontributi në rritjen e aseteve të sistemit bankar sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Tabela 5. Struktura e aseteve të sistemit bankar

Përshkrimi	Qershor 2009		Qershor 2010		Qershor 2011		Qershor 2012	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	241.9	12.5	268.1	12.1	265.3	10.6	298.4	11.3
Bilanci me bankat komerciale	286.7	14.9	351.6	15.8	319.5	12.8	265.3	10.0
Letrat me vlerë	13.3	0.7	114.0	5.1	205.6	8.2	215.6	8.1
Kreditë dhe lizingu	1,280.9	66.5	1,404.6	63.3	1,624.9	65.0	1,776.3	67.0
Asetet fikse	40.1	2.1	42.6	1.9	45.0	1.8	49.9	1.9
Asetet tjera	64.3	3.3	37.8	1.7	40.7	1.6	46.9	1.8
Gjithsej	1,927.1	100.0	2,218.8	100.0	2,501.0	100.0	2,652.3	100.0

Burimi: BQK (2012)

Aktiviteti financiar i bankave komerciale në Kosovë vazhdon të jetë i përqëndruar në aktivitetin ndërmjetësues brenda ekonomisë së Kosovës, ku kreditë përbëjnë 67 përqind të gjithsej aseteve të sistemit bankar (Tabela 5). Ndërsa, investimet e bankave që operojnë në

Kosovë në tregjet jashtë vendit në qershor 2012 përbënin 21.9 përqind të gjithsej asetëve të sistemit bankar të Kosovës (25.3 përqind në qershor 2011).


Investimet jashtë vendit kryesisht janë në formën e plasmanëve të bankave komerciale që operojnë në Kosovë në bankat jashtë vendit (bilanci me bankat komerciale) dhe si investime në letra me vlerë. Pjesëmarrja e bilancit me bankat komerciale në gjithsej asetet e sistemit bankar u zvogëlua nga 12.8 përqind sa ishte në qershor të vitit 2011, në 10 përqind të gjithsej asetëve në qershor të vitit 2012, që njëherit paraqet edhe pjesëmarrjen më të ulët që nga fillimi i funksionimit të sistemit bankar të Kosovës. Duke shënuar rënie vjetore prej 16.9 përqind, bilanci me bankat komerciale në qershor 2012 arriti vlerën prej 265.3 milionë euro. Investimet në letrat me vlerë gjatë kësaj periudhe ruajtën nivelin prej 8.1 përqind të gjithsej asetëve të sistemit bankar.

Sidoqoftë, jo të gjitha investimet në letra me vlerë paraqesin investime jashtë vendit, duke pasur parasysh faktin se që nga muaji janar 2012, për herë të parë në Kosovë filloi të funksionojë edhe tregu i Bonove të Thesarit, që paraqet një mundësi të re investimi për bankat komerciale në vend (Kutia 2).

## Kutia 2. Tregu i Bonove të Thesarit në Republikën e Kosovës


Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Borxhin Publik në Kosovë (janar 2010) u krijua mundësia e qasjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës në borxh publik. Pas krijimit të bazës ligjore, BQK si agjent fiskal i Qeverisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave ndërtuan infrastrukturën për funksionalizimin e tregut të bonove të thesarit të Qeverisë. Rrjedhimisht, në janar të vitit 2012 u shpall ankandi i parë i letrave me vlerë që nënkupton funksionalizimin e tregut dhe emetimin e bonove të thesarit të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Tregtimi i bonove të thesarit në Kosovë realizohet përmes ankandeve publike, të cilat organizohen dhe monitorohen nga ana e BQK-së. Akterët Primar janë bankat komerciale në Kosovë. Institucionet tjera apo klientët e bankave komerciale, mund të dorëzojnë ofertat e tyre në ankandet e letrave me vlerë vetëm përmes bankave përkatëse në tregun primar. Përveç ofrimit të infrastrukturës teknike, BQK-ja mundëson tregtimin e letrave me vlerë në kushte të një konkurrence të plotë. Ofertat nga akterët primarë mund të jenë konkurruese dhe jo konkurruese. Në ofertat konkurruese, akterët primarë

Figura 21. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë



Burimi: BQK (2012)

Figura 22. Norma e interesit dhe shuma e zbritur në emër të interesit



Burimi: BQK (2012)

ofertojnë shumën dhe normën e interesit, ndërsa në ofertat jo konkurruese ofertuesit pranojnë normën e përcaktuar nga oferta dhe kërkesa e tregut e cila është rezultat i ofertave konkurruese.

Deri në qershor 2012 u mbajtën gjithsej gjashtë ankande për shitjen e letrave me vlerë të qeverisë. Shuma e ofertuar nga Qeveria e Kosovës për çdo ankand ishte 10 milionë euro, ndërsa kërkesa për blerjen e letrave me vlerë vazhdimisht ka tejkaluar shumën e ofertuar (Figura 21). Niveli më i lartë i tejkalimit të shumës së ofertuar ishte në qershor 2012 kur për shumën e ofertuar prej 10 milionë euro, kërkesa e akterëve primarë ishte 35.7 milionë euro.

Norma mesatare vjetore e interesit gjatë kësaj periudhe ishte 3.3 përqind (Figura 22). Në ankandin e muajit mars ishte norma më e lartë e interesit (4.0 përqind), ndërsa niveli më i ulët i normës së interesit ishte në muajin Qershor (2.9 përqind). Afati i maturimit për ankandet e shpallura në periudhën janar - qershor ishte 91 ditë.

Emetimi i bonove të thesarit ndikon pozitivisht në stabilitetin e përgjithshëm financiar, duke promovuar rritjen e efikasitetit në procesin e ndërmjetësimit financiar si dhe duke vendosur bazat për zhvillimin e tregut të kapitalit në vend.


### 6.2.2 Kreditë

Aktiviteti kredidhënës i bankave komerciale vazhdon të përfaqësojë një ndër burimet kryesore të financimit të konsumit dhe investimeve në vend. Përkundër pasigurisë në tregjet financiare globale, perceptimet e bankave në Kosovë për një ambient ekonomik relativisht më stabil kanë ndikuar në rritjen e mëturshme të kredidhënies.

Megjithatë, aktiviteti kredidhënës gjatë kësaj periudhe kishte ritëm më të ngadalshëm të rritjes. Vlera e gjithsej kredive të lëshuara nga sistemi bankar në Kosovë, në qershor 2012, arriti në 1.77 miliardë euro (36.2 përqind e PBB-së), që paraqet një normë vjetore të rritjes prej 9.3 përqind (15.7 përqind në qershor 2011), (Figura 23). Ngadalësimi i rritjes së gjithsej kredive kryesisht ishte rezultat i ngadalësimit të rritjes së kredive për ndërmarrjet (14.1 përqind në qershor 2011; 5.2 përqind në qershor 2012). Bazuar në rezultatet e anketës së BQK-së të realizuar me bankat që operojnë në Kosovë, në tremujorin e dytë të vitit 2012,


del se bankat raportuan rritje të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet e mesme dhe të vogla, ndërsa rënie të kërkesës nga ndërmarrjet e mëdha. Përkundër rritjes së kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, bankat raportuan për shtrëngim të standardeve dhe kritereve të aplikuar në procesin e kreditimit. Sipas bankave, faktorët kryesor që ndikuan në këtë

Figura 23. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Figura 24. Struktura e kredive, në përqindje



Burimi: BQK (2012)


shtrengim ishin perceptimi negativ nga ana e bankave për gjendjen e përgjithshme ekonomike dhe të industrive të veçanta, si dhe rreziku që ndërlihet me realizimin e kolateralit.

Struktura e gjithsej kredive vazhdon të dominohet nga kreditë për ndërmarrjet, pjesëmarrja e të cilave në gjithsej kreditë në gjysmën e parë të vitit 2012 ishte 67 përqind. Megjithatë, siç mund të vërehet nga figura 24, pjesëmarrja e kredive për ndërmarrjet në gjithsej kreditë po shënon një rënie të lehtë. Në anën tjetër, rritja më e ngadalshme e këtyre kredive për ndërmarrjet ka bërë që kreditë për ekonominë familjare të zënë peshë më të madhe në gjithsej kreditë duke rritur pjesëmarrjen në 30.7 përqind të gjithsej kredive.

Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarisë ekonomike ishte e ngjashme me periudhat paraprake. Pjesa më e madhe e kredive për ndërmarrjet në gjysmën e parë të vitit 2012 u absorbua nga kreditë për sektorin e shërbimeve, me pjesëmarrje prej 71.6 përqind. Në kuadër të kredive për sektorin e shërbimeve, pjesa më e madhe i takoi kredive për sektorin e tregtisë, pjesëmarrja e të cilave ishte 51.3 përqind e gjithsej kredive për ndërmarrjet (Figura 25). Me pjesëmarrje të konsiderueshme karakterizohen edhe kreditë e lëshuara për sektorin e industrisë (ku përfshihen kreditë për miniera, prodhimtari, industri dhe ndërtimtari), të cilat përfaqësuan 24.8 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrje.


Sektori i bujqësisë vazhdon të karakterizohet me qasje të ulët në kreditë bankare, duke pranuar vetëm 4 përqind të gjithsej kredive që lëshohen për ndërmarrjet. Kjo tregon se bankat komerciale në Kosovë vazhdimisht kanë treguar qasje konzervative ndaj sektorit të bujqësisë, gjë e cila tregohet edhe nga normat më të larta të interesit që aplikohen për

Figura 25. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje




Burimi: BQK (2012)

Figura 26. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Figura 27. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje




Burimi: BQK (2012)

kreditë lëshuar këtij sektori. Hezitimi i sistemit bankar për të kredituar sektorin e bujqësisë dhe niveli më i lartë i rrezikut të perceptuar për këtë sektor vërehet edhe nga fakti se kreditë aktuale të lëshuara për këtë sektor në masën dërmuese burojnë nga një bankë e vetme.

Struktura e kredive sipas afatit të maturimit vazhdoi të dominohet nga kreditë me afat më të gjatë të maturimit, të cilat gjithashtu u karakterizuan me rritje të pjesëmarrjes në periudhën raportuese (Figura 27). Në qershor 2012, kreditë me afat maturimi mbi dy vite përfaqësuan 69.4 përqind të gjithsej kredive (68.7 përqind në qershor 2011). Prej tyre, pjesa më e madhe e kredive i takoi kredive me afat maturimi prej dy deri në pesë vite, të cilat kishin pjesëmarrje prej 43.9 përqind të gjithsej kredive (41.2 përqind në qershor 2011), pasuar nga kreditë me afat maturimi prej pesë në dhjetë vite të cilat përfaqësuan 24.7 përqind të gjithsej kredive (20.7 përqind në qershor 2011). Në anën tjetër, kreditë me afat maturimi prej një deri në dy vite zvogëluan pjesëmarrjen e tyre nga 7.9 përqind në 7.2 përqind në qershor të vitit 2012.

Figura 28. Trendi i rritjes së kredive sipas maturitetit,



Burimi: BQK (2012)

### 6.2.3 Detyrimet

Aktiviteti financiar i sistemit bankar në Kosovë vazhdon të financohet kryesisht nga burimet e brendshme të financimit, përkatësisht nga depozitat e qytetarëve të Kosovës. Rrjedhimisht, depozitat e sistemit bankar të Kosovës përfaqësojnë kategorinë dominuese në kuadër të detyrimeve të sistemit bankar, me pjesëmarrje prej 79.5 përqind (Tabela 6). Si depozitat, ashtu edhe po thuajse të gjitha kategoritë tjera në kuadër të detyrimeve të sistemit bankar, në gjysmën e parë të vitit 2012 u karakterizuan me ngadalësim në trendin e rritjes. Gjatë kësaj periudhe, vlera e depozitave arriti në 2.1 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.7 përqind (11.8 përqind në qershor të vitit 2011). Mjetet vetanake (kapitali vetanak), që gjithashtu paraqesin një burim të rëndësishëm të financimit për bankat, shënuan rritje vjetore prej 6.6 përqind (7 përqind në qershor 2011), duke arritur vlerën prej 255.8 milionë euro. Në rritjen e mjeteve vetanake kryesisht ndikoi rritja e përshtetshme e kapitalit aksionar prej 6.3 përqind (3.7 përqind në qershor 2011), ndërsa ngadalësimi i rritjes së profitit të mbajtur nga 30.8 përqind në qershor 2011 në 20.9 përqind në qershor të vitit 2012 ndikoi negativisht në rritjen e kapitalit vetanak.

Ngadalësimi i vazhdueshëm i rritjes së depozitave të qytetarëve të Kosovës në vitet e fundit ka ndikuar që bankat komerciale që operojnë në Kosovë të orientohen edhe drejt shfrytëzimit të fondeve tjera, siç janë financimet nga jashtë.

Për shembull, pas një kohe të mosshfrytëzimit të huave tjera (që nga viti 2008), bankat komerciale në vitin 2012 filluan përsëri shfrytëzimin e këtij burimi të financimit, që në qershor 2012 arriti vlerën prej 26.8 milionë euro.



Tabela 6. Struktura e detyrimeve të sistemit bankar

Përshkrimi	Qershor 2009		Qershor 2010		Qershor 2011		Qershor 2012	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	41.8	2.2	65.1	2.9	86.6	3.5	21.3	0.8
Depozitat	1,512.7	78.5	1,751.5	78.9	1,957.8	78.3	2,108.5	79.5
Huatë tjera	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	26.8	1.0
Detyrimet tjera	152.1	7.9	152.4	6.9	183.0	7.3	205.8	7.8
Borxhi i ndërvarur	16.9	0.9	24.4	1.1	33.5	1.3	31.0	1.2
Mjetet vetanake	203.3	10.5	224.3	10.1	239.9	9.6	255.8	9.6
Gjithsej detyrimet	1,927.1	100.0	2,218.8	100.0	2,501.0	100.0	2,652.3	100.0


Burimi: BQK (2012)

Në huatë nga jorezidentët kryesisht bëjnë pjesë huatë e lëshuara nga bankat amë dhe bankat simotra dhe marrëveshjet me afat për rritjen e likuiditetit. Po ashtu, detyrimet tjera shënuan rritje vjetore prej 12.5 përqind. Dy kategori tjera të rëndësishme në kuadër të detyrimeve të sistemit bankar janë edhe borxhi ndërvarur dhe bilanci nga bankat tjera, të cilat në gjysmën e parë të vitit 2012 kishin nivel më të ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Borxhi i ndërvarur shënoi rënie prej 7.5 përqind (rritje për 37.2 përqind në qershor 2011) duke arritur vlerën prej 31 milionë euro. Ndërsa, rënie më të theksuar shënoi vlera e bilancit nga bankat tjera nga 86.6 milionë euro në gjysmën e parë të vitit të kaluar në 21.3 milionë euro në periudhën e njëjtë të këtij viti (rënie për 75.4 përqind).

## 6.2.4 Depozitat

Në qershor 2011, vlera e depozitave në sistemin bankar të Kosovës arriti në 2.1 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.7 përqind. Përkundër rritjes së vazhdueshme, trendi i rritjes së gjithsej depozitave në sistemin bankar është karakterizuar me ngadalësim të normës së rritjes (Figura 29). Ngadalësimi i rritjes së gjithsej depozitave gjatë viteve të fundit deri diku mund të jetë i natyrshëm duke pasur parasysh

Figura 29. Trendi i rritjes së depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

faktin se në vitet e para të funksionimit të sistemit bankar ka pasur fluks më të madh të kursimeve që më parë ishin mbajtur jashtë sistemit bankar e të cilat në mënyrë të vazhdueshme pastaj janë sistemuar si depozita në sistemin bankar. Sidoqoftë, këtij ngadalësimi i kanë kontribuar edhe faktorë të tjerë siç janë tërheqja e depozitave të qeverisë nga bankat komerciale si dhe zhvillimet e ndërlydhura me krizën globale të cilat kanë ndikuar edhe ngadalësimin e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik.

Në gjysmën e parë të vitit 2012, ngadalësimi i rritjes së depozitave erdhi kryesisht si rrjedhojë e zvogëlimit të depozitave të korporatave publike dhe ngadalësimit të rritjes së depozitave të ekonomive familjare dhe depozitave të ndërmarrjeve. Depozitat e ekonomive familjare ngadalësuan trendin e rritjes në 15.5 përqind, krahasuar me rritjen prej 19 përqind në qershor 2011. Trend i ngjashëm u evidentua edhe në rastin e depozitave të

ndërmarrjeve private, të cilat në qershor 2011 shënuan rritje vjetore prej 15.5 përqind, ndërsa në qershor të këtij viti rritja vjetore ishte 13.9 përqind.


Depozitat e ekonomive familjare, të cilat vazhdojnë të përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të bankave komerciale në vend, në gjysmën e parë të vitit 2012 arritën vlerën prej 1.5 miliardë euro dhe përfaqësuan 72.1 përqind të gjithsej depozitave (Figura 30). Depozitat e ndërmarrjeve private arritën vlerën prej 414.3 milionë euro, duke përfaqësuar 19.6 përqind të gjithsej depozitave. Në anën tjetër, depozitat e ndërmarrjeve publike pothuajse u përgjysmuan, duke shënuar vlerën prej 70.8 milionë euro (3.4 përqind e gjithsej depozitave), krahasuar me vlerën prej 118.9 milionë euro në qershor të vitit të kaluar (6.1 përqind e gjithsej depozitave).

Rënie shënuan edhe depozitat e jorezidentëve, të cilat regjistruan vlerën prej 75.9 milionë euro (3.6 përqind e gjithsej depozitave) që është për 23.9 përqind më e ulët se vlera e shënuar në qershor 2011. Depozitat e institucioneve tjera financiare kishin pjesëmarrje të ngjashme me vitin e kaluar (5.5 përqind të gjithsej depozitave), ndërsa vlera e tyre arriti në 115.3 milionë euro dhe shënoi rritje vjetore prej 12.2 përqind. Pjesa kryesore e depozitave të institucioneve tjera financiare përfaqësohet nga depozitat e kompanive të sigurimit dhe depozitat e fondeve pensionale. Në qershor 2012, depozitat e kompanive të sigurimit dhe depozitat e fondeve pensionale përbënin 95.3 përqind të gjithsej depozitave të institucioneve tjera financiare që mbajnë depozita në bankat komerciale. Pjesa tjetër e depozitave të institucioneve tjera financiare prej 4.7 përqind, ndahet mes institucioneve mikrofinanciare dhe ndihmësve tjerë financiarë.

### 6.2.5 Normat e interesit


Në gjysmën e parë të vitit 2012, lëvizja e normave të interesit u karakterizua me një rënie të lehtë për kreditë, ndërsa normat e interesit në depozita mbetën të pandryshuara në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 31). Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar nga 14.3 përqind në periudhën janar-qershor 2011, në 13.7 përqind në periudhën janar-qershor 2012.

Figura 30. Struktura e depozitave sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Figura 31. Mesatarja gjashtëmuajore e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Ndërsa, mesatarja e normës së interesit në depozita mbeti e pandryshuar krahasuar me gjysmën e parë të vitit të kaluar, duke qëndruar në 3.4 përqind. Rrjedhimisht, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita (angl. interest rate spread) u zvogëlua në 10.2pp, nga 10.9pp sa ishte në qershor 2011.

Sipas afatit të maturimit, normat më të larta të interesit u regjistruan për depozitat e ndërmarrjeve me afat maturimi 1 deri në 2 vite, dhe atë për shumat më të vogla se 250 mijë euro, norma mesatare e të cilave ishte 5 përqind. Në kuadër të këtyre depozitave, norma më e ulët e interesit u evidentua në depozitat me afat maturimi deri në një muaj, me një mesatare prej 2.16 përqind. Në kuadër të depozitave të ekonomive familjare, po ashtu norma më e ulët mesatare e interesit u evidentua në depozitat me afat maturimi deri në një muaj (2.46 përqind), ndërsa norma më e lartë e interesit u evidentua tek depozitat me afat maturimi mbi dy vite (5.23 përqind).

Sipas qëllimit të shfrytëzimit të kredisë, kreditë dhënë ndërmarrjeve për qëllime investive mesatarisht kishin norma më të ulëta të interesit, krahasuar me normat e interesit për kreditë dhënë ndërmarrjeve për qëllime tjera të shfrytëzimit. Norma më e ulët mesatare për kreditë investive të ndërmarrjeve ishte për kreditë me afat maturimi mbi pesë vite (11.1 përqind), ndërsa norma më e lartë mesatare e interesit ishte për kreditë me afat maturimi deri në 1 vit (15.6 përqind). Ngjashëm me kreditë investive, kreditë e ndërmarrjeve për qëllime tjera të shfrytëzimit u karakterizuan me norma të ngjashme të interesit, ku kreditë me afat maturimi deri në një vit kishin normat më të larta mesatare prej 17.7 përqind, si dhe kreditë me afat maturimi deri në pesë vite kishin normat më të ulëta mesatare prej 14.4 përqind. Në kuadër të kredive të ekonomive familjare, norma më e ulët e interesit te kreditë për patundshmëri u regjistrua për kreditë me afat maturimi deri në pesë vite (9.9 përqind), ndërsa kreditë me afat maturimi prej pesë deri në dhjetë vite u karakterizuan me normën më të lartë mesatare prej 11.5 përqind.

### **Kutia 3. Zbërthimi i kostos së ndërmjetësimit *ex-post* në sistemin bankar të Kosovës**

Faktorët të cilët ndikojnë në norma të interesit janë të shumtë. Kushtet e tregut, efikasiteti operativ, faktorët institucional dhe rregullimi bankar janë disa nga faktorët kyç që ndërveprojnë dhe ndikojnë në përcaktimin e normës së interesit. Duke u bazuar në metodën e Hansen dhe Rocha (1986), të modifikuar dhe aplikuar në kontekst të Kosovës nga Morina dhe Toçi (2007), është bërë llogaritja e normës *ex-post* të ndërmjetësimit financiar, si dhe kostoja e ndërmjetësimit *ex-post* është zbërthyer në katër komponentë të koston me qëllim të analizimit të pjesëmarrjes së tyre në përcaktimin e normës së interesit për kredi për periudhën 2005-2011.

Aplikimi i kësaj qasje mundëson llogaritjen e normës së ndërmjetësimit që lidhet vetëm me operacionet bankare të kreditimit dhe bazohet në koncepte të kontabilitetit ku të hyrat nga operacionet bankare të kreditimit barazohen me shpenzimet për kreditim dhe fitimin që realizohet.

Norma e interesit për kredi, e cila realisht bartet nga huamarrësit, zbërthehet në normën e kreditimit dhe pagesën e tarifave dhe komisioneve, që njëherit pasqyrojnë të hyrat e bankave nga operacioni i kreditimit. Ndërsa, kostot të cilat i bartin bankat zbërthehen në katër kategori kryesore: kostot e financimit, kostot operationale, kostot e rrezikut dhe ato rregullative. Diferenca ndërmjet normës së llogaritur të ndërmjetësimit dhe komponentëve të koston paraqet mbetjen, e cila ngërthen të hyrat nga operacione tjera bankare dhe gabimet e mundshme në llogaritje si pasojë e supozimeve të bëra nga modeli.

Tabela 7. Zbërthimi i kostos së ndërmjetësimit

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	Mesatarja
<b>Norma e ndërmjetësimit ex-post</b>	<b>15.2</b>	<b>14.6</b>	<b>14.3</b>	<b>14.0</b>	<b>14.1</b>	<b>13.3</b>	<b>12.7</b>	<b>14.0</b>
Norma e kreditimit	13.2	12.5	11.5	11.9	12.4	11.6	11.0	12.0
Tarifat dhe komisionet	2.0	2.2	2.8	2.2	1.8	1.7	1.7	2.0
<b>Kostoja ex-post</b>	<b>11.2</b>	<b>12.3</b>	<b>12.3</b>	<b>13.3</b>	<b>13.0</b>	<b>13.1</b>	<b>13.2</b>	<b>12.6</b>
Kosto e financimit	1.8	2.2	2.3	3.0	3.0	2.8	2.8	2.6
Kosto operacionale	5.0	4.7	4.9	4.8	3.9	3.6	3.7	4.4
Kosto e rrezikut	3.9	4.7	4.4	4.7	5.7	6.3	6.4	5.2
Kosto rregullative	0.5	0.7	0.7	0.8	0.4	0.4	0.4	0.6
Taksat	0.3	0.6	0.5	0.6	0.1	0.2	0.2	0.4
Rezervat	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
Artikujt e memorandumit/ Diferenca								
<b>Mbetja</b>	<b>4.0</b>	<b>2.4</b>	<b>2.0</b>	<b>0.7</b>	<b>1.2</b>	<b>0.2</b>	<b>-0.5</b>	<b>1.4</b>
Profiti	1.4	1.7	2.3	1.4	1.2	1.3	1.4	1.5

Burimi: BQK (2012)

Në Tabelën 1 mund të shihet se *ex-post* norma e ndërmjetësimit ka pasur trend të lehtë rënës. Në vitin 2011, norma e kreditimit ishte 10.97 përqind, ndërsa ajo e tarifave dhe komisioneve 1.7 përqind, duke dhënë kështu normën e përgjithshme të ndërmjetësimit prej 12.67 përqind, e cila është për 2.5pp më e ulët se sa në vitin 2005 dhe 0.6pp më e ulët se sa në vitin paraprak.


Struktura e kostos së ndërmjetësimit ka pësuar ndryshime gjatë periudhës 2005-2011, ku vërehet se pjesëmarrja e kostove operacionale, të cilat kishin pozitë dominuese deri në vitin 2008, është zvogëluar gradualisht për të u tejkualuar nga kostot e rrezikut (Figura 32).

Rrjedhimisht, faktorët me

pjesëmarrjen më të madhe në koston e ndërmjetësimit në vitin 2011 ishin faktorët e rrezikut me 6.38pp. Arsyeja e rritjes së pjesëmarrjes së këtyre kostove është rritja e shpenzimeve për provizione të humbjeve në kredi, të cilat janë rritur më shumë se rritja e vëllimit të kredive (Figura 33). Kjo rritje pjesërisht mund të jetë si pasojë e krizës së sektorit financiar dhe real në nivel global dhe implikimeve të saj në ekonominë e Kosovës, ku norma e kredive joperformuese u rritë në 5.9 dhe 5.8 përqind në vitin 2010 dhe 2011, krahasuar me 3.3 dhe 4.3 përqind sa ishin në vitin 2008 dhe 2009, respektivisht.

Kostot operacionale, të cilat në vitin 2011 ishin 3.7 përqind, zënë pozitën e dytë për nga pjesëmarrja në koston e ndërmjetësimit. Krahasuar me vitin 2005, kur pjesëmarrja ishte 5 përqind, këto kosto janë zvogëluar duke reflektuar kështu rritjen graduale të efikasitetit operativ të sistemit bankar në Kosovë.

Figura 32. Ex-post kosto e financimit, operacionale dhe e rrezikut




Burimi: BQK (2012)

Kostot e financimit, që përfaqësojnë normën e interesit në depozita, kanë pasur tendencë rritëse deri në vitin 2008, kur edhe filluan të zvogëlohen. Megjithatë, pjesëmarrja e këtyre kostove, që vazhdojnë të jenë në pozitën e tretë në strukturën e kostos së ndërmjetësimit, në vitin 2011 patën kontribut më të lartë se në vitin 2005.

Kostot rregullative, që në vete ngërthejnë koston e taksave dhe rezervave të sektorit bankar, kanë pasur trend rënës, duke zbritur pjesëmarrjen e tyre në koston totale në 0.38 pikë të përqindjes në vitin 2011 nga 0.5 pikë të përqindjes sa ishin në vitin 2005. Përderisa kosto e rezervave të detyrueshme ka qenë stabile, ky

ndryshim vjen kryesisht si rezultat i zvogëlimit të koston së taksave, që përkon me përgjysmimin e normës tatimore në të ardhura të korporatave që hyri në fuqi në fillim të vitit 2009.

Figura 33. Raporti ndërmjet provizioneve për humbje nga kreditë dhe bruto kredive




Burimi: BQK (2012)

### 6.3. Performanca dhe Rreziqet e Sistemit Bankar

Performanca e sistemit bankar në Kosovë vazhdon të jetë pozitive, përkundër ambientit jo të favorshëm ekonomik në nivel global. Megjithatë, zhvillimet në ekonominë globale ndikuan në ngadalësimin e rritjes ekonomike edhe në Kosovë, duke u reflektuar kështu në rënie të treguesve kryesorë të profitabilitetit dhe rritjen e lehtë të rreziqeve të sektorit bankar të Kosovës për periudhën qershor 2011 – qershor 2012 (Figura 34). Profitabiliteti i

Figura 34. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK (2012)

sektorit bankar të Kosovës shënoi rënie krahasuar me periudhën paraprake, kryesisht për shkak të ngadalësimit të rritjes së të hyrave. Më gjithë rënie e profitabilitetit, bankat që operojnë në Kosovë kanë udhëhequr politika të matura dhe adekuate të menaxhimit të rreziqeve që i kanosen sistemit bankar, duke ndikuar kështu që sistemi bankar i Kosovës të vazhdojë të ketë qëndrueshmëri të lartë. Niveli i likuiditetit të sistemit bankar vazhdon të jetë mjaft i kënaqshëm, përkundër tendencës së lehtë rënëse të treguesve kryesorë të likuiditetit. Shkalla e rezervave të bankave komerciale të mbajtura në Bankën Qendrore vazhdon të mbetet më e lartë se ajo e kërkuar, duke dëshmuar kështu aftësinë e sistemit bankar për përmbushjen në kohë të detyrimeve afatshkurtra. Për më tepër, struktura e aseteve gjithëpërfshirëse që dominohet nga asetet likuide themelore siguron shkallë të lartë të likuiditetit të sistemit bankar të Kosovës. Rreziku kreditor, përkundër rritjes së lehtë si pasojë e përkeqësimit të cilësisë së portofolit kreditor, vazhdoi të menaxhohet mirë nga bankat, të cilat vazhduan të mbajnë vlerën e provizioneve për humbje nga kreditë në nivel më të lartë se sa vlera e tërësishme e kredive joperformuese. Gjithashtu, niveli i


kapitalizimit të sistemit bankar të Kosovës, që reflekton aftësinë solvente të sistemit, vazhdon të jetë mjaft i kënaqshëm, duke tejkaluar dukshëm normën minimale të përcaktuar nga BQK dhe rregullativat ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, sistemi bankar i Kosovës vazhdon të karakterizohet me shkallë të ulët të rrezikut të likuiditetit, rrezikut kreditor dhe rrezikut të solvencës, duke u radhitur kështu ndër sistemet bankare më të qëndrueshme në rajon, marrë parasysh poashtu edhe rritjen e vazhdueshme të kredive dhe depozitave.

### 6.3.1 Performanca e sistemit bankar

Deri në qershor 2012, sistemi bankar i Kosovës raportoi profit neto prej 10.2 milion euro, që është për 31.2 përqind më i ulët krahasuar me qershor 2011 (Figura 35). Zvogëlimi i profitit të sistemit bankar ishte kryesisht pasojë e rritjes më të shpejtë të shpenzimeve krahasuar me të hyrat e përgjithshme. Të hyrat e përgjithshme të sistemit bankar arritën vlerën 124.2 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.2 përqind (Figura 36). Struktura e të hyrave vazhdon të dominohet nga interesi në kredi që në qershor 2012 kishte një pjesëmarrje prej 78.0 përqind në gjithsej të hyrat e sistemit bankar (Figura 37).


Ngadalësimi i rritjes së kreditimit të ekonomisë nga sistemi bankar u reflektua edhe në ngadalësimin e rritjes së të hyrave nga interesi. Të hyrat nga interesi në kredi, që paraqesin burimin kryesor të të hyrave për bankat në Kosovë, arritën në 96.9 milion euro në qershor 2012, një rritje vjetore prej 7.8 përqind (9.9 përqind në qershor 2011) (Figura 38). Me përjashtim të të hyrave që janë realizuar nga investimet në letra me vlerë, të gjitha kategoritë e të hyrave nga interesi janë karakterizuar me rritje më të ngadalshme krahasuar

Figura 35. Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve, në milionë euro




Burimi: BQK (2012)

Figura 36. Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve



Burimi: BQK (2012)


Figura 37. Struktura e të hyrave sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2012)


me vitin paraprak. Në qershor 2012, të hyrat nga investimet në letra me vlerë u rritën me 60.8 përqind (21.5 përqind në qershor 2011). Rritja e të hyrave nga investimet në letra me vlerë u ndikua kryesisht nga rritja e vazhdueshme e mjeteve të investuara nga bankat komerciale në letra me vlerë. Në kategorinë e të hyrave të përgjithshme të sistemit bankar hyjnë edhe të hyrat nga jo-interesi, të cilat në vitin 2012 shënuan vlerën prej 23.1 milionë euro (21.1 milionë euro në qershor 2011). Kjo kategori e të hyrave kryesisht përbëhet prej të hyrave nga tarifat dhe komisionet në produktet bankare, që në qershor 2012 arritën vlerën 21.5 milion euro (19.4 milion euro në qershor 2011). Në qershor 2012, shpenzimet e sektorit bankar arritën vlerën prej 111.6 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 14.9 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 16.0 përqind në qershor 2011. Ngadalësimi i rritjes ishte i pranishëm në të gjithë zërat e shpenzimeve bankare, me përjashtim të shpenzimeve të interesit që shënuan rritje vjetore prej 11.1 përqind në qershor 2012 (rënie vjetore për 3.6 përqind në qershor 2011) (figura 39). Në kuadër të shpenzimeve të interesit, duhet të veçojmë shpenzimet e interesit në depozita, që shënuan rritje vjetore prej 13.0 përqind dhe kontribuan në rritjen e shpenzimeve të interesit me 11.6 pp (Figura 40). Rritja e shpenzimeve të interesit në depozita ishte kryesisht rrjedhojë e rritjes së normave të interesit në depozita si dhe vazhdimisht të rritjes së vetë depozitave. Në kuadër të shpenzimeve të jointeredit, shpenzimet e provizioneve për mbulimin e humbjeve potenciale nga kreditë vazhduan të rriten. Në qershor 2012, shpenzimet për provizione arritën në 27.5 milion euro, një rritje prej 39.5 përqind. Rritja e shpenzimeve për

Figura 38. Normat vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive




Burimi: BQK (2012)

Figura 39. Rritja e shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Figura 40. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2012)


humbjeve potenciale nga kreditë vazhduan të rriten. Në qershor 2012, shpenzimet për provizione arritën në 27.5 milion euro, një rritje prej 39.5 përqind. Rritja e shpenzimeve për

provizionet kryesisht i atribuohet rritjes së kredive joperformuese në sektorin bankar gjatë kësaj periudhe, gjë që ndikoi që bankat të ndajnë mjete shtesë për të mbuluar humbjet potenciale. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative mbeten kategoria dominuese në kuadër të gjithsej shpenzimeve të sistemit bankar (44.5 përqind të gjithsej shpenzimeve deri në qershor 2012), megjithëse të gjithë zërat në këtë kategori të shpenzimeve bankare përcollën një trend të ngadalësuar të rritjes (Figura 41). Krahasuar me qershorin e vitit të kaluar, shpenzimet e personelit përcollën një trend më të ngadalësuar të rritjes në qershor 2012 kryesisht si pasojë e ngadalësimit të rritjes së numrit të të punësuarve në sistemin bankar në vend. Shpenzimet e personelit u rritën me 3.5 përqind në qershor 2012 (8.9 përqind në qershor 2011).

**6.3.2. Profitabiliteti dhe Efikasiteti i sistemit bankar**


Zvogëlimi i profitit neto u reflektua edhe në përkeqësimin e treguesve të profitabilitetit të sistemit bankar, siç janë Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return on Average Asset: ROAA) dhe Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity: ROAE). Në qershor 2012, ROAA shënoi rënie, duke zbritur në 0.8 përqind krahasuar me 1.2 përqind në qershor 2011 (Figura 42). Me rënie u karakterizua edhe norma e ROAE, që zbriti në 8.1 përqind krahasuar me 12.9 përqind në qershor 2011. Rritja më e shpejtë e shpenzimeve krahasuar me të hyrat në sistemin bankar në vend ka ndikuar edhe në përkeqësimin e indikatorëve të efikasitetit për sistemin bankar. Raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave u ngrit në 89.9 përqind në qershor 2012 nga 85.4 përqind sa ishte në qershor 2011 (figura 43). Megjithatë, sistemi bankar në vend

Figura 41. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: BQK (2012)

Figura 42. Treguesit e profitabilitetit



Burimi: BQK (2012)

Figura 43. Raporti shpenzime/të hyra, në përqindje



Burimi: BQK (2012)



shënoi përmirësim për sa i përket gjenerimit të të hyrave në raport me asetet. Kjo tregohet përmes raportit ndërmjet të hyrave dhe gjithsej asetëve të sistemit bankar, që në qershor 2012 shënoi rritje të lehtë në 4.68 përqind nga 4.59 përqind sa ishte në qershor të vitit 2011.

**Tabela 8. Treguesit e efikasitetit të sistemit bankar, në mijëra euro**

Përshkrimi	Qershor 2008	Qershor 2009	Qershor 2010	Qershor 2011
Asete/nr. i punëtorëve	503.6	637.9	684.4	714.3
Profiti/nr. i punëtorëve	3.2	5.4	4.1	2.8
Numri i kredive/nr. i punëtorëve	66.6	75.8	92.3	113.4
NIM (në përqindje)	3.4	3.0	2.6	2.7

Burimi: BQK (2012)

Ngadalësimi i rritjes së gjithsej asetëve të sistemit bankar ndikoi që edhe vlera mesatare e asetëve të menaxhuara nga një punëtor të jetë më e vogël krahasuar me vitin paraprak. 4.4 përqind nga 7.3 përqind sa ishte në qershor 2011. Në anën tjetër, numri mesatar i kredive të lëshuara për një punëtor u rrit me 22.9 përqind në qershor 2012 krahasuar me rritjen vjetore prej 21.8 përqind në qershor 2011.

Margjina Neto e Interesit (angl. Net Interest Margin: NIM) në qershor 2012 ishte 2.8 përqind, që paraqet një rritje të lehtë krahasuar me vitin e kaluar kur kjo normë qëndroi në 2.7 përqind (Tabela 8).

## 6.4. Rreziqet e Sistemit Bankar

### 6.4.1 Rreziku i likuiditetit

Shkalla e likuiditetit në sistemin bankar të Kosovës vazhdoi të qëndrojë në nivel të lartë edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2012. Të gjithë indikatorët mbi likuiditetin e sistemit u mirëmbajtën në nivele të kënaqshme dhe në pajtueshmëri me rekomandimet e BQK-së. Gjendja e kënaqshme e likuiditetit konfirmohet edhe me anë të analizës stres-test, rezultatet e së cilës sugjerojnë se edhe në skenarët më të ashpër të lëvizjes së depozitave problemet e mundshme me likuiditet do të ishin të përballueshme nga ana e sistemit bankar, dhe të izoluara në banka individuale. Duke marrë parasysh treguesit e likuiditetit si dhe vazhdimin e rritjes së qëndrueshme të depozitave në sistemin bankar, që reflekton edhe besimin e qëndrueshëm të qytetarëve në këtë sistem, rreziku i likuiditetit në sistemin bankar të Kosovës vazhdon të konsiderohet i ulët.

Niveli i lartë i mjeteve likuide dhe ekspozimi i ulët ndaj rrezikut të likuiditetit lidhet drejtpërdrejtë me strukturën e aktivitetit të sistemit bankar të Kosovës i cili konsiderohet të jetë një sistem i bazuar në aktivitetet e bankingut tradicional, me kreditë dhe depozitat si përbërësit kryesor të bilancit të gjendjes së sistemit. Mbështetja e lartë në depozita si burim financimi ka bërë që bankat të kenë një burim më stabil të financimit dhe mos të bazohen në fonde afatshkurtëra, oferta e të cilave është më e luhatshme dhe kanë kosto më

të lartë të financimit, sidomos në kohët e vështirësive ekonomike dhe financiare si këto nëpër të cilat po kalojnë ekonomitë e vendeve të zhvilluara.


Depozitat vazhdojnë të përbëjnë afër 80 përqind të detyrimeve të bankave komerciale, përderisa në anën tjetër 67 përqind e aseteve përbëhet nga kreditë. Në qershor 2012, raporti kredi/depozita qëndronte në 83.2 përqind, që paraqet një tejkalim të lehtë të nivelit prej 80% të rekomanduar nga Banka Qendrore (Figura 44). Megjithatë, nga figura 44 është evidente ekzistenca e faktorit

sezonal (sezonaliteti) në trendin e këtij raporti. Gjatë pesë viteve të fundit shihet qartë se mesi i vitit në vazhdimësi është karakterizuar me një nivel më të lartë të raportit kredi/depozita, i cili në pjesën e mbetur të vitit pastaj është rikthyer në nivelin e rekomanduar nga Banka Qendrore. Ky sezonalitet kryesisht ndërlidhet me rritjen më të shpejtë të depozitave gjatë gjysmës së dytë të vitit.

Një indikator tjetër me rëndësi për vlerësimin e likuiditetit të sistemit bankar është edhe vlera e tërësishme e aseteve likuide në raport me gjithsej asetet e sistemit. Edhe pse indikatorët mbi asetet likuide patën një ulje të lehtë krahasuar me qershorin 2011, në përgjithësi konsiderohet se vlera e aseteve likuide në sistemin bankar të Kosovës është mjaft e lartë. Në qershor 2012, asetet likuide 'themelore'<sup>5</sup> (angl. core liquid assets) përbënin 22.6 përqind të gjithsej aseteve (24.3 përqind në qershor 2011), ndërsa asetet likuide 'gjithëpërfshirëse' (angl. broad liquid assets) përbënin 28.9 përqind të gjithsej aseteve, krahasuar me 29.8 përqind në qershor 2011. Ky zvogëlim i pjesëmarrjes së aseteve likuide në gjithsej asetet kryesisht i atribuohet zvogëlimit të mjeteve të cilat investoheshin në formë të plasmanëve nga bankat që operojnë në Kosovë të bankat jashtë vendit. Në qershor 2012, këto plasmane përbënin 10 përqind të gjithsej aseteve, apo 2.8pp më pak se në qershor 2011.


Si një matës i mirë i shkallës së likuiditetit të sistemit bankar është edhe raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra<sup>6</sup> (Figura 45). Raporti i aseteve likuide 'themelore' ndaj detyrimeve afatshkurtëra në qershor 2012 ishte 28.3 përqind (31.1 përqind në qershor

Figura 44. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Figura 45. Raporti asete likuide "broad"/detyrime afatshkurtëra



Burimi: BQK (2012)

<sup>5</sup> Asetet likuide 'core' përfshijnë paranë e gatshme dhe bilancin në BQK, si dhe llogaritë rrjedhëse në bankat tjera dhe plasmanet në bankat tjera me maturitet deri në 90 ditë. Asetet likuide broad' përfshijnë asetet likuide 'core' si dhe asetet e tregtueshme dhe letrat me vlerë me maturitet deri në 90 ditë.


<sup>6</sup> Detyrimet afatshkurtëra përfshijnë depozitat, huamarrjet afatshkurtëra dhe detyrimet tjera me maturitet deri në një vit.

2011), përderisa raporti i aseteve likuide ‘gjithëpërfshirëse’ ndaj detyrimeve afatshkurtëra ishte 36.2 përqind (38.1 përqind në qershor 2011). Edhe pse vërehet një rënie e këtyre indikatorëve krahasuar me vitin e kaluar, nivelet aktuale konsiderohen të jenë mjaft të larta dhe të kënaqshme sa i përket ruajtjes së aftësisë së sistemit për t’u ballafaquar me rrezikun e likuiditetit.

Jo vetëm që treguesit e lartpërmendur janë në nivele të favorshme, por edhe nëse e analizojmë përmbajtjen e aseteve likuide më në detaje shihet se bankat vazhdimisht kanë treguar kujdes të lartë për sa i përket strukturës së investimeve. Investimet në letra me vlerë përbëjnë 8.1 përqind të gjithëj aseteve të sistemit bankar, dhe përveç në tregjet e jashtme një pjesë e tyre tani më investohet edhe në Kosovë.

Investimet e bankave në tregjet e jashtme kryesisht janë bërë në investime që konsiderohen të kenë shkallë të lartë të sigurisë, si për nga lloji i produktit ashtu edhe për nga vendi ku janë investuar. Struktura e investimeve të bankave në letra me vlerë kryesisht përqendrohet në tri kategori kryesore: fletëobligacione të qeverive, të korporatave financiare dhe korporatave jo-financiare.

Figura 46. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Sa i përket vendeve ku janë të investuara, bankat janë kryesisht të orientuara në letrat me vlerë të qeverive të vendeve me një stabilitet më të qëndrueshëm financiar, si: Gjermania, Franca, Austria e Shtetet e Bashkuara të Amerikës.


Mjetet e investuara në tregjet e jashtme mirëmbajtën strukturën e tri viteve të fundit (të iniciuar në fundin e vitit 2009), ku pjesa më e madhe e tyre është investuar në fletëobligacione qeveritare e më pak në ato të korporatave financiare (Figura 46). Në qershor 2012, 76.1 përqind e letrave me vlerë përbëheshin nga fletëobligacionet e lëshuara nga qeveritë e huaja, dhe 10 përqind nga fletëobligacionet e korporatave financiare. Përderisa për dallim nga vitet paraprake, kur një pjesë shumë e vogël e mjeteve të investuara në letra me vlerë investohej edhe në fletëobligacione të korporatave jo-financiare (një mesatare prej 0.5 përqind e gjithëj investimeve në letra me vlerë), gjatë vitit 2012 bankat nuk investuan pothuajse fare në këto fletëobligacione.

Që nga fillim i vitit 2012, përpos tregjeve të jashtme, bankat në Kosovë kanë edhe një mundësi tjetër investimi, në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe kjo mundësi e re është mirëpritur nga bankat që operojnë në Kosovë. Në qershor 2012, 13.8 përqind e mjeteve të investuara në letra me vlerë përbëhej prej bonove të thesarit të lëshuara nga Qeveria e Kosovës (Figura 46).

Me këtë strukturë të investimeve në letra me vlerë, kryesisht në fletëobligacione qeveritare të cilat konsiderohen me rrezik më të ulët, ekspozimi i bankave komerciale të Kosovës ndaj rrezikut të likuiditetit është minimizuar. Mirëpo nga ana e përfitimit, rreziku më i ulët do të thotë edhe kthim më të ulët, gjë që karakterizon momentalisht sistemin bankar të Kosovës.

Se sistemi bankar i Kosovës ka ekspozim të ulët ndaj rrezikut të likuiditetit konfirmohet edhe me mirëmbajtjen e vazhdueshme të rezervave të likuiditetit në nivel më të lartë se niveli minimal i kërkuar nga BQK (Figura 47). Në qershor 2012, vlera totale e rezervave të likuiditetit të sistemit bankar ishte 310.3 milionë euro, duke tejkaluar kështu rezervën e detyrueshme për afër 70 përqind (rezerva e detyrueshme për sistemin ishte 182.8 milionë euro). Përveç efektit në zvogëlimin e rrezikut të likuiditetit, mbajtja e rezervave të tepërta nënkupton edhe kosto për bankat duke pasur parasysh faktin se bankat përfitojnë interesin e përcaktuar nga BQK-ja vetëm për shumën e rezervës së detyrueshme, përderisa çdo shumë që tejkalon rezervën e detyrueshme nuk kompensohet me interes.


Figura 47. Rezervat e sistemit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Një tjetër mënyrë e vlerësimit të rrezikut të likuiditetit është analiza e hendekut të likuiditetit (angl. liquidity gap analysis), përmes së cilës vlerësohet mjaftueshmëria e aseteve me një afat të caktuar maturimi për përmbushjen e detyrimeve me po atë afat maturimi. Megjithatë, duhet pasur parasysh se roli kryesor i biznesit bankar mbetet ndërmjetësimi në mes të depozitorëve dhe kredimarrësve, andaj sistemi bankar në përgjithësi detyrimet afat-shkurtëra (depozitat) i konvertton në asete afat-gjata (kreditë). Analiza bazohet në idenë se vlera e aseteve që maturojnë brenda afatit të caktuar duhet të përputhet me vlerën e detyrimeve që maturojnë brenda të njëjtit afat. Dallimi në mes këtyre dy shumave paraqet hendekun apo mospërputhjen e maturitetit. Rezultatet e paraqitura në figurën 48. lexohen duke konsideruar se hendeku pozitiv nënkupton se vlera e aseteve është më e madhe se vlera e detyrimeve brenda afatit të caktuar të maturimit; përderisa hendeku negativ nënkupton të kundërtën: vlera e aseteve është më e vogël se vlera e detyrimeve brenda afatit të caktuar të maturimit<sup>7</sup>. Duke pasur parasysh faktin se në sistemin bankar të Kosovës pjesa më e madhe e aseteve përbëhet nga kreditë si dhe pjesa më e madhe e detyrimeve përbëhet nga depozitat, atëherë mospërputhja e afatit të maturimit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve kryesisht pasqyron dallimet në mes të afatit të maturimit të kredive dhe depozitave.

Figura 48. Hendeku i likuiditetit, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

<sup>7</sup> Maturiteti i aseteve dhe detyrimeve ndahet në këto periudha: 1 deri 7 ditë, 8 deri 30 ditë, 91 deri në 180 ditë, 181 deri në 365 ditë dhe më shumë se 1 vit.


Mospërputhja në maturitet vazhdon të jetë e ngjashme me vitet paraprake. Në qershor 2012, mospërputhja më e theksuar e afatit të maturimit ishte në kategorinë ‘më shumë se 1 vit’, ku vlera e asetëve në tejkalon vlerën e detyrimeve për 446.3 milionë euro (Figura 48). Krahasuar me qershorin 2011, vërehet një përmirësim në hendekun e likuiditetit në kategorinë e maturimit ‘185-365 ditë’ i cili vazhdon të jetë pozitiv por më i ulët se sa në vitin e kaluar (53.5 milionë euro krahasur me 70.4 milionë euro në qershor 2011). Ndërsa, për tri kategoritë e para ku përfshihen mjetet dhe detyrimet me maturitet deri në 90 ditë, ashtu siç edhe pritet, hendeku ka vazhduar të jetë negativ për faktin se kreditë kryesisht kanë maturitet më të gjatë se tre muaj. Në mënyrë që të zbutet paksa kjo mospërputhje në mes të afateve të maturimit të kredive dhe depozitave, bankat do të duhej të përqendroheshin në tërheqjen e detyrimeve (depozitave) me afat më të gjatë maturimi.

### 6.4.2 Rreziku kreditor

Rritja më e ngadalshme e ekonomisë së Kosovës gjatë vitit 2012 është reflektuar edhe në rritjen e kredive të sistemit bankar, e cila ishte dukshëm më e ngadalshme krahasuar me vitet e mëparshme. Këto zhvillime u reflektuan edhe në cilësinë e portofolit kreditor. Raporti ndërmjet Kredive Joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) dhe gjithsej kredive në qershor 2012 arriti në 6.5 përqind nga 5.9 sa ishte në qershor 2011.


Kjo rritje e NPL-ve paraqet përkeqësim të cilësisë së portofolit kreditor, gjë që nënkupton rritje të rrezikut kreditor në sistemin bankar në vend. Megjithatë, rritja e raportit të NPL-ve ndaj gjithsej kredive nuk paraqet në tërësi dobësim të aftësisë paguese të kredimarrësve. Kjo rritje po ashtu ka të bëjë me ngadalësimin e rritjes së kredive në përgjithësi. Figura 51 tregon se vlera e NPL-ve poashtu ka shënuar ngadalësim të theksuar të rritjes, gjë e cila nënkupton se rritja e raportit ndërmjet NPL-ve dhe gjithsej kredive para se gjithash është pasojë e ngadalësimit më të theksuar të rritjes së gjithsej kredive dhe jo si rezultat i ndonjë rritje të theksuar të vlerës së NPL-ve. Me gjithë rritjen e raportit të NPL-ve, sistemi bankar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të lartë të qëndrueshmërisë, duke u mbështetur në nivelin e lartë të kapitalizimit që ka. Kjo tregohet edhe nga analiza stres-test, rezultatet e së cilës sugjerojnë se niveli i lartë i

Figura 49. Struktura e kredive sipas klasifikimit



Burimi: BQK (2012)


Figura 50. Raporti NPL/gjithsej kredite, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

kapitalizimit të bankave bënë që ato të jenë në gjendje të përballojnë nivele edhe më të larta të NPL-ve duke mos u ballafaquar me nevojën për rikapitalizim. E tërë kjo tregon se sistemi bankar i Kosovës është në gjendje të mirë për sa i përket rrezikut kreditor, duke nënkuptuar aftësinë e këtij sistemi që të vazhdojë së përkrahuri ekonominë e vendit përmes aktivitetit kreditor. Në këtë kontekst, është me rëndësi që aktiviteti kreditor i bankave në Kosovë të zhvillohet duke u bazuar sa më tepër në rrethanat në ekonominë e Kosovës, duke shmangur kështu formimin e perceptimeve të bazuara në zhvillimet në sektorin e jashtëm të cilat mund të mos jenë në përputhje me zhvillimet reale në ekonominë e Kosovës.

Figura 51. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve




Burimi: BQK (2012)

Të dhënat nga figura 49 tregojnë se në periudhën qershor 2011 – qershor 2012 ka ndodhur një migrim i lehtë i kredive nga kategoritë me cilësi më të mirë drejtë kategorive me cilësi më të dobët. Si rezultat i kësaj, pjesëmarrja e kredive me probleme (kategoritë: nënstandarde, të dyshimta, dhe të humbura) në gjithsej kreditë e sistemit bankar ka arritur në 9.5 përqind (8.2 përqind në qershor 2011).

Kreditë joperformuese, të cilat përbëhen nga kreditë e kategorizuara si të dyshimta dhe të humbura, në qershor 2012 rritën pjesëmarrjen në 6.5 përqind të gjithsej kredive (5.9 përqind në qershor 2011), raport ky që paraqet nivelin më të lartë të NPL-ve që nga fillimi i funksionimit të sistemit bankar në Kosovë (Figura 50). Rritja e raportit të NPL-ve për sistemin bankar reflekton rritjen e këtij raporti tek shumica e bankave që operojnë në Kosovë, por duhet theksuar faktin se në të njëjtën kohë kishte banka që kanë përmirësuar raportin ndërmjet NPL-ve dhe gjithsej kredive. Në rritjen e raportit ndërmjet NPL-ve dhe gjithsej kredive, krahas rritjes së shumës së NPL-ve, ndikim të theksuar pati edhe ngadalësimi i rritjes së kredive në përgjithësi, që madje mund të konsiderohet edhe si faktori kryesor në rritjen e raportit të NPL-ve. Kjo me që vlera e NPL-ve nuk shënoi ndonjë përshpejtim të trendit të rritjes, por madje shënoi një normë të rritjes dukshëm më të ulët se sa në vitin e kaluar (figura 51). Në qershor 2012, vlera e NPL-ve të sistemit bankar arriti në 113.7 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 20.7 përqind, përderisa rritja vjetore e shumës së NPL-ve në qershor 2011 ishte 51.5 përqind. Në të njëjtën kohë, rritja vjetore e gjithsej kredive ishte 9.3 përqind, e

Figura 52. Struktura e kredive joperformuese, në përqindje



Burimi: BQK (2012)


cila paraqet një ngadalësim mjaft të theksuar kur merret parasysh norma e rritjes prej 15.7% përqind në qershor 2011. Sa i përket strukturës së NPL-ve kreditë e kategorizuara si të humbura vazhdojnë të përbëjnë pjesën më të madhe krahas kredive të dyshimta. Gjatë vitit të fundit vërehet një zhvendosje e një pjese të kredive të dyshimta në ato të humbura (Figura 52). Në qershor 2012, 67 përqind e NPL-ve të sistemit bankar janë klasifikuar si të humbura.

Për sa i përket strukturës së NPL-ve sipas sektorëve të kreditimit vërehet një rritje e NPL-ve në secilin nga sektorët. Nga figura 53 është e qartë se rritja më e madhe dhe njëkohësisht niveli më i lartë i raportit të NPL-ve ndaj gjithsej kredive të sektorëve të caktuar paraqitet në sektorin e prodhimitarisë, ku 13.5 përqind të kredive në këtë sektor janë të klasifikuara si NPL. Rritje mjaft e theksuar e pjesëmarrjes së NPL-ve vërehet edhe në sektorin e shërbimeve të hotelierisë, ku pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e këtij sektori gati se u dyfishua (nga 5.4 përqind në qershor 2011 arriti në 10.4 përqind në qershor 2012). Sidoqoftë, ngjashëm me rritjen e raportit të pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë e sistemit bankar, edhe te këta sektorë rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve kryesisht reflekton ngadalësimin e rritjes së gjithsej kredive, përderisa vlera nominale e NPL-ve ka shënuar trend të ngjashëm të rritjes me vitet e kaluara.

Dy sektorët më të rëndësishëm, sa i përket kredihënies mbeten tregtia dhe ekonomitë familjare. Andaj ekspozimi dhe cilësia e kredive të këtyre dy sektorëve janë përcaktuesit kryesorë të cilësisë së portfolios kreditore në përgjithësi për sistemin bankar. Figura 53 tregon se rritje më të theksuar të raportit të NPL-ve kishte në sektorin e tregtisë, ku nga gjithsej vlera e kredive të kësaj kategorie 9.0 përqind janë klasifikuar si NPL (6.4 përqind në qershor 2011). Ndërsa, vetëm 2.5 përqind e kredive të ekonomive familjare janë cilësuar si jo-performuese (1.8 përqind në qershor 2011). Niveli i ulët i NPL-ve në sektorin e ekonomive familjare sugjeron se rritja e nivelit të NPL-ve të sistemit bankar kryesisht i atribuohet cilësisë së kredive të ndërmarrjeve.


Përkundër rritjes së NPL-ve, bankat në Kosovë kanë vazhduar të jenë të kujdesshme në mirëmbajtjen e mbulimit të NPL-ve me provizione për humbje nga kreditë. Vlera e mjeteve të ndara për provizione ka vazhduar të jetë më e lartë se vlera e tërësishme e NPL-së (figura 54). Në qershor 2012, provizionet për mbulimin

Figura 53. NPL-të sipas sektorëve



Burimi: BQK (2012)

Figura 54. NPL-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2012)

e humbjeve nga kreditë tejkaluan për 17.3 përqind vlerën e tërësishme të kredive të klasifikuara si NPL, nivel ky i ngjashëm me qershorin e vitit 2011.

#### Kutia 4. Ngarkesa me Borxh dhe Performanca e Kredive të Klientëve Mikrokreditor në Kosovë<sup>8</sup>

Fondi Evropian për Evropën Juglindore (angl. European Fund for Southeast Europe: EFSE), gjatë periudhës Prill-Tetor 2012, realizoi studimin e radhës, objektiv kryesor i të cilit ishte vlerësimi i nivelit të ngarkesës me borxh për klientët e sektorit financiar në Kosovë dhe identifikimin e faktorëve që mund të ndikojnë në rrezikun e paraqitjes së problemit të mbingarkesës së huamarrësve me borxh. Ky studim përfshiu një mostër prej 2,200 huamarrësve nga gjithsej nëntë institucione financiare (banka komerciale dhe institucione mikrofinanciare), përderisa kontratat e kredive që janë përfshirë në studim hyjnë në grupin e kredive me vlerë prej 10,001 euro deri në 50,000 euro. Studimi mbështet gjetjet e tij në përpilimin dhe analizën e të dhënave të Regjistrimit të Kredive të Kosovës dhe të dhënave të sistemit të menaxhimit të informacionit nga institucionet financiare. Si rrjedhojë e ridefinimit të mikrokredive në vitin 2012<sup>9</sup>, studimi u nda në dy segmente ku segmenti i parë përfshinë klientët me kredi prej 10,001 euro deri në 25,000 euro gjegjësisht mikrokreditë, ndërkaq segmenti i dytë përfshinë klientët me kredi në vlerë nga 25,001 euro deri në 50,000 euro. Duke qenë se rezultatet e studimit treguan për një nivel të borxhit dhe strukturë të ngjashme të huamarrjes në të dy segmentet, rezultatet në këtë analizë do të paraqesim si mesatare të dy segmenteve, përveç në rastet kur dallimet mes segmenteve vlerësohen si më të theksuara. Nga gjithsej klientët e përfshirë në këtë studim, rreth 96.5 përqind janë klientë të sistemit bankar, përderisa pjesa e mbetur janë klientë të institucioneve mikrofinanciare. Sa i përket llojit të huamarrjes, kreditë kishin pjesëmarrjen më të lartë në mostër (60 përqind), pasuar nga mbitërheqjet (20 përqind) dhe kartat e kreditit (13 përqind).

Për llogaritjen e nivelit të ngarkesës me borxh janë marrë për bazë të hyrat mujore të ekonomive familjare, përkatësisht profitet mujore të ndërmarrjeve dhe shuma mujore e pagesës së borxhit të këtyre klientëve. Gjetjet e këtij studimi tregojnë se rreth 30 përqind e klientëve të përfshirë në këtë studim (ekonomi familjare dhe biznese) rezultojnë të jenë afër të qenurit të mbingarkuar me borxh. Studimi ofron një pasqyrë mjaftë të qartë të nivelit të mbingarkesës me borxh të ekonomive familjare dhe bizneseve ndarazi. Sa i përket ekonomive familjare, indeksi i mbingarkesës me borxh<sup>10</sup> del të jetë rreth 35 përqind, ndërsa te mostra e bizneseve<sup>11</sup>, ky indeks është diç mbi rreth 30 përqind. Si do që të jetë, studimi tregon se nuk është vënë re korrelacion në mes të nivelit të ngarkesës me borxh që ka një klient dhe performancës së ripagimit së kredisë.

Raporti tregon se rreth 61 përqind e klientëve të përfshirë në studim kanë rezultuar të kenë dy e më shumë kontrata krediti, përderisa 39 përqind e klientëve raportuan vetëm një kontratë aktive krediti. Mesatarisht, klientët në mostrën e zgjedhur kishin rreth 2.3 kontrata krediti. Në këtë rast, duhet theksuar se klientët me më shumë se një kontratë aktive të kreditit ishin më të pranishëm në segmentin e dytë (kreditë me vlerë 25,001 euro deri në 50,000 euro). Kjo mund të ndodh për shkak se klientët që kategorizohen në segmentin e dytë rezultojnë të kenë më shumë probleme në ripagimin e kredisë dhe marrjen përsipër të kontratave të reja kreditore e konsiderojnë si zgjidhje për shlyerjen e borxhit.

Gjetjet e studimit dëshmojnë se mbingarkesa me borxh rezultoi të jetë më e theksuar te klientët që kishin pranuar kredi nga disa institucione financiare njëkohësisht. Mesatarisht, një klient rezultoi të jetë duke shfrytëzuar kredi nga 1.5 institucione financiare njëkohësisht. Rreth 37.5 përqind e klientëve të përfshirë në studim deklaruan të kenë disa kontrata aktive krediti nga disa institucione

<sup>8</sup> EFSE (2012), The Risk of Over-indebtedness of MSE Clients in Kosovo.

<sup>9</sup> Në Prill 2012 u aprovua ligji i ri mbi bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet tjera financiare jobanka, sipas të cilit mikrokreditë klasifikohen si kontrata kredie me vlerë deri në 25,000 euro.

<sup>10</sup> Gjithsej servisimi i borxhit në baza mujore / të ardhurat neto të ekonomive familjare

<sup>11</sup> Gjithsej servisimi i borxhit në baza mujore / të ardhurat mujore neto të biznesit.



financiare. Huamarrja nga disa institucione financiare ishte më e theksuar ndërmjet bankave (95 përqind e klientëve), përderisa vetëm 2 përqind e klientëve në mostër rezultuan të kenë marr kredi nga bankat dhe institucionet mikrofinanciare, njëkohësisht.

Gjithashtu, detyrimet e tjera kishin vëmendje të veçantë në këtë studim, pasi që rreth 41.5 përqind e klientëve kanë rezultuar të kenë qenë bashkëhuamarrës apo garantues për huamarrës të tjerë. Studimi tregon se rreth 34 përqind e klientëve kanë qenë garantues për dikë tjetër ndërkaq 12 përqind e klientëve kanë qenë bashkëhuamarrës. Tendenca për t'u involvuar në më shumë se një kontratë krediti rezulton të ketë pasur korrelacion pozitiv me garancionet e dhëna për dikë tjetër. Gjetjet e studimit tregojnë se klientët që kishin garantuar për kredi që përballen me vonesa në pagesat mujore kishin tendencë të kishin probleme edhe në rikthimin e vetë kredive të tyre.

Gjetjet e këtij studimi poashtu sugjerojnë se rreth 89.7 përqind e klientëve treguan aftësi të mirë paguese duke arritur që të realizojnë pagesën e tyre mujore në kohë apo brenda 30 ditëve, përderisa 10.3 përqind e klientëve kishin vonesa prej 30 ditësh apo më shumë. Kreditë që u klasifikuan në segmentin e dytë rezultuan të kenë më shumë probleme me vonesat për rikthimin e kredisë (11.9 përqind) krahasuar me kreditë e segmentit të parë (8.6 përqind). Klientët që rezultuan të jenë angazhuar në më shumë se një kontratë krediti dhe klientët që kishin marrë kredi nga disa institucione financiare paraqiten të kenë performancë më të dobët në kthimin e kredisë. Për më tepër, huamarrësit me përvojë më të gjatë në huamarrje kanë rezultuar të jenë më të parregullt në pagesën e kredisë në kohë. Përderisa vetëm 5 përqind e klientëve që kishin marr kredi për herë të parë kishin deklaruar vonesa prej më shumë se 30 ditë, rreth 11 përqind e klientëve që kishin marr hua edhe në të kaluarën kishin deklaruar vonesa në pagesat mujore. Gjithashtu, më të padisiplinuar në pagesën e kredisë në kohë kanë rezultuar klientët të cilët i janë afuar periudhës së likuidimit të kredisë. Prirjet për parregullsi në kthimin e kredisë në kohë që janë paraqitur në fazat afër maturimit të afatit të kthimit të kredisë mund të jenë, mes tjerash, pasojë e vlerësimit joadekuat të performancës së pritshme të kredimarrësve nga ana e institucioneve kredidhënëse, ose nga paraqitja e faktorëve të paparashikuar me ndikim në performancën e kredimarrësit. Vlen të theksohet se vonesat ishin më të theksuara te kreditë e lëshuara nga institucionet mikrofinanciare krahasuar me kreditë e sistemit bankar.

Edhe pse niveli i ngarkesës me borxh ende nuk mund të konsiderohet të jetë problematik në rastin e Kosovës, është e domosdoshme që institucionet kredidhënëse ti kushtojnë kujdes të shtuar aspekteve që mund të qojnë drejtë rritjes së mëtejme të mbingarkesës me borxh, e në këtë kontekst kujdes të veçantë kërkon dukuria e huamarrjes nga disa institucione financiare në të njëjtën kohë. Po ashtu, vërehet se dukuria e involvimit në më shumë se një kontratë kreditore përmes garantimit ose bashkëhuamarrjes mund të qojë drejtë rritjes së problemeve të kthimit të kredisë. Në këtë kontekst, përveç vëmendjes së shtuar gjatë aprovimit të kredive për klientët e angazhuar në më shumë kontrata kreditore, është shumë e rëndësishme që institucionet kredidhënëse ti kushtojnë vëmendje të veçantë edhe aspektit të edukimit të klientëve të tyre rreth pasojave që mund ti bartin nga angazhimi në detyrime të tjera siç janë garantimi dhe bashkëhuamarrja.

#### 6.4.2.1 Koncentrimi i rrezikut kreditor

Për të pasqyruar koncentrimin e rrezikut kreditor janë marrë për bazë ekspozimet e mëdha kreditore në raport me kapitalin e klasës së parë. Sipas rregullores së BQK-së, të gjitha huamarrjet të cilat tejkalojnë 10 përqind të kapitalit të klasës së parë klasifikohen si ekspozime të mëdha. Vlen të përmendet se në këto huamarrje, përveç kredive e mbitërheqjeve (si ekspozim direkt), përfshihen edhe ekspozimet indirekte siç janë garancionet, zotimet e pashfrytëzuara dhe letër kreditë. Me anë të këtij indikator mundësohet identifikimi i rreziqeve të mundshme për sistemin bankar (apo edhe për bankat individuale në veçanti) si rezultat i ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj një numri të caktuar të kredimarrësve. Rritja e ekspozimeve të mëdha mund të kuptohet si rritje e rrezikut kreditor, me që në këtë rast sistemi bankar paraqet ndjeshmëri më të madhe ndaj

cilësisë së disa kredive të caktuara, atyre që kanë peshë më të madhe në portfolion kreditor të bankave. Pra ekspozimet e mëdha bëjnë që rreziku kreditor i bankave të jetë i koncentruar në kredi të caktuara. Ekspozimet e mëdha të sistemit bankar në qershor 2012 arritën vlerën 182.7 milionë euro, që është një rritje vjetore prej 38.7 përqind, përderisa kapitali i klasës së parë u rrit për 7 përqind. Si rezultat, raporti i ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit të klasës së parë


arriti në 72.0 përqind, nga 55.6 përqind në qershor 2011 (Figura 55). Edhe pse vërehet se gjatë periudhës së fundit ka pasur rritje të koncentrimin të rrezikut kreditor, duhet theksuar se gjatë së njëjtës periudhë është shënuar rritje e numrit të ekspozimeve të mëdha – gjë që sugjeron se ka pasur shpërndarje të koncentrimin të rrezikut kreditor në më shumë kredimarrës. Derisa në qershor 2011 numri i ekspozimeve të mëdha ishte 41, në qershor 2012 numri i tyre arriti në 54 gjë që ndikoi në rritjen e raportit të ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit të klasës së parë. Cilësia e kredive të konsideruara si ekspozime të mëdha ka ndikim të drejtpërdrejt në stabilitetin e sistemit bankar, andaj edhe në analizën stres-test mbi sistemin bankar janë konsideruar skenarë të tillë në mënyrë që të testohet ndjeshmëria e sistemit ndaj ndonjë dështimi të mundshëm të kredimarrësve më të mëdhenj. Rezultatet e kësaj analize sugjerojnë se edhe në skenarët më ekstrem, siç është skenari i dështimit të pesë kredimarrësve më të mëdhenj në secilën nga bankat, sistemi bankar në tërësi do të mund të mirëmbante treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin mbi 12 përqind, përderisa problemet me rikapitalizimin do të ishin të izoluara në disa nga bankat individuale.

### 6.4.3 Rreziku i solvencës

#### 6.4.3.1 Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit


Sistemi bankar i Kosovës karakterizohet me një shkallë të lartë të kapitalizimit që në vazhdimësi ka tejkaluar minimumin e kërkuar rregullativ. Shkalla e kapitalizimit paraqet një tregues të rëndësishëm të qëndrueshmërisë së sistemit bankar, duke pasur parasysh faktin që kapitali konsiderohet të jetë shtylla kryesore për mbulimin e humbjeve potenciale në rast të ndonjë tronditje në sistemin bankar. Për më tepër, struktura e kapitalit të sistemit bankar të Kosovës përmban një normë mjaft të lartë të kapitalit të klasit të parë, gjë që paraqet një cilësi mjaft të mirë të kapitalit. Se shkalla e

Figura 55. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK (2012)

Figura 56. Kapitalizimi i sistemit bankar



Burimi: BQK (2012)

kapitalizimit është mjaft e lartë konfirmohet edhe nga rezultatet e analizës stres-test të cilat sugjerojnë se sistemi është në gjendje të përballoj nivele mjaft të larta të NPL-ve duke mos u ballafaquar me nevojën për rikapitalizim.


Niveli aktual i kapitalizimit të sistemit bankar të Kosovës, shprehur përmes Treguesit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (*angl. Capital Adequacy Ratio: CAR*)<sup>12</sup>, është mjaft i kënaqshëm duke marrë parasysh se dukshëm tejkalon normën minimale prej 12 përqind të përcaktuar nga BQK-ja (Figura 56). Në qershor 2012, CAR për sistemin bankar qëndronte në nivelin e njëjtë me qershorin 2011, në 17.2 përqind. Niveli i njëjtë i raportit arsyetohet me faktin se të dy komponentët, si kapitali ashtu dhe asetet e peshuara ndaj rrezikut (*angl. Risk Weighted Assets: RWA*), kanë shënuar një normë të rritjes shumë të përafërt prej 7.1 përqind dhe 7.0 përqind, përkatësisht. Rritja më e ngadalshme e RWA krahasuar me vitin e kaluar i atribuohet drejtpërdrejtë rritjes më të ngadalshme të portofolit kreditor të sistemit bankar.

Vlera e kapitalit të sistemit bankar të Kosovës në vazhdimësi ka qenë më e lartë se që u është kërkuar me rregulloren përkatëse të BQK-së (Figura 57). Në qershor 2012, gjithsej kapitali i sistemit bankar ishte 303.9 milionë euro, vlerë kjo e cila tejkalon për 92.2 milionë euro kapitalin e kërkuar rregullativ.

#### 6.4.3.2 Kapitali


Kapitali i sistemit bankar vazhdoi të rritet edhe gjatë vitit 2012, megjithëse me ritëm më të ngadalshëm (Figura 58). Rritja vjetore e kapitalit në qershor 2012 ishte 7.1 përqind, e cila është për 2.3pp më ulët se sa rritja vjetore e shënuar në qershor 2011. Ngadalësimi i rritjes së gjithsej kapitalit ishte kryesisht rezultat i rritjes më të ngadalshme të kapitalit aksionar (si përbërësi kryesor i kapitalit të sistemit bankar) dhe rënies së fitimit për vitin aktual.

Figura 57. Gjithsej kapitali dhe kapitali rregullativ, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Figura 58. Gjithsej kapitali dhe norma vjetore e rritjes, në milionë euro




Burimi: BQK (2012)

<sup>12</sup> Sipas rregullave të BQK-së, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të kapitalit rregullativ në raport me asetet e peshuara ndaj rrezikut.

Burim kryesor i financimit të kapitalit vazhdon të jetë kapitali aksionar dhe fitimi i realizuar nga bankat (si ai i vitit aktual, ashtu edhe fitimi i pashpërndarë nga vitet paraprake), të cilat përbëjnë afër 85 përqind të kapitalit rregullativ. Këto pozicione klasifikohen si pjesë e kapitalit të klasës së parë, apo kapitalit themelor. Një pozicion tjetër i financimit të kapitalit është edhe borxhi i ndërvarur (*angl. Subordinated debt*), si përbërësi i tretë i kapitalit për nga pjesëmarrja (10.2 përqind e gjithsej kapitalit). Borxhi i ndërvarur klasifikohet si pjesë e kapitalit të klasës së dytë.

Figura 59. Struktura e kapitalit të sistemit bankar




Burimi: BQK (2012)

Krahas vlerës së kapitalit dhe CAR, vetë cilësia e kapitalit është një tregues i rëndësishëm i qëndrueshmërisë së sistemit bankar. Si pjesë më e qëndrueshme e kapitalit konsiderohet kapitali i klasës së parë, dhe si pjesë e tij kapitali aksionar. Sistemi bankar i Kosovës konsiderohet një sistem me kapital mjaft të qëndrueshëm e me strukturë cilësore, me që 60 përqind e gjithsej kapitalit përbëhet nga kapitali aksionar. Cilësia e kapitalit, në mes tjerash, ka rol të rëndësishëm për rankimin kreditor të bankave, duke ndikuar drejtpërdrejtë në koston e financimit të jashtëm si dhe në lehtësinë e bankave për qasje në financim të jashtëm.

Pjesëmarrja e kapitalit të klasës së parë dhe të klasës së dytë në gjithsej kapitalin rregullativ ishte pothuajse e njëjtë me atë të qershorit 2011 (Figura 59). Në qershor 2012, 16.5 përqind e gjithsej kapitalit ishte kapital i klasës së dytë (16.4% në qershor 2011), që paraqet një shumë prej 50.3 milionë euro. Përbërësit kryesor të kapitalit të klasës së dytë vazhdojnë të jenë borxhi i ndërvarur (61.8 përqind) dhe provizionet e përgjithshme (38.2 përqind). Përderisa vlera e borxhit të ndërvarur kishte mbetur e pandryshuar krahasuar me qershorin 2011, vlera e provizioneve shënoi rritje vjetore prej 26.3 përqind duke arritur kështu në 19.2 milionë euro. Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të mos shfrytëzojë instrumente tjera si përbërës të kapitalit të klasës së dytë.

Kapitali i klasës së parë me shumën prej 253.7 milion euro, përbën 83.5 përqind të gjithsej kapitalit rregullativ (Figura 59). Kategoria dominuese në strukturën e përgjithshme të kapitalit të klasës së parë mbetet kapitali aksionar duke përbërë 71.4 përqind të këtij kapitali (Figura 60). Fitimi për vitin aktual, fitimi i pashpërndarë si dhe fondet rezervë po ashtu paraqesin kategori të rëndësishme të kapitalit të klasës së parë. Në

Figura 60. Struktura e kapitalit të klasës së parë, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

qershor 2012, kjo kategori përfaqëson rreth 30.2 përqind të gjithë kapitalit të klasës së parë.

Kapitali aksionar, si kategoria kryesore e kapitalit të klasës së parë shënoi rritje vjetore prej 7.8 përqind, duke arritur vlerën prej 181.1 milionë euro. Kjo normë e rritjes së kapitalit aksionar është dukshëm më e lartë se sa në qershor të vitit 2011, kur norma e rritjes ishte 2.2 përqind. Ndërsa, vlera e fitimit të vitit aktual, fitimit të pashpërndarë dhe fondeve rezervë arriti 76.6 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.7 përqind (22.1 përqind rritja vjetore në qershor 2011). Niveli më i ulët i rritjes vjetore të kësaj kategorie kryesisht ishte rezultat i rënies së fitimit në vitin aktual dhe fondeve rezervë krahasuar me nivelin e qershorit 2011.


#### 6.4.3.3 Asetet e peshuara ndaj rrezikut

Vlera e gjithëj aseteve të peshuara ndaj rrezikut arriti në 1.76 miliardë euro në qershor 2012, që paraqet një rritje vjetore prej 7 përqind (19.2 përqind në qershor 2011). Rritja vjetore më e ulët është rezultat i rritjes më të ngadalshme të portfolios së kredive si përbërësi kryesor i RWA-ve.

Struktura e RWA-ve mbetet e ngjashme me qershorin e vitit 2011 (Figura 61). Kjo strukturë dominohet nga asetet me peshë të

rrezikut prej 100 përqind (kryesisht e përbërë nga kreditë dhe zërat jo-bilancor), pjesëmarrja e të cilave arriti në 78.7 përqind (Figura 61). Asetet me peshë të rrezikut prej 75 përqind përbënë 15.7 përqind të gjithëj RWA-ve. Kjo kategori përbëhet nga kreditë e garantuara me hipotekën e parë në pasuri të patundshme, me vonesë kthimi prej më pak se 30 ditë. Kategoria me pjesëmarrjen më të ulët në strukturën e RWA-ve përbëhet nga asetet me peshë të rrezikut prej 50 përqind, pjesëmarrja e të cilave ishte 0.8 përqind e gjithëj RWA-ve nga 1 përqind sa ishte në qershor 2011.<sup>13</sup>

Figura 61. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2012)

## 6.5. Analiza stres-test

Krahas analizës së gjendjes aktuale të ekspozimit të sistemit bankar ndaj rrezikut kreditor, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të solvencës, analiza stres-test paraqet një vegël shtesë përmes së cilës është vlerësuar qëndrueshmëria e sektorit ndaj tronditjeve potenciale, si në cilësinë e portfolit kreditor ashtu edhe në pozitën e likuiditetit. Rezultatet e shtjelluara më poshtë kanë për bazë të dhënat e sistemit bankar për muajin qershor 2012. Gjatë kësaj analize është testuar qëndrueshmëria e sistemit bankar të Kosovës kundrejt rrezikut kreditor të kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe rrezikun nga norma e

<sup>13</sup> Kjo kategori përbëhet nga kërkesat me maturim prej 1 viti ose më pak në bankat që veprojnë në vendet e OECD-së, por që nuk janë të klasifikuara ose që janë rankuar nga Standard & Poor's me B ose me gradë më të ulët apo që janë klasifikuar nga Moody's me P-3 ose me gradë më të ulët.

këmbimit, si dhe është testuar aftësia e tij që të ruaj gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike lidhur me paraqitjen e normave të larta të tërheqjes e depozitave.

### 6.5.1 Rreziku kreditor

#### Metodologjia

Analiza mbështetet në skenarin hipotetik se kriza ekonomike në vendet e Bashkimit Evropian do të vazhdojë të reflektohet në ekonominë e Kosovës përmes zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend. Si rezultat, kjo supozohet të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike, duke zgjeruar kështu hendekun e prodhimit dhe duke ndikuar negativisht në cilësinë e portofolit kreditor. Në këtë skenar është marrë parasysh norma mesatare e rritjes ekonomike në Kosovë prej rreth 4 përqind në pesë vitet e fundit si dhe është supozuar rënie ekonomike prej 2.0 përqind për vitin 2012, gjë që do të rriste hendekun e prodhimit për 6.0 përqind. Për të vlerësuar ndikimin e hendekut të prodhimit në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese (*angl. Non-Performing Loans: NPL*), janë shfrytëzuar koeficientët e elasticitetit nga një analizë e papublikuar e FMN-së për disa vende të Evropës qendrore dhe juglindore.<sup>14</sup> Rrjedhimisht, duke konsideruar një koeficient të elasticitetit të NPL ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të rritej për 4.8pp. Rreziku kreditor është kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe rrezikun nga norma e këmbimit, ku është supozuar rënie e normave të interesit dhe zhvlerësim i valutës euro ndaj valutave të tjera si rezultat i zhvillimeve në disa vende të eurozonës. Rrjedhimisht, përveç rritjes së pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë, në këtë skenar po ashtu është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan për 20 përqind<sup>15</sup> si dhe zvogëlimi i normave të interesit për 2.0 pp. Rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë ndikon në rritjen e provizioneve, zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes/fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe zvogëlimi i normave të interesit ndikon në humbjet/fitimet e të hyrave neto nga interesi duke marrë parasysh hendekun e maturiteteve të kredive dhe depozitave. Krahas supozimeve për tronditjet e lartpërmendura, po ashtu është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst, është supozuar se të hyrat nga 'provizionet dhe të ngjashme' dhe të hyrat tjera nga jo-interesi në vitin 2012 do të jenë ekuivalente me 60 përqind të këtyre të hyrave në vitin 2011 (kjo për shkak se është supozuar se nuk do të ketë rritje të kredive), përderisa komponentet tjera të pasqyrës së të ardhurave janë supozuar të kenë nivel të ngjashëm me ato të vitit 2011.

Rritja e supozuar e NPL-ve është shprehur përmes migrimit të kredive nga kategoritë performuese (standarde, në vëzhgim, nënstandarde) drejtë kategorive joperformuese (të dyshimta dhe të humbura). Rritja e NPL-ve është shpërndarë proporcionalisht në kuadër të kategorisë së kredive të dyshimta dhe të kredive të humbura, duke marrë për bazë pjesëmarrjen fillestare të këtyre kategorive në gjithsej NPL-të. Rritja e NPL-ve reflektohet në nivelin e provizioneve bazuar në rregulloren e BQK-së për provizionimin e kredive sipas klasifikimit. Supozimi për rritjen e NPL-ve aplikohet edhe te zërat jashtë-bilancor që përfshijnë zotimet e pashfrytëzuara, garancionet, letër kreditë në dispozicion, dhe letër kreditë komerciale.

<sup>14</sup> Notë e papublikuar e FMN-së "CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise", Korrik 2009.

<sup>15</sup> Supozim i bazuar në të dhënat historike mbi luhatjen e kursit të këmbimit valutor euro/dollar amerikan.

Me gjithë faktin se në skenarin e analizuar është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan për të vlerësuar rrezikun e normës së këmbimit valutor, është me rëndësi të potencohet se ndikimi i këtij rreziku në bilancin e gjendjes së sistemit bankar vazhdon të jetë shumë i vogël. Pjesa dërmuese e portofolios së kredive është në euro, kreditimi në valutë të huaj pothuaj se nuk ekziston, duke bërë që rreziku nga norma e këmbimit valutor të mbetet minor.

Skenari mbi rrezikun nga norma e interesit nënkupton zvogëlimin e normave të interesit për 2pp (si për asetet ashtu edhe për detyrimet në bilancin e gjendjes). Zvogëlimi i normave të interesit mund të ndikojë në margjinën neto të interesit (*angl. Net Interest Margin: NIM*) qoftë pozitivisht qoftë negativisht varësisht nga kompozicioni i afatit të maturimit të kredive dhe depozitave. Sistemi bankar i Kosovës ka ekspozim të ulët edhe ndaj këtij rreziku, me që pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave në sistemin bankar të Kosovës kanë normë fikse të interesit. Andaj, sistemi bankar është shumë pak i ndjeshëm ndaj lëvizjeve të normave të interesit në periudhën afatshkurtër.

Krahas skenarit të lartpërmendur, si skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i kredimarrësve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli maksimal i NPL-ve të cilin bankat mund ta përballojnë pa pasur nevojë për rikapitalizim.

Qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është vlerësuar në kuptim të ndikimit të rritjes së NPL-ve, zhvlerësimit të valutës euro dhe rënies së normave të interesit në nivelin e kapitalit rregullativ të sektorit bankar dhe në nivelin e aseteve të peshuara me rrezik, rrjedhimisht, në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

## Rezultatet

Gjendja ekzistuese e sistemit bankar të Kosovës për sa i përket kapitalizimit të bankave është mjaft e favorshme, duke pasur parasysh treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit në 17.2 përqind. Gjithashtu, sistemi bankar vazhdon të qëndroj mirë edhe për sa i përket nivelit të kredive jo-performuese në raport me gjithsej kreditë (6.5 përqind) dhe mbulueshmërisë së humbjeve eventuale nga këto kredi me anë të provizioneve, të cilat mbulojnë kreditë jo performuese me 117.3 përqind. Andaj, sistemi bankar tregon nivel të lartë të qëndrueshmërisë ndaj rrezikut kreditor edhe nën kushtet e paraqitjes së skenarëve hipotetikë të përshkruar më lartë. Në supozimet se pjesëmarrja e NPL-ve në portfolion e kredive të sektorit do të rritet për 4.8pp, euro do të zhvlerësohet ndaj dollarit amerikan për 20 përqind, dhe normat e interesit do të zvogëlohen për 2.0pp, në nivel të sistemit bankar në tërësi CAR do të vazhdonte të qëndrojë në mbi 12 përqind, përderisa në nivel të bankave individuale CAR i vetëm dy prej bankave do të zbriste nën nivelin prej 12 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore, ndërsa një prej bankave do të kishte CAR prej 12 përqind. Megjithatë, në mënyrë që niveli i CAR të këtyre dy bankave të ngritej në minimumin rregullativ prej 12 përqind, do të duhej një injektim kapitali ekuivalent me vetëm 0.32 përqind të PBB-së.

Nën këtë skenar, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e sistemit bankar do të arrinte në 11.3 përqind, përderisa në nivel të bankave individuale kjo pjesëmarrje e NPL-ve do të sillej brenda intervalit 4.8 përqind deri në 13.4 përqind. Supozimet e sipërpërmendura të tronditjeve, si rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve, zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan, si dhe zvogëlimi i normave të interesit do të bënte që gjithsej humbja e sistemit bankar të arrinte vlerën prej 56.1 milionë euro. Megjithatë, jo e tëra kjo vlerë mund të konsiderohet si

humbje eventuale me që duhet të merret parasysh fakti se një pjesë e madhe e kësaj humbje do të absorbohej nga profiti i pritur për periudhën e konsideruar.

Në kuadër të analizës stres-test është testuar edhe aftësia e secilës nga bankat për të përballuar dështimin e tre kredimarrësve më të mëdhenj. Supozimi i dështimit të tre kredimarrësve më të mëdhenj në secilën nga bankat do të zvogëlonte CAR-në e disa bankave nën 12 përqind, përderisa CAR e gjithsej sistemit bankar do të vazhdonte të qëndronte mbi nivelin e kërkuar rregullativ. CAR e tri prej bankave do të zbriste nën nivelin prej 12 përqind, dhe në mënyrë që niveli i CAR-së të këtyre tri bankave të ngritej në minimumin rregullativ prej 12 përqind do të duhej një injektim kapitali ekuivalent me vetëm 0.48 përqind të PBB-së. Nën supozimin e dështimit të pesë kredimarrësve më të mëdhenj në secilën bankë, vlera e kapitalit të nevojshëm për injektim do të ishte ekuivalent me 0.7 përqind të PBB-së.

Gjithashtu, bankat paraqiten të afta për të përballuar nivele mjaft të larta të NPL-ve pa pasur nevojë për rikapitalizim. Niveli më i ulët i NPL-ve kur në njërin nga bankat paraqitet nevoja për kapital shtesë (në mënyrë që CAR të mbetet në 12 përqind) është 8.1 përqind, përderisa në një prej bankave NPL duhet të arrijë deri në 33.1 përqind në mënyrë që të paraqitet nevoja për kapital shtesë. Sistemi bankar si tërësi është në gjendje të përballojë një raport të NPL-ve deri në 21.1 përqind pa pasur probleme me mirëmbajtjen e CAR-së në nivelin e kërkuar rregullativ prej 12 përqind.

### 6.5.2 Rreziku i likuiditetit

#### Metodologjia

Analiza e rrezikut të likuiditetit mbështetet në skenarin e tërheqjes së një vlere më të theksuar të depozitave nga sistemi bankar dhe teston aftësinë e sistemit për përballimin e një tronditje të tillë. Në njërin prej skenarëve të kësaj analize është konsideruar tërheqja e depozitave përgjatë një periudhe pesë ditore, duke mos marrë parasysh mundësinë e qasjes së bankave në financim nga jashtë. Skenari mbi rrezikun e likuiditetit është bazuar në një supozim mjaft konzervativ: tërheqje të depozitave me një normë prej 10 përqind të gjithsej depozitave në baza ditore përgjatë një periudhë pesë ditore. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e konvertimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, përderisa mundësia e konvertimit të mjeteve jolikuide në para të gatshme do të ishte vetëm një përqind e këtyre mjeteve brenda ditës. Gjithashtu është supozuar se bankat kanë qasje të plotë në rezervat e tyre, ndërsa nuk është marrë parasysh mundësia e financimit të bankave përmes burimeve të jashtme të financimit. Përpos normës fikse prej 10 përqind të tërheqjes së depozitave në baza ditore, një tjetër skenar i konsideruar ishte tërheqja e depozitave me një normë progresive duke filluar nga 5 përqind deri në 10 përqind përgjatë një periudhe prej 5 ditëve.

Krahas skenarit të lartpërmendur, si skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun e likuiditetit janë konsideruar edhe dështimi i depozitorëve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli maksimal i tërheqjes së depozitave të cilin bankat do të mund ta përballonin pa pasur nevojë për mjete likuide shtesë.

Qëndrueshmëria e sistemit bankar në këtë analizë është testuar në kuptim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së aseteve likuide të bankave për të përballuar një tërheqje të tillë të depozitave.



## Rezultatet

Në pjesët më të hershme të këtij publikimi është cekur se sistemi bankar i Kosovës konsiderohet të jetë mjaft likuid, gjë që vërtetohet edhe nga niveli mjaft i lartë i indikatorëve të likuiditetit. Asetet themelore (*angl. core liquid assets*) likuide dhe ato gjithëpërfshirëse (*angl. broad liquid assets*) përbëjnë 22.6 përqind, përkatësisht 28.9 përqind të gjithëj aseteve të sistemit bankar. Andaj, edhe në rast se skenarët e lartpërmendur do të shfaqeshin në praktikë, sistemi bankar do të tregonte një qëndrueshmëri mjaft të lartë kundrejt rrezikut të likuiditetit.

Në përgjithësi, rezultat e stres-testit, bazuar në skenarin e tërheqjes së vazhdueshme pesëditore të depozitave, sugjerojnë se sistemi bankar i Kosovës paraqitet të ketë nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë edhe në rast se do të paraqiteshin norma më të larta të tërheqjes së depozitave. Nën supozimin hipotetik të tërheqjes së depozitave në mënyrë të vazhdueshme për pesë ditë me radhë me normën e supozuar më lartë, problemet e para të likuiditetit në banka fillojnë të shfaqen pas ditës së dytë, dhe atë vetëm në njërin prej bankave (Tabela 9).

**Tabela 9. Përmbledhje e rezultateve të stress-testit: Rreziku i likuiditetit**

Përshkrimi	Numri i bankave 1/	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)	Raporti kredi/depozita (në përqindje)
Pas ditës së parë	0	0	93.1
Pas ditës së dytë	1	5,056	103.4
Pas ditës së tretë	2	26,532	114.9
Pas ditës së katërt	3	63,044	127.7
Pas ditës së pestë	4	113,115	141.9

Shënim:1/ Numri i bankave të cilat do të kishin nevojë për mjete likuide shtesë.

Norma e tërheqjes së depozitave nga secila bankë është konsideruar të jetë 10 përqind e gjithëj depozitave të tyre në baza ditore për pesë ditë rresht. Pas ditës së dytë, shumë e mjeteve likuide shtesë për bankën e afektuar do të ishte 5.06 milionë euro (0.11 përqind e PBB-së). Përderisa, raporti kredi/depozita do të arrinte në 103.4 përqind (duke supozuar se niveli i kredive nuk do të vazhdonte të rritej gjatë kësaj periudhe). Pas ditës së katërt, problemet me mjetet likuide do të shfaqeshin edhe në dy banka të tjera, duke e sjellë numrin e bankave të afektuara në tre. Në këtë rast, vlera shtesë e mjeteve likuide të nevojshme për tejkalimin e problemeve me likuiditet do të arrinte vlerën prej 63.04 milionë euro (Tabela 9). Pas ciklit pesë-ditor të tërheqjes së depozitave, në katër nga bankat e sistemit do të shfaqeshin problemet e likuiditetit, përderisa vlera e mjeteve likuide shtesë do të arrinte në 113.1 milionë euro (2.6 përqind e PBB-së). Në këtë fazë, nën supozimin se vlera e kredive nuk ndryshon, raporti kredi/depozita do të arrinte në 141.9 përqind në nivel të sistemit bankar.

Nën supozimin e tërheqjes së depozitave me një normë progresive (5 deri 10 përqind), edhe pas ditës së pestë problemet me likuiditetin paraqiten vetëm në dy prej bankave të sistemit. Shumë e mjeteve likuide shtesë për ato dy banka do të ishte 33.6 milionë euro, përderisa raporti kredi/depozita për gjithë sistemin do të arrinte në 121.9 përqind.

Rezultatet tregojnë nivel të kënaqshëm të likuiditetit të sistemit bankar edhe kundrejt supozimit për tërheqjen e depozitave të depozitorëve më të mëdhenj në secilën bankë. Kjo nënkupton që bankat paraqiten të afta për të përballuar tërheqjen e menjëhershme të

depozitave nga depozitorët më të mëdhenjë, gjë që tregon se niveli aktual i koncentrimin të burimeve të financimit në banka nuk po paraqet rrezik serioz të likuiditetit.

Gjithashtu, rezultatet sugjerojnë se bankat janë të afta të përballojnë norma mjaft të larta të tërheqjes së depozitave pa pasur vështirësi të likuiditetit. Sistemi bankar është në gjendje të përballojë tërheqje të depozitave deri në afër 30 përqind të gjithsej depozitave pa pasur probleme në mirëmbajtjen e mjeteve të nevojshme likuide. Në këtë rast, raporti kredi/depozita do të arrijë në 117 përqind, nën supozimin se vlera e kredive mbetet e pandryshuar.

## 6.6. Sistemi i pagesave dhe infrastruktura bankare

Një sistem i sigurt dhe efektiv i pagesave është i domosdoshëm për funksionim e mirëfilltë të sistemit financiar në vend. BQK ka vazhduar aktivitetin e saj për të promovuar një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe evitimin e rreziqeve të mundshme që mund ti kanosen sistemit të pagesave. Sistemet e pagesave mund të përballen me rrezik kreditor (rreziku që një nga pjesëmarrësit në sistem nuk do të mund të arrijë ti shlyej detyrimet financiare brenda sistemit në kohë apo në një të ardhme), rrezik të likuiditetit (një nga pjesëmarrësit në sistem nuk mund të arrijë të shlyej obligimet e tij financiare në kohën e pritur por mund ti shlyej në një të ardhme të afërt), rrezik ligjor (infrastruktura e dobët ligjore nxit rrezikun kreditor apo rrezikun e likuiditetit), rrezik operacional (mosfunksionimet teknike apo gabimet operacionale mund të nxisin rritjen e rrezikut kreditor apo të likuiditetit) dhe rrezik sistemik (pamundësia e një apo disa pjesëmarrësve në sistem për të shlyer obligimet e tij, apo një përçarje në vet sistemin mund të ndikojë në pamundësinë që pjesëmarrësit tjerë në sistemin e pagesave apo në pjesë tjera të sistemit financiar të shlyejnë obligimet e tyre financiare në kohën e paraparë).

Stabiliteti i sistemit të pagesave lidhet ngushtë me stabilitetin e sistemit financiar në vend. Kriza e fundit financiare dëshmoi peshën që kanë sistemet e pagesave në kontekstin e sistemit financiar, kur kemi parasysh shkallën me të cilën janë përhapur tronditjet përmes sistemit të pagesave nga një vend në tjetrin. Kriza financiare ka dëshmuar edhe njëherë shkallën e ndërvarësisë ndërmjet sistemeve të pagesave në nivel global, sidomos në rastet e institucioneve më të mëdha financiare.

Andaj, sistemet e pagesave duhen të kenë një bazë të qëndrueshme legale që siguron ekzekutimin e sigurt të transaksioneve të pagesave, si dhe mekanizma që kontrollojnë rreziqet financiare dhe operacionale të cilët mund të pengojnë mbarëvajtjen e sistemit. Ndërtimi i një sistemi sipas standardeve ndërkombëtare ofron mundësinë për të menaxhuar pagesat individuale me vlerë më të madhe, pagesat prioritare apo ato pagesa që kanë kapacitetin për të nxitur dhe transmetuar çarjet në sistem. Zhvillimet e fundit kanë ndikuar që bankat të ndërmarrin hapa për krijimin e disa standardeve universale për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave me rëndësi sistemike. Këto sisteme konsiderohen të tilla kryesisht për shkak të llojit të pagesave që përpunojnë apo për shkak të një apo disa pjesëmarrësve në sistem që konsiderohen të kenë rëndësi sistemike. Aktualisht, BQK është pronare dhe operatore e sistemit të vetëm të pagesave në Kosovë, i cili quhet Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN). Sistemi më i avancuar i pagesave RTGS (*angl. Real Time Gross Settlement*) që përpunon kryesisht pagesat me vlerë të madhe dhe pagesat urgjente midis bankave në vend dhe institucioneve qeveritare është në fazën e fillestare të

implementimit. Ky sistem do të mundësoj shlyerjen e pagesave në kohë reale, duke ndikuar që rreziku potencial që shoqërohet me vonesat eventuale në shlyerjen e pagesave të minimizohet.

Sistemi ndërbankar i pagesave në Kosovë shlyen pagesat e rregullta, priritare, masive, masive priritare, kos-giro, debitim direkt dhe letrat me vlerë. Pagesat priritare mund të jenë pagesa individuale por edhe pagesa me shumicë dhe përdoren kryesisht për pagesa urgjente komerciale. Duke marr parasysh që SEKN përpunon të gjitha pagesat në vend, çarjet në të apo vonesat eventuale në procesin e shlyerjes do të kishin pasoja të mëdha për sistemin financiar në vend. Andaj, BQK është angazhuar të ndjek parimet themelore ndërkombëtare të Komitetit për Sistemet e Pagesave dhe Shlyerjeve (*angl. Committee on Payment and Settlement Systems: CPSS*) për sistemet e pagesave me rëndësi sistemike, për të evituar rreziqet e mundshme që mund ti kanosen sistemit të pagesave në vend kur kemi parasysh që SEKN është sistemi i vetëm për pagesa ndërbankare. Deri më tani, sistemi i pagesave të Kosovës është karakterizuar me ecuri shumë të favorshme të cilat kanë pasur kontribut shumë të rëndësishëm në stabilitetin financiar në vend.

Numri dhe vlera e transaksioneve që përpunon SEKN ka shënuar rritje të vazhdueshme edhe në vitin 2012. Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2012, në sistemin SEKN është realizuar një numër prej 2.1 milion transaksionesh, me vlerë totale prej 2.5 miliard euro. Krahasuar me gjashtëmuorin e parë të vitit 2011, numri i gjithsej transaksioneve rezulton të jetë rritur për 2.6 përqind, përderisa vlera e gjithsej transaksioneve të shlyera në të njëjtën periudhë është rritur për 15.4 përqind. Ngjashëm me vitin e kaluar, numri dhe vlera e gjithsej transaksioneve të shlyera në gjashtëmuorin e parë të vitit rezulton të jetë e përqendruar në tremuorin e dytë të vitit 2012. Mesatarisht, çdo ditë në sistemin e SEKN janë procesuar dhe shlyer rreth 17,096 transaksione me një qarkullim mesatar ditor prej rreth 20.5 milion euro.

Nëse analizojmë strukturën e vlerës dhe numrit të gjithsej transaksioneve të procesuara përmes SEKN-së, del se peshën kryesore në gjithsej transaksionet e realizuara në SEKN e kanë bankat komerciale si pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në këtë sistem (93.4 përqind e numrit të gjithsej transaksioneve si dhe 77.1 përqind e gjithsej vlerës së transaksioneve të realizuara janë transaksione të realizuara përmes bankave komerciale). Sa i përket shkallës së koncentrimin në sistemin e pagesave në vend, duke përjashtuar BQK-në si pjesëmarrëse në sistem, rreth 52.9 përqind e numrit të gjithsej transaksioneve menaxhohet nga tri banka pjesëmarrëse në sistem, përderisa rreth 67.8 përqind e vlerës së gjithsej transaksioneve menaxhohet nga tri bankat më të mëdha në sistemin bankar në vend.

### 6.6.1 Instrumentet e pagesave

Vlera dhe numri i pagesave të realizuara përmes SEKN ka shënuar rritje edhe në vitin 2012. Pjesëmarrjen më të lartë në numrin e gjithsej transaksioneve vazhdojnë të kenë pagesat e rregullta masive (68.8 përqind të numrit të gjithsej pagesave) që zakonisht janë pagesa të realizuara nga ose për institucionet qeveritare siç janë pagesat e pagave. Këto pagesa pasohen nga pagesat e rregullta (18.1 përqind) dhe pagesat kos-giro (urdhërpagesë në formë letre që mundëson realizimin e pagesave të regjistrimit, taksat apo faturat e shërbimeve publike përmes bankës) të cilat përbëjnë 12.3 përqind të gjithsej transaksioneve.

Sa i përket numrit të gjithsej pagesave të procesuara nga SEKN, rritjen më të shpejtë vjetore e kanë shënuar pagesat masive priritare (nga 1,050 në qershor 2011 në 2,782 në

qershor 2012) dhe pagesat përmes debitimit direkt (nga 3,205 qershor 2011 në 4,911 në qershor 2012). Edhe sa i përket vlerës të transaksioneve të realizuara përmes SEKN, duke pasur parasysh bazën e tyre ende të ulët, pagesat masive prioritare dhe pagesat e realizuara përmes debitimit direkt shënuan rritjen më të shpejtë vjetore (nga 658,662 mijë euro në 1.5 milion euro dhe 2.9 milion euro në 4.2 milion euro në qershor 2012, respektivisht).

Pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej vlerën e transaksioneve në qershor 2012 e kishin pagesat normale (58.0 përqind në gjithsej vlerën e transaksioneve), megjithëse edhe vlera e pagesave Kos-Giro dhe Debitimit Direkt kanë shënuar rritje të vazhdueshme (Tabela 10). Vlen të theksohet se që nga janari 2012, BQK ka filluar edhe emetimin e bonove të thesarit të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012, në sistemin pagesave në Kosovë janë shlyer 131 letra me vlerë, shuma e të cilave rezulton të jetë 89.5 milion euro.

**Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN**

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	Gjashtëmujori i parë 2011	Gjashtëmujori i parë 2012	Gjashtëmujori i parë 2011	Gjashtëmujori i parë 2012
Normale	15.9	18.1	60.0	58.0
Prioritare	0.4	0.5	12.1	13.4
Letra me vlerë	0.0	0.0	0.0	3.6
Të kthyera	0.0	0.0	0.0	0.0
Masive Normale (detale)	71.9	68.8	10.1	9.3
Kos-Giro	11.6	12.3	17.6	15.4
Masive Prioritare (detale)	0.1	0.1	0.0	0.1
Debitimi Direkt	0.2	0.2	0.1	0.2

Burimi: BQK (2012)

Deri në qershor 2012, numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare arriti në 2.2 milion llogari, një rritje vjetore prej 7.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.<sup>16</sup> Struktura e llogarive bankare dominohet nga llogaritë e rezidentëve (98.3 përqind në qershor 2012). Në kuadër të llogarive të rezidentëve, llogaritë individuale bankare përbëjnë rreth 94.3 përqind të gjithsej llogarive të rezidentëve, përderisa pjesa e mbetur prej 5.7 përqind i përket llogarive afariste. Ngjashëm, struktura e llogarive të jo-rezidentëve dominohet nga llogaritë individuale (96.8 përqind në qershor 2012), përderisa llogaritë afariste ende kanë një pjesëmarrje më të vogël prej 3.2 përqind. Në kuadër të llogarive, rëndësi të veçantë kanë llogaritë bankare E-banking, përmes së cilave shfrytëzuesit i qasen shërbimeve bankare 'online' nga interneti.

Në qershor 2012, numri i gjithsej llogarive E-banking arriti në 100,519 që tregon për një rritje vjetore prej 71.3 përqind në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Sa i përket vëllimit të gjithsej transaksioneve E-banking, sikurse numri i transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking ashtu edhe vlera e tyre u karakterizua me rritje. Numri i gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking arriti në 243,184 në qershor 2012

<sup>16</sup> Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë, numrin e llogarive E-Banking, numrin e llogarive që përdorin urdhëresën periodike ("standing order") dhe numrin e llogarive që përdorin Debitimin Direkt ("Direct Debit") – DD.

(186,726 në qershor 2011), përderisa vlera e gjithsej transaksioneve përmes E-Banking në të njëjtën periudhë arriti në 509.0 milion (490.7 milion në qershor 2011).

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2012, numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe shërbime për pagesa të ndryshme arriti në 677,664, një rritje prej 16.0 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në qershor 2012, numri i gjithsej kartelave me funksion debiti arriti në 589,871, përderisa numri i llogarive me funksion krediti arriti në 87,793. Përkundër shkallës më të ulët të përdorimit, numri i kartelave të kreditit është karakterizuar me rritje më të shpejtë krahasuar me rritjen e numrit të kartelave të debitit. Deri në qershor të vitit 2012, numri i kartelave të debitit u karakterizua me një rritje vjetore prej 11.2 përqind përderisa në të njëjtën periudhë, numri i kartelave të kreditit shënoi rritje vjetore prej 63.0 përqind.

Rritja e vazhdueshme e rrjetit të bankomatëve (*angl. Automated Teller Machine: ATM*) dhe pajisjeve POS (*angl. Point-of-Sale*), që i mundësojnë klientëve të bëjnë pagesa në pika të shitjes, tregon për një zgjerim të vazhdueshëm të infrastrukturës bankare. Numri i pajisjeve ATM dhe pajisjeve POS të instaluar nga bankat komerciale shënuan rritje vjetore prej 7.0 përkatësisht 15.9 përqind deri në qershor 2012. Gjithsej numri i ATM-ve të instaluar arriti në 472 përderisa numri i POS-ve arriti në 7,713 (Tabela 10). Gjatë periudhës janar-qershor 2012, numri i tërheqjeve përmes ATM-ve arriti në 4.1 milion, me një qarkullim total prej 378.2 milion euro (342.1 milion euro në gjashtëmuorin e parë të vitit 2011). Gjithashtu, në gjashtëmuorin e parë të vitit 2012 u procesuan rreth 1.6 milion pagesa përmes pikave shitëse me kartela në терминаlet POS, me një qarkullim prej 77.2 milion euro (58.9 milion euro në gjashtëmuorin e parë të vitit 2011). Deri në qershor të vitit 2012, pjesëmarrja e tërheqjes së parave të gatshme nga ATM në vlerën e gjithsej transaksioneve me kartela ishte rreth 83.0 përqind, ndërkaq rreth 17.0 përqind ishin pagesa të klientëve me kartela në pajisjet POS, gjë që tregon për shkallën e lartë të përdorimit të parasë së gatshme në ekonominë e vendit.

Sa i përket përafrimit me vendet e rajonit në kontekst të zhvillimit dhe zgjerimit të infrastrukturës bankare, Kosova vazhdon të ecën shpejtë por është ende nën mesataren e rajonit. Kosova ka përcjellë trend të shpejtë të përafrimit me vendet e rajonit edhe sa i përket pajisjeve të instaluar POS. Në vitin 2011, Kosova kishte gjithsej 7,534 pajisje POS të instaluar, para Shqipërisë që kishte numrin më të vogël të pajisjeve POS në rajon (5,126). Sa i përket numrit të llogarive të cilave klientët mund të ju qasen përmes E-banking, të dhënat tregojnë se Mali i Zi ka numrin më të vogël të llogarive E-banking (27,230), pasuar nga Shqipëria (37,138) dhe Kosova (100,519).

**Tabela 11. Rrjeti i sistemit bankar**

Përshkrimi	Qershor 2009	Qershor 2010	Qershor 2011	Qershor 2012
Numri i ATM-ve	282	380	441	472
Numri i POS-ve	4,612	5,493	6,654	7,713
Numri i llogarive 'e-banking'	17,496	49,188	58,685	100,519

Burimi: BQK (2012)

## 7. INSTITUCIONET TJERA FINANCIARE

### 7.1. Kompanitë e Sigurimit


Sistemi i kompanive të sigurimit vazhdoi të zgjerojë aktivitetin e tij edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2012. Megjithatë, pesha e këtij sistemi në gjithsej sektorin financiar vazhdon të jetë relativisht e ulët, duke përfaqësuar 3.2 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar. Prej gjithsej 13 kompanive të sigurimit që operojnë në Kosovë, 10 prej tyre ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet jojetësore, ndërsa vetëm 3 kompani të sigurimit ofrojnë sigurim jetësor. Struktura e pronësisë së kompanive të sigurimit mbetet e ngjashme me vitet paraprake, ku 10 kompani janë me pronësi të huaj, ndërsa 3 kompanitë tjera kanë pronësi vendore. Relacion i ngjashëm karakterizon edhe strukturën e aseteve në bazë të pronësisë, ku 77 përqind e aseteve të kompanive të sigurimit menaxhohen nga kompanitë e huaja, ndërsa pjesa e mbetur e aseteve menaxhohet nga kompanitë me pronësi vendore.

Në krahasim me institucionet tjera financiare, si bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimit karakterizohen me shkallë relativisht më të ulët të koncentrimin në treg. Në periudhën janar-qershor 2012, indeksi Herfiendahl-Hirschmann (HHI) sugjeron rënie të shkallës së koncentrimin në tregun e industrisë së sigurimeve në 896.5 pikë, krahasuar me 1,021.8 pikë në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Gjithsej asetet e kompanive të sigurimit, në qershor të vitit 2012, arritën vlerën prej 120.2 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 16.3 përqind. Struktura e aseteve dominohet nga depozitat, të cilat në qershor të vitit 2012 përfaqësuan 58 përqind të gjithsej aseteve (Figura 62).


Në anën e detyrimeve, rezervat teknike dhe kapitali vetanak përfaqësojnë kategoritë me peshën më të madhe, me pjesëmarrje prej 48.5 përqind, përkatësisht 40.6 përqind (Figura 63). Këto dy kategori të detyrimeve u karakterizuan me rritje, ku kapitali vetanak shënoi rritje relativisht më të lartë prej 17.6 përqind krahasuar me rritjen e rezervave teknike prej 14 përqind.

Figura 62. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit



Burimi: BQK (2012)

Figura 63. Struktura e detyrimeve të kompanive të sigurimit



Burimi: BQK (2012)


Raporti ndërmjet kapitalit dhe asetëve, që shprehë nivelin e kapitalizimit të kompanive të sigurimit, në gjysmën e parë të vitit 2012 u rrit për 0.5pp dhe arriti në 40.6 përqind. Gjithashtu, raporti ndërmjet kapitalit dhe rezervave teknike, që tregon aftësisë e kompanive të sigurimit për të përballuar humbjet potenciale, u rrit në 83.7 përqind, krahasuar me 81.1 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.<sup>17</sup> Ky raport u rrit kryesisht për shkak të rritjes më të shpejtë të kapitalit në krahasim me rritjen e rezervave teknike.

Përderisa bilanci i gjendjes së kompanive të sigurimit në gjysmën e parë të vitit 2012 tregon për zgjerim të aktivitetit të industrisë së sigurimeve, analiza e të hyrave dhe shpenzimeve tregon për rënie të performancës së kësaj industrie. Kjo për arsye se fitimi neto i kompanive të sigurimit, si një nga indikatorët kryesor të performancës së kësaj industrie, shënoi vlerën prej 0.6 milionë që paraqet pothuasje vetëm gjysmën e vlerës së profitit neto që ishte regjistruar deri në qershorin e vitit

2011. Rënia e profitit të kompanive të sigurimit u reflektua edhe në përkeqësimin e dy indikatorëve të performancës, si Kthimi Mesatar në Asete (*angl. Return on Average Assets: ROAA*) dhe Kthimi Mesatar në Kapital (*angl. Return on Average Equity: ROAE*). ROAA në qershor të vitit 2012 ishte 0.6 përqind, krahasuar me 1.2 përqind sa ishte në qershor të vitit 2011. ROAE gjithashtu u karakterizua me trend të ngjashëm, duke rënë në 1.4 përqind, krahasuar me normën prej 3 përqind sa ishte në qershor 2011.<sup>18</sup>


Në qershor të vitit 2012, numri i policave të shitura nga kompanitë e sigurimit që operojnë në Kosovë ishte 304.1 mijë, që në krahasim me numrin e polisave të shitura në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar paraqet një rritje vjetore prej 24.8 përqind. Vlera e primeve të pranuar gjatë kësaj periudhe u rrit për 4 përqind, duke shënuar vlerën prej 39.6 milionë euro. Lëvizje e ngjashme karakterizoi edhe vlerën e dëmeve të paguara në gjysmën e parë të vitit 2012, të cilat arritën vlerën prej 13.9 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 3.6 përqind. Rritja përafërsisht e njëjtë si e primeve të pranuar, ashtu edhe e dëmeve të paguara, ndikoi që raporti ndërmjet primeve të pranuar dhe dëmeve të paguara të mbetet përafërsisht i njëjtë me atë të vitit të kaluar, gjegjësisht 35.2 përqind (Figura 64). Në

Figura 64. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Figura 65. Struktura e primeve të pranuar të kompanive të sigurimit



Burimi: BQK (2012)


<sup>17</sup> Rezervat teknike janë të nevojshme për të siguruar përmbushjen e përhershme të detyrimeve të kompanive të sigurimit ndaj të siguruarve deri në skadim të marrëveshjes së sigurimit.

<sup>18</sup> Indikatorët ROAA dhe ROAE janë anualizuar.

kuadër të primeve të pranuara, vetëm rreth 0.8 përqind janë prime të gjeneruara nga sigurimi jetësor, ndërsa pjesa tjetër e primeve janë të sigurimit jojetësor.

Veprimtaria e kompanive të sigurimit në Kosovë kryesisht është e koncentruar në ofrimin e policave jovullnetare. Pjesa më e madhe e policave jovullnetare përbëhet nga policat për sigurimin e palës së tretë (*angl. Third Party Liability: TPL*), të cilat edhe gjenerojnë pjesën kryesore të primeve të pranuara (Figura 65). Primit nga TPL-të, në qershor të vitit 2012 arritën vlerën prej 22.5 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 3.3 përqind. Pjesë e rëndësishme e primeve jovullnetare janë edhe polisat kufitare, të cilat në qershor 2012 pothuajse dyfishuan vlerën duke arritur në 5.3 milionë euro. Polisat kufitare përfaqësojnë 13.3 përqind të gjithsej primeve të pranuara. Përveç TPL-ve dhe polisave kufitare, të cilat gjenerojnë prime jovullnetare, pjesë e primeve të pranuara janë edhe primet vullnetare (p.sh.: sigurimi kasko, sigurimi shëndetësor etj.), vlera e të cilave në qershor 2012 arriti në 11.8 milionë euro dhe u karakterizua me rënie vjetore prej 1.2 përqind. Vlera e dëmeve të paguara gjatë kësaj periudhe ishte 13.9 milionë euro. Pjesa më e madhe e dëmeve është paguar për mbajtësit e polisave TPL, të cilat përfaqësuan 64.7 përqind e gjithsej dëmeve të paguara (Figura 66).

Figura 66. Struktura e dëmeve të paguara të kompanive të sigurimit




Burimi: BQK (2012)

### 7.2. Fondet pensionale

Ndër sistemet me rritje të konsiderueshme në kuadër të sektorit financiar vazhdon të jetë sistemi pensional, asetet e të cilit në qershor 2012 shënuan rritje prej 19.5 përqind krahasuar me qershorin e vitit 2011. Pjesëmarrja e sistemit pensional në gjithsej asetet e sektorit financiar ka arritur në 18.6 përqind me një vlerë të përgjithshme të aseteve prej 659.1 milionë euro (13.4 përqind e PBB-së). Pjesa dërrmuese e aseteve të sistemit pensional menaxhohet nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), ndërsa pjesa prej 0.6 përqind menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Gjatë periudhës janar-qershor 2012, performanca e aseteve të TKPK-së u karakterizua me ngritje të ngadalshme të çmimit të aksionit, vlera e të cilit arriti në 1.05 euro. Rikuperimi i tregjeve financiare dhe tregjeve të kapitalit gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012 pritet të

Figura 67. Çmimi i aksionit tëTKPK-së dhe indeksi DJI



Burimi: Trusti (2012), DJI (2012)




reflektojnë pozitivisht edhe në performancën e investimeve të TKPK-së gjatë pjesës së mbetur të vitit. Sa i përket çmimit të njësisë për FSKP-në, rritja në periudhën qershor 2011 deri qershor 2012 ishte 3.0 përqind.

Kjo performancë e investimeve bëri që TKPK të realizoj kthim pozitiv nga investimet në gjysmën e parë të vitit 2012. Megjithatë, ky kthim pozitiv i adresohet kryesisht tremujorit të parë të vitit 2012 kur

u realizua kthim në vlerë prej 28 milionë euro, ndërsa në tremujorin e dytë të vitit 2012 TKPK realizoi kthim negativ prej 8.8 milionë euro. Performanca e investimeve të TKPK-së është në linjë me zhvillimet e përgjithshme në tregjet globale financiare. Kjo tregohet edhe përmes lëvizjeve të ngjashme të vlerës së aksionit të TKPK-së me indikatorët e tregjeve globale, si për shembull Dow Jones Industrial (DJI) (Figura 67). Siç mund të vërehet në figurën 68, asetet e TKPK-së janë kryesisht të koncentruara në aksione (rreth 40 përqind). Instrument tjetër me pjesmarrje relativisht të lartë janë edhe investimet në Bono të qeverive si dhe Bono të lidhura me inflacion. Në qershor 2012, TKPK ka investuar 5 përqind të aseteve në tregun vendor, kryesisht në depozita në bankat lokale. Struktura e aseteve të FSKP-së është e dominuar nga fletëobligacionet, të cilat kanë një pjesmarrje në rreth 75 përqind të gjithsej aseteve, ndërsa rreth 23 përqind e aseteve janë të plasuar në depozita. Pjesa e mbetur i takon kategorisë së aksioneve dhe parasë së gatshme.

Figura 68. Struktura e investimeve të Trustit




Burimi: Trusti (2012)

### 7.3. Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiarë

Aktiviteti i Institucioneve Mikrofinanciare (IMF) në Kosovë vazhdon të jetë i përqendruar në financimin e bizneseve të vogla dhe ekonomive familjare. IMF-të zënë një pjesë relativisht të vogël në sektorin financiar, duke përfaqësuar 3.7 përqind të gjithsej aseteve financiare në Kosovë. Në fund të qershorit të vitit 2012, sektori IMF-ve numëronte gjithsej 19 institucione, krahasuar me 17 institucione sa ishin në qershorin e vitit të kaluar.

Figura 69. HHI për asetet e IMF-ve



Burimi: BQK (2012)

Industria mikrofinanciare vazhdimisht është karakterizuar me një shkallë relativisht të lartë të koncentrimin të tregut. Megjithatë, bazuar në Indeksin Herfindahl-Hirschman (IHH), shkalla e koncentrimin të tregut të IMF-ve po tregon gjithnjë e më shumë trend rënës (Figura 69). Përderisa në vitet e kaluara asetet e tri IMF-ve më të mëdha dominonin

strukturën e aseteve në industrinë mikrofinanciare, në qershor të vitit 2012, asetet e IMF-ve tjera përfaqësuan 53.8 përqind të gjithsej aseteve të IMF-ve, duke dominuar kështu për herë të parë tregun (Figura 70).


Përkundër rritjes së pjesëmarrësve në industrinë mirkofinanciare, vlera e gjithsej aseteve të IMF-ve në gjysmën e parë të vitit 2012 u zvogëlua për 4.1 përqind, duke rënë në 122.6 milionë euro. Kjo për arsye se kreditë, të cilat paraqesin kategorinë kryesore të aseteve të IMF-ve, pësuan rënie vjetore prej 10.9 përqind. Vlera e kredive në qershor 2012 ishte 102.6 milionë euro (Figura 71).

Numri i gjithsej kredive të lëshuara deri në qershor 2012 ishte 55,022, që paraqet rënie vjetore prej 13.8 përqind. Rrjedhimisht, vlera mesatare e një kredie të lëshuar arriti në 1,864.9 euro (1,804.9 euro në gjysmën e parë të vitit 2011).

Pjesëmarrja e kredive të lëshuara nga IMF-të ndaj gjithsej kredive të lëshuara nga sektori financiar në Kosovë është relativisht e ulët dhe vazhdimisht po shënon rënie (7.5 përqind në qershor 2010; 6.6 përqind në qershor 2011; 5.5 përqind në qershor 2012).

Në gjysmën e parë të vitit 2012, performanca e IMF-ve u përkeqësua ndjeshëm, duke përmbyllur periudhën raportuese me humbje. Në qershor të vitit 2012, IMF-të regjistruan humbje neto prej 2.4 milionë euro.


Figura 70. Asetet e IMF-ve sipas madhësisë, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Burimi: BQK (2012)

Figura 71. Kreditë e lëshuara nga IMF-të, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

## Tema Specifike\*

\* Pikëpamjet e shprehura në temat specifike janë të autorit ose autorëve dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimin zyrtar të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Temat specifike paraqesin hulumtim në progres nga autori ose autorët dhe janë publikuar për të hapur diskutime dhe komente.



## 8. Relacioni në mes të Konkurrencës së Sektorit Bankar dhe Provizioneve të Humbjeve nga Kreditë

Arben Mustafa\*

### Abstrakt

Ky punim hulumton relacionin ndërmjet konkurrencës dhe rrezik-marrjes në sektorët bankar në ekonomitë në tranzicion të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, duke shfrytëzuar të dhëna në nivel të bankave individuale për periudhën 2002-2009. Masa e konkurrencës është llogaritur duke shfrytëzuar metodën Panzar-Rosse, ndërsa si masë e përafërt për nivelin e rrezikut të ndërmarrë nga bankat janë shfrytëzuar provizionet për humbjet nga kreditë. Rezultatet sugjerojnë se bankat që operojnë në tregje më konkurruese janë të prira të ndërmarrin nivele më të ulëta të rrezikut. Modeli kontrollon poashtu për efektin që indikatorë të tjerë në nivel të bankave individuale dhe në nivel të shteteve kanë në provizionet për humbje nga kreditë.

### 8.1. Hyrje

Çështja e shkallës së rrezikut të ndërmarrë nga bankat konsiderohet e rëndësishme si në literaturë ashtu edhe në mesin e rregullatorëve, kryesisht për shkak se falimentimi i mundshëm i bankave mund të shkaktojë pasoja shumë më të mëdha negative për ekonominë në krahasim me falimentimin e bizneseve të llojeve të tjera. Sipas Beck *et al.* (2010) bankat ndryshojnë nga llojet e tjera të bizneseve për shkak të tri arsyeve kryesore: a) falimentimi i mundshëm i bankave sjellë kosto të larta sociale, të cilat janë të lidhura kryesisht me humbjet e mundshme për depozituesit e painformuar që nuk janë në gjendje të vlerësojnë si duhet rreziqet me të cilat përballen; b) falimentimi i një banke mund të ndikojë negativisht edhe në bankat e tjera me anë të efektit të "infektimit"<sup>20</sup>, duke ndikuar kështu negativisht në stabilitetin e përgjithshëm financiar dhe sistemin e pagesave dhe c) bankat janë biznese të veçanta për shkak të pranisë së rregullimit bankar, që nënkupton edhe ekzistimin e një rrjeti sigurie për bankat që, në mes tjerash, përfshinë sigurimin e depozitave, huadhënësin e fundit dhe procedurat për zgjidhjen e krizave bankare. Ekzistenca e një rrjeti të tillë sigurie mund të imponojnë një barrë të konsiderueshme financiare për rregullatorin dhe qeverinë, duke rritur kështu koston e përgjithshme të falimentimit të një banke.

Duke pranuar kostot e mundshme që lidhen me rreziqet bankare, literatura ekonomike i ka trajtuar në mënyrë të veçantë faktorët që çojnë bankat drejtë marrjes së rreziqeve më të mëdha. Në këtë kontekst, vëmendje e konsiderueshme i është kushtuar relacionit ndërmjet konkurrencës dhe nivelit të rrezikut të ndërmarrë nga bankat, ku një pjesë e rëndësishme e

\* Arben Mustafa është Drejtor i Departamentit për Stabilitet Financiar dhe Analiza Ekonomike në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Pikëpamjet e paraqitura në këtë artikull janë të autorit dhe jodomsodoshmërisht përfaqësojnë pikëpamjet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Verzioni origjinal i këtij artikulli është i publikuar në verzionin e gjuhës angleze të "Raporti i Stabilitetit Financiar 3".

<sup>20</sup> Efekti "infektues" mund të ndodhë në dy forma: (i) falimentimi i një banke rrit pasigurinë e klientëve të bankave tjera në lidhje me imunitetin e atyre bankave dhe mund të nxitë tërheqjen e depozitave nga ato banka, (ii) për shkak se bankat mbajnë plasmane në bankat tjera, falimentimi i një prej bankave mund të shkaktojë humbje edhe në bankat e tjera të lidhura.

literaturës argumenton që konkurrenca ka ndikim të rëndësishëm në nivelin e rrezikut të ndërmarrë nga bankat. Megjithatë, literatura deri më tani nuk ka arritur një konsensus të përgjithshëm mbi natyrën e ndikimit që konkurrenca ka në sjelljen e bankave për sa i përket marrjes së rrezikut. Pikëpamja mbizotëruese thotë se bankat që operojnë në tregjet më konkurruese ndërmarrin nivele më të larta të rrezikut. Bazuar në këto pikëpamje, rregullatorët, sidomos në të kaluarën, shpeshherë kanë ndërmarrë masa për të kufizuar konkurrencën bankare, duke synuar ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar. Megjithatë, një rrymë tjetër e literaturës promovon pikëpamjen se konkurrenca bankare redukton nivelin e rrezikut të ndërmarrë nga bankat, duke sugjeruar që bankat me fuqi tregu ndërmarrin nivele më të larta të rrezikut në krahasim me bankat që operojnë në tregjet konkurruese.

Mospajtimi rreth asaj nëse konkurrenca përkeqëson apo rritë stabilitetin e sektorit bankar ka qenë e pranishme si në studimet teorike ashtu edhe në ato empirike. Studimet empirike që kanë hulumtuar këtë marrëdhënie dallojnë kryesisht në mënyrën e matjes së konkurrencës, ku disa studime kanë përdorur nivelin e kufizimeve rregullatore të konkurrencës, ndërsa të tjerat kanë përdorur masa të tilla si indekse të përqendrimit të tregut, testin statistikor Panzar-Rosse ose Indeksine Lerner. Ka edhe dallime në lidhje me masën e përdorur për të matur rrezikun bankar, që kryesisht përbëhen nga treguesit e cilësisë së portfolit kreditor, por edhe nga treguesit e kapitalizimit të bankës dhe probabilitetit të falimentimit.

Në këtë artikull, ne kemi hulumtuar marrëdhëniet në mes të konkurrencës dhe shkallës së rrezikut të ndërmarrë nga banka për një mostër prej 15 ekonomive në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL), duke përdorur të dhënat individuale të bankave për periudhën 2002-2009. Modeli Panzar-Rosse është përdorur për të matur konkurrencën e sektorit bankar në secilin vend, për çdo vit, ndërsa niveli i rrezikut të bankës është përfaqësuar nga provizionet për humbjet nga kreditë.

## 8.2. Historiku teorik i relacionit ndërmjet konkurrencës në sektorin bankar dhe marrjes së rrezikut

Ky seksion ofron një rishikim të teorive kryesore mbi relacionin ndërmjet konkurrencës në sektorin bankar dhe marrjes përsipër të rrezikut. Literatura në këtë fushë është e ndarë në dy pikëpamje, ku njëra pretendon se konkurrenca ka ndikim pozitiv në shkallën e rrezikut të ndërmarrë nga bankat, dhe tjetra që pohon se konkurrenca ka ndikim negativ.

Pikëpamja se konkurrenca më intensive çon në rritjen e rrezikut të ndërmarrë nga bankat është e bazuar kryesisht në hipotezën e “vlerës së ekskluzivitetit” (*anglisht: charter value*) që rrjedhë nga puna e Keeley (1990). Vlera e ekskluzivitetit i referohet vlerës aktuale të përfitimeve të ardhshme që do t'i fitonte banka nëse do të vazhdonte së operuari. Sipas Keeley (1990), rritja e konkurrencës zvogëlon vlerën e ekskluzivitetit dhe nxitë bankat për të ndërmarrë rreziqe më të mëdha në mënyrë që të mirëmbajnë/rrisin fitimet e tyre. Niveli më i lartë i rrezikut të ndërmarrë pastaj do të reflektohet në një cilësi më të ulët të portfolit të asetëve dhe në një nivel më të ulët të kapitalizimit të bankës. Hipoteza e vlerës së ekskluzivitetit mbështetet edhe nga një numër i autorëve të tjerë si Hellman *et al.* (2000) dhe Repullo (2003) të cilët pohojnë se rritja e konkurrencës çon në shkallë më të lartë të rrezikut të ndërmarrë nga bankat. Fokusi i këtyre studimeve është konkurrenca midis bankave në tregun e depozitave, ku ata vërejnë se konkurrenca më e lartë nxitë bankat të ofrojnë norma më të larta të interesit të depozitave, në mënyrë që të tërheqin nivele më të larta të tyre. Në këto kushte, bankat do të priren të favorizojnë investimet në asetet me më shumë rrezik, të cilat ofrojnë një kthim më të lartë në periudhën aktuale, ndërsa vlera më e ulët e ekskluzivitetit nënkupton një kosto më të ulët oportune në aspektin e fitimeve të humbura në rast të falimentimit të bankës.

Megjithatë, ndikimi i konkurrencës në rrezik-marrjen e bankës varet edhe nga një numër faktorësh të tjerë, si shkalla e shpalosjes së zbulimit të informacionit mbi rrezikun nga bankat, prania e një skeme të sigurimit të depozitave si dhe kërkesat rregullatore të kapitalit, të cilat ndërveprojnë me konkurrencën në përcaktimin e prirjes së bankave kundrejt marrjes së rrezikut. Në këtë kontekst, në qoftë se informacioni i rrezikut mund të vëzhgohet nga huamarrësit si dhe nëse janë në funksion skema e sigurimit të depozitave e bazuar në rrezik dhe kërkesat rregullative të kapitalit, atëherë rritja e konkurrencës jo domosdoshmërisht çon në nivel më të lartë të rrezikut të ndërmarrë nga bankat.

Një aspekt tjetër i literaturës bankare hulumton ndikimin e konkurrencës në rrezik-marrje të bankave nga perspektiva e teorive të informacionit asimetric. Një nga problemet me të cilat përballen bankat në procesin e ndërmjetësimit financiar është zgjedhja e gabuar (*anglisht: adverse selection*), ku bankat kanë vështirësi në dallimin në mes të huamarrësve me rrezik të ulët dhe me rrezik të lartë. Sipas Marquez (2002), me rritjen e numrit të bankave, çdo bankë ka më pak informacion në lidhje me pjesëmarrësit e tregut për shkak të shpërndarjes së informacionit midis bankave, duke rritur kështu problemin e zgjedhjes së gabuar. Megjithatë, kjo teori nuk merr parasysh infrastrukturën e shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve kredihënëse siç janë byrotë kreditore apo regjistrat kreditor që sot janë të pranishme pothuajse në çdo vend. Problemi i i zgjedhjes së gabuar trajtohet edhe nëpërmjet procedurave të shqyrtimit (*anglisht: screening procedures*), ku banka nxitë huamarrësin potencial për të shpalosur informacione relevante për vendimin e bankës për të lëshuar ose jo kredinë për atë klient. Shumica e studimeve që ekzaminonë ndikimin e konkurrencës në procesin e shqyrtimit nga bankat argumentojnë për një marrëdhënie negative, duke nënkuptuar se konkurrenca më e lartë çon në një shqyrtim më të vogël nga ana e bankave, duke rritur kështu mundësinë që një pjese të madhe të huamarrësve me cilësi të dobët të u aprovohen kreditë (Chan *et al.*, 1986; Manove *et al.*, 2001). Sipas këtyre autorëve, kur konkurrenca rritet, shqyrtimi reduktohet për shkak se bankat kanë tendencë për të zvogëluar shpenzimet, ose për shkak se duan të devijojnë nga shqyrtimi i duhur i aplikantëve për kredi në mënyrë që të zotërojnë pjesë më të madhe të tregut. Megjithatë, rritja e konkurrencës jo domosdoshmërisht mund të ketë ndikim negativ në nivelin e shqyrtimit bankar. Chen (2007) e sheh shqyrtimin si një komponent shtesë të strategjisë konkurruese të bankës, duke argumentuar se një bankë mund të konkurrojë me bankat e tjera duke ofruar norma më të ulëta të interesit të kredisë, si dhe duke rritur përpjekjet për një shqyrtim më të madh. Sipas këtij autori, përveç preferencave për norma më të ulëta të interesit të kredisë, huamarrësit e mirë gjithashtu mund të preferojnë të shqyrtohen më hollësisht në mënyrë që të vlerësohen në mënyrë korrekte nga banka, e cila nga ana tjetër, do të shpërblejë ata me një qasje më të lehtë dhe më të favorshme në financim në të ardhmen.

Ndikimi i konkurrencës në nivelin e rrezik-marrjes nga banka nëpërmjet ndikimit të saj në normat e interesit të kredisë është adresuar edhe nga Boyd dhe de Nicolo (2005), të cilët sugjerojnë se bankat monopoliste marrin rreziqe më të larta, ndërsa konkurrenca e rritur çon në rrezik më të ulët në portofolet e aseteve të bankave. Sipas Boyd dhe de Nicolo, pasi që bankat monopoliste kanë tendencë për të vendosur norma më të larta të interesit të kredisë, sipërmarrësit do të jenë të prirur të angazhohen në projekte me rrezik më të madh, të cilat u premtojnë norma më të larta të kthimit, në mënyrë që të kompensojnë pagesat e interesit të lartë. Anasjelltas, me rritjen e konkurrencës, bankat do të priren që të ofrojnë norma më të ulëta të interesit të kredisë, të cilat do të ndikojnë që huamarrësit të ndërmarrin projekte më të sigurta. Kjo nënkupton që rritja e konkurrencës në tregun bankar rezulton në një rrezik më të ulët për portofolet e aseteve të bankave.

Marrëdhënia në mes të konkurrencës dhe rrezik-marrjes nga bankat mbetet e ndarë edhe në literaturën empirike, me një pikëpamje që pretendon se rritja e konkurrencës bankare dëmton stabilitetin e sistemit bankar (Keeley, 1990; Saurina, 2003; Dick, 2006), ndërsa tjetra që mban qëndrimin se stabiliteti i sistemit bankar është më i madh kur ekziston një konkurrencë më intensive midis bankave (Boyd dhe De se Nicoló's, 2005; Schaeck dhe Čihák, 2007; Jayaratne dhe Strahan, 1998).

### 8.3. Matja e konkurrencës së sektorit bankar te vendeve të EQL duke përdorur qasjen Panzar-Rosse

Qëllimi i këtij seksioni është të llogaris variablën e konkurrencës së sektorit bankar në ekonominë në tranzicion në EQL, e cila më pas do të përdoret si një variabël shpjeguese në vlerësimin e ndikimit të konkurrencës së sektorit bankar në provizionet për humbjet nga kreditë.

Modeli Panzar dhe Rosse (1987) është një qasje jo-strukturore e bazuar në teorinë mikroekonomike, e cila matë konkurrencën në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes kuantifikimit të sjelljes së firmave, duke mos marrë parasysh asnjë element të strukturës së tregut. Modeli Panzar-Rosse prodhon të ashtuquajturin testin statistikor H (H-statistics), i cili matë shumën e elasticitetit të të ardhurave të bankave kundrejt çmimeve të inputeve të bankave. Me fjalë të tjera, testi statistikor H tregon se si të ardhurat e bankave i përgjigjen një rritjeje në çmimet e inputeve. Sipas kësaj qasjeje, reagimi i të ardhurave ndaj ndryshimit të çmimeve të inputeve ndryshon varësisht prej sjelljes konkurruese të bankës. Vlera e testit statistikor H tregon nëse sjellja e bankave është në përputhje me nocionin e monopolit, konkurrencës monopolistike, apo konkurrencës së përsosur.

Një regresion standard, i njohur si modeli Panzar-Rosse, i përdorur për llogaritjen e testit statistikor H është një formë e reduktuar e ekuacionit të të ardhurave që merr formën e mëposhtme:

$$\log_e (TR_i) = \alpha_0 + \sum_{i=1}^n \beta_i \log w_i + \sum_{i=1}^n \gamma \log z_i + error\ term \quad (1)$$

ku,  $i$  është indeksi për firmën, TR përfaqëson të ardhurat e bankës,  $w$  përfaqëson vektorin e çmimeve të inputeve të bankës dhe  $z$  përfaqëson vektorin e variablave të kontrollit që ndikojnë në të ardhurat e bankës. Në rastin tonë, çmimet e inputeve përbëhen nga çmimi i fondeve (shpenzimet e interesit/depozitat), çmimi i fuqisë punëtore (shpenzimet e personelit/asetet totale) dhe çmimin e kapitalit fizik (shpenzime të tjera operative/asetet fikse). Ekuacioni gjithashtu përfshin dy variabla të kontrollit (kreditë/totali i aseteve dhe kapitali/totali i aseteve), të cilat shpjegojnë përbërjen e strukturës së totalit të aseteve dhe prirjen e bankës kundrejt rrezik-marrjes. Në model, ne nuk kontrollojmë për variablën e madhësisë së bankës, d.m.th. asetet totale, për shkak të animit të mundshëm drejt specifikimit të gabuar që kontrolli për këtë variabël mund të shkaktojë. Vendimi për të mos kontrolluar për madhësinë e bankës është i bazuar kryesisht në kritikën e Bikker et al. (2009), i cili pretendon se përfshirja e totalit të aseteve midis variablave të kontrollit shkakton anim në rritjen e vlerën së testit statistikor H, pasi ajo transformon ekuacionin e formës së reduktuar të të ardhurave në një ekuacion të formës së reduktuar të çmimeve.

Ekuacioni Panzar-Rosse është vlerësuar empirikisht duke përdorur të dhëna të kryqëzuara (anglisht: cross-section data) për çdo vend dhe për çdo vit. Metoda e përdorur për vlerësimin është metoda e thjeshtë e Katrorëve të Vegjël (anglisht: Ordinary Least Square: OLS), duke pasur parasysh se për disa prej vendeve numri i vëzhgimeve ndër-sektoriale është mjaft i vogël. Pasi që shumica e koeficientëve të çmimeve të inputeve (testi statistikor H), i kalkuluar përmes vlerësimit të këtij modeli, do të përdoret si variabël e pavarur në modelin e fazës së dytë, ne jemi më të interesuar për trendin e kësaj variable se sa për vlerën absolute. Prandaj, ne do të injorojmë çfarëdo animi në vlerësim që mund të ketë rezultuar nga përdorimi i metodës OLS.



## 8.4. Vlerësimi i ndikimit të konkurrencës në nivelin e rrezik-marrjes në sektorin bankar

### 8.4.1 Përshkrimi i modelit dhe të dhënave

Ky seksion paraqet vlerësimin empirik të ndikimit të konkurrencës së sektorit bankar në provizionet për humbjet nga kreditë për 15 ekonomitë në tranzicion në EQL, për periudhën 2002-2009. Vlerësimi është bërë në bazë të një paneli të pabalancuar të të dhënave vjetore. Të dhënat për bankat individuale të përdorura për këtë vlerësim janë marrë nga baza e të dhënave e Bureau Van Dijk BankScope, ndërsa të dhënat në nivel të shteteve janë marrë nga Banka Botërore dhe Fondacioni Heritage. Modeli i përdorur për të vlerësuar marrëdhëniet midis konkurrencës dhe rrezik-marrjes është strukturuar si më poshtë:

$$\begin{aligned} prov\_loans_{it} = & \alpha_0 + \beta_1 Hstat_{it} + \beta_3 ta_{it} + \beta_2 L.nonint_{it} + \beta_4 L.equity\_ta_{it} + \beta_7 L.nim_{it} + \\ & \beta_4 hhi\_dep_{it} + \beta_5 rgdpgrowth_{it} + \beta_6 cpi_{it} + \beta_7 rule\_law_{it} + \beta_8 fin\_freed_{it} + \beta_9 dv\_year_{it} + \\ & \beta_{10} dv\_country_{it} + \varepsilon_{it} \end{aligned}$$

ku,  $i$  paraqet bankën dhe  $t$  paraqet vitin.

Në mungesë të të dhënave për kreditë joperformuese për bankat individuale, variabla e varur në modelin tonë përbëhet nga raporti i provizioneve për humbjet nga kreditë ndaj totalit të kredive (*prov\_loans*). Variabla që përfaqëson konkurrencën e sektorit bankar (*Hstat*) është testi statistikor H i llogaritur bazuar në metodën Panzar-Rosse në seksionin 2. Modeli gjithashtu përmban disa variabla të kontrollit specifike për bankat dhe disa të tjera për shtetet. Variablat specifike bankare të kontrollit përfshijnë: asetet totale (*ta*), të cilat përfaqësojnë madhësinë e bankës; raporti i të ardhurave nga jo-interesi ndaj totalit të aseteve (*nonint*), e cila është përfshirë për të kontrolluar për strukturën e veprimtarisë së bankës; pjesëmarrja e kapitalit ndaj totalit të aseteve (*equity\_ta*), e cila është përfshirë për të kontrolluar prirjen e bankës për sa i përket rrezik-marrjes; dhe margjina neto e interesit (*nim*), e cila është përfshirë për të kontrolluar për efektin e normave të interesit. Variablat *nonint*, *equity\_ta* dhe *nim* janë të specifikuara për periudhën paraprake t-1 (anglisht: first lags) në mënyrë që të trajtojnë endogjenitetin potencial me variablën e varur. Variablat specifike në nivel të shteteve përfshijnë: indeksin e koncentrimin të tregut, gjegjësisht Index Herfindahl-Hirschman për depozitat (*hhi\_dep*); normën reale të rritjes së PBB-së (*rgdpgrowth*); normën e rritjes vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (*cpi*); Indeksit e Sundimit të Ligjit të formuluar nga Banka Botërore (*rule\_law*), dhe Indeksit e Lirisë Financiare formuluar nga Fondacioni Heritage (*fin\_freed*). Modeli gjithashtu përmban variablat fiktive (anglisht: dummy variables) për çdo vit (*dv\_year*) dhe për çdo vend (*dv\_country*).

Metoda e zgjedhur për ekzekutimin e regresionit është metode me Efekte Fikse. Megjithatë, për shkak se është përdorur një mostër e përbërë nga të dhëna të disa vendeve, përfshirja e variablave fiktive për vendet është konsideruar si e nevojshme. Pasi që metoda e Efekteve Fikse nuk lejon përfshirjen e variablave fiktive, që janë variabla të pandryshueshme gjatë kohës, metoda e përdorur për llogaritjen e regresionit në këtë rast është metoda e Zbërthimit të Vektorit të Efekteve Fikse (anglisht: *Fixed Effects Vector Decomposition*), e cila lejon edhe përfshirjen e variablave të cilat nuk ndryshojnë gjatë kohës. Megjithatë, për testimin e qëndrueshmërisë së rezultateve tona, janë përdorur gjithashtu edhe metoda e thjeshtë e efekteve fikse dhe ajo e efekteve të rastit (duke pasur parasysh se Testi Haussman nuk përjashton mundësinë për ta përdorur këtë të fundit).

### 8.4.2 Rezultatet e vlerësimit

Rezultatet e regresionit sugjerojnë ekzistencën e relacionit negativ në mes të konkurrencës së sektorit bankar, të matur me testin e statistikës Panzar-Rosse, dhe nivelit të rrezikut në portofolin kreditor të bankave, të matur me raportin e provizioneve për humbje nga kreditë

ndaj gjithsej kredive. Me fjalë të tjera, rezultatet sugjerojnë që niveli më i lartë i konkurrencës çon në cilësi më të lartë të portofolit kreditor. Ky rezultat korresponon me një numër të studimeve tjera empirike në këtë fushë, siç janë: Schaeck dhe Čihák (2007), Schaeck *et al.* (2006), Beck *et al.* (2003), Jayaratne dhe Strahan (1998). Një pjesë e konsiderueshme e literaturës së kësaj fushe argumenton çështjen pse konkurrenca nuk do të duhej të çonte tek ndërmarrja më e lartë e rrezikut, mirëpo argumentet pse konkurrenca do të duhej të zvogëlonte shkallën e ndërmarrjes së rrezikut janë mjaft të kufizuara. Megjithatë, relacioni negativ në mes të konkurrencës dhe ndërmarrjes së rrezikut nga bankat mund t'i atribuohet fillimisht faktit që në kushte të konkurrencës më të lartë, depozitorët kanë më shumë alternativa se ku t'i depozitojnë mjetet e tyre, dhe si rezultat i kësaj kanë më shumë tendencë që të i 'ndëshkojnë' bankat me nivel të lartë të rrezik-marrjes duke i zhvendosur depozitat në banka më të sigurta. Për më tepër, siç argumenton Chen (2007), me rritje të konkurrencës bankat mund të aplikojnë procedura më të rrepta të shqyrtimit ngase huamarrësit më cilësor mund të preferojnë t'i nënshtrohen shqyrtimit më të mirë në mënyrë që të mund të dallohen nga huamarrësit më pak cilësor.

Në këtë studim është kontrolluar gjithashtu për indeksin e përqendrimit të tregut, të matur me Indeksin Herfindahl-Hirschman (HHI), i cili argumentohet të jetë një masë alternative e konkurrencës. Megjithatë, ndikimi i përqendrimit të tregut në rrezikun bankar rezultoi të jetë statistikisht i parëndësishëm. Përfshirja apo mos-përfshirja e Indeksit Herfindahl-Hirschman në regresion rezultoi të mos ketë ndikim në shenjën e koeficientit të testit statistikor H (H-statistics), e as në rëndësinë statistikore të tij, duke mbështetur kështu qëndrimin e Claessens dhe Laeven (2003) të cilët argumentuan se përqendrimi i tregut dhe konkurrenca paraqesin dy veçori të ndryshme të tregut bankar, andaj edhe efekti i tyre në stabilitetin e sistemit bankar është i pavarur nga njëri tjetri.

**Tabela 1. Rezultatet e vlerësimit**

	prov_loans
H_stat	-0.099*
Lagnonintinc_ta	0.094**
logta	-0.414***
Lagequity_ta	-0.033***
hhi_dep	0.001
rgdpgrowth	-0.203***
cpi	-0.023
Lagnim	-0.105**
rule_law_wb	0.364
finacial_freedom_hrt	-0.046**
resid_stage2	1.000***
Constant	10.878**
Vëzhgimet	1,816
R <sup>2</sup>	0.413

\*\*\* p<0.01, \*\* p<0.05, \* p<0.1

Raporti i të hyrave nga jo-interesi ndaj gjithsej asetëve ka rezultuar të ketë efekt pozitiv në provizionet për humbje nga kreditë, duke sugjeruar kështu që bankat me pjesëmarrje më të madhe të asetëve që nuk gjenerojnë interes tentojnë të jenë më të ekspozuara ndaj rreziqeve të lidhura me cilësinë e portofolit kreditor. Rezultatet gjithashtu tregojnë shenjë pozitive për koeficientin e gjithsej asetëve, duke sugjeruar që bankat më të mëdha tentojnë të kenë cilësi më të mirë të portofolit kreditor, që mund të i atribuohet faktit që bankat më të mëdha janë në gjendje të përdorin metoda më të avancuara të menaxhimit të rrezikut, por edhe faktit që bankat më të mëdha kanë më shumë mundësi të kenë historik më të

gjatë të operimit, e që mund të jetë përparësi e madhe në aspektin e posedimit të informacionit për huamarrësit potencial.

Sipas rezultateve të studimit, bankat që kanë nivel më të lartë të normës së kapitalit ndaj gjithsej aseteve tentojnë të jenë më të sigurta në aspektin e cilësisë së portofolit kreditor. Kjo gjetje është në linjë me këndvështrimin e Repullo (2003) i cili argumenton se me prezencën e kërkesave për kapital, është kapitali i bankës ai që rrezikohet fillimisht, andaj bankat nuk kanë shtytje për të ndërmarrë shkallë të lartë të rrezikut që do të i dërgonte ato drejt falimentimit të mundshëm. Rezultatet gjithashtu sugjerojnë që bankat me margjina më të larta të interesit tentojnë të kenë nivel më të ulët të rrezikut në portofolet e tyre kreditore. Kjo gjetje mund t'i atribuohet faktit që normat e larta të interesit mund të dekurajojnë huamarrësit potencialit më të 'dobët' nga aplikimi për kredi, duke rezultuar në cilësi më të mirë të huamarrësve në portofolin kreditor të bankave. Për më tepër, normat më të larta të interesit mund të sigurojnë fitime të mjaftueshme për bankat, duke i bërë ato mos të jenë të nxitura që të ndërmarrin projekte të natyrës 'rrezik i lartë – kthim i lartë'.

Sa i përket indikatorëve në nivel të shteteve, rezultatet e studimit sugjerojnë që rritja reale e PBB-së ka ndikim statistikisht të rëndësishëm negativ në provizionet për humbje nga kreditë, që nënkupton se kapaciteti i pagimit të kredisë nga huamarrësi është më i madh në periudhat me rritje ekonomike. Ndikimi i inflacionit në cilësinë e portofolit kreditor rezultoi të jetë statistikisht i parëndësishëm. Përkundër pritjeve, koeficienti i indeksit të sundimit të ligjit rezultoi të jetë statistikisht i parëndësishëm gjithashtu, që në një masë mund të i atribuohet ndryshimit të ulët të indeksit përgjatë periudhës së përfshirë në analizë. Indeksi i Lirisë Financiare, i cili matë shkallën e ndërhyrjes së qeverisë në vendimmarrjen e bankave, rezultoi të ketë efekt negativ që nënkupton se sa më e ulët që është shkalla e ndërhyrjes së qeverisë, aq më cilësor do të jetë portofoli i kredive.

## 8.5. Përfundimi

Literatura teorike dhe empirike mbi relacionin e konkurrencës së sektorit bankar dhe rrezikut mbetet e pa konsensus, ku njëra pikëpamje argumenton që marrëdhënia mes këtyre të dyjave është pozitive, ndërsa tjetra pikëpamje argumenton të kundërtën. Kjo analizë vlerësoi empirikisht relacionin në mes të konkurrencës dhe nivelit të ndërmarrjes së rrezikut në sektorin bankar të ekonomive të tranzicionit në Evropën Qendrore dhe Lindore, duke përdorur të dhëna në nivel të bankave individuale për periudhën 2002-2009. Strategjia e vlerësimit empirik ka përfshirë dy faza, ku në fazën e parë është llogaritur masa e konkurrencës (Panzar-Rosse H-statistics), ndërsa në të dytën është vlerësuar në mënyrë empirike ndikimi i konkurrencës në provizionet për humbje nga kreditë.

Gjetja kryesore e studimit sugjeron që raporti ndërmjet konkurrencës së sektorit bankar dhe provizioneve për humbje nga kreditë është negativ, që nënkupton që niveli më i lartë i konkurrencës sjellë tek nivel më i ulët i rrezikut në portofolin kreditor të bankave. Rezultati është nxjerrë duke kontrolluar në të njëjtën kohë edhe për indikatorë të tjerë specifik për bankat, indikatorë kryesorë makroekonomik dhe institucional. Në këtë mënyrë, rezultatet sugjerojnë që bankat me nivel më të lartë të aseteve, normë më të lartë të kapitalit dhe margjinë më të lartë të interesit tentojnë të kenë rrezik më të ulët në portofolin e tyre kreditor, përderisa bankat me pjesëmarrje më të lartë të aseteve që nuk gjenerojnë interes tentojnë të kenë shkallë më të lartë të rrezikut në portofolet e tyre kreditore. Rritja reale e PBB-së rezulton të ketë efekt të konsiderueshëm negativ në provizionet për humbje nga kreditë, duke sugjeruar kështu që aftësia paguese e huamarrësve tenton të përmirësohet në kushtet e rritjes së aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në vend. Rezultatet sugjerojnë që liria financiare përmirëson cilësinë e portofolit kreditor, në të cilin rast sa më e ulët shkalla e ndërhyrjes së qeverisë në vendimmarrjen e bankave, aq më i ulët niveli i rrezikut në portofolin kreditor të atyre bankave. Ndikimi i indeksit të përqendrimit të tregut rezultoi të jetë statistikisht i parëndësishëm. Për më

tepër, rezultatet e regresionit shfaqin efekt të pavarur të matësit të konkurrencës dhe indeksit të përqendrimit të tregut, që korresponon me pikëpamjen që konkurrenca dhe përqendrimi i tregut përfaqësojnë dy gjëra të ndryshme.

## 9. Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike në Kosovë

### Albulenë Kastrati \*

#### Abstrakt

Ky artikull elaboron rrezikun sistemik në sektorin financiar, me fokus në një koncept relativisht të ri në literaturën e financave, atë të institucioneve financiare me rëndësi sistemike (SIFI-t). Esenca e debatit për SIFI qëndron në faktin se këto institucione janë esenciale për mbarëvajtjen e sektorit financiar, por gjithashtu, mosfunksionimi i tyre kërcënon seriozisht stabilitetin financiar dhe atë makroekonomik. Me qëllim të ofrimit të një pasqyre më gjithëpërfshirëse, ky artikull përfshinë modelin për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike në Kosovë (SIB-t), i cili mbështetet në tri kriteret kryesore, përkatësisht, madhësia, zëvendësueshmëria dhe ndërlidhja. Gjetjet kryesore të kësaj analize janë se tri bankat më të mëdha në Kosovë qartë rezultojnë me rëndësi sistemike në të gjitha kriteret e konsideruara. Përveç tri bankave më të mëdha, dy banka tjera më të vogla po ashtu janë cilësuar me rëndësi sistemike te kriteri i zëvendësueshmërisë; ndërsa, te kriteri i ndërlidhjes, përkundër nivelit të ulët të ndërlidhjes mes bankave në Kosovë, tri bankat më të mëdha rezultuan me rëndësi sistemike.

#### 9.1. Hyrje

Kohët e krizave financiare zakonisht nxisin reformimin e rregullativës dhe politikëbërjes paraprake të sistemit financiar. Kjo për arsye se institucionet financiare janë më të brishta gjatë krizave financiare (Bernanke dhe Gertler, 1989) dhe mund të shkaktojnë pasoja të rënda në tërë ekonominë e vendit. Në rastin e krizës financiare globale që filloi në vitin 2007/2008, përhapja e shpejtë e krizës nga institucionet financiare individuale në tërë sistemin financiar dhe pastaj edhe në sektorin real rriti vëmendjen dhe përkushtimin ndaj rrezikut sistemik (Tarashev *et al.*, 2010). Kjo krizë financiare motivoi riformulimin e kornizës së mëparshme rregullative (siç ishte Basel II) dhe nxiti reforma në mënyrën e rregullimit të institucioneve financiare, veçanërisht institucioneve të mëdha dhe të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Këto institucione janë esenciale për mbarëvajtjen e sektorit financiar dhe të sektorëve tjerë në ekonomi, mirëpo në rast mosfunksionimi, gjithashtu mund të paraqesin pasoja serioze për tërë sistemin dhe ekonominë. Institucionet e tilla quhen institucione financiare me rëndësi sistemike (*angl. Systemically Important Financial Institutions: SIFIs*). Duke marrë parasysh pasojat financiare dhe ekonomike që sollën SIFI-t që nga fillimi i krizës globale financiare, një nga mësimet kryesore që u nxorën prej kësaj krize ishte nevoja për rritjen e stabilitetit dhe sigurisë në tregjet financiare, duke i kushtuar vëmendje të theksuar rrezikut sistemik.

Koncepti i rrezikut sistemik është relativisht i vjetër në literaturë dhe daton qysh rreth njëzet vite më parë. Megjithatë, në aspekt të politikëbërjes, koncepti i SIFI-ve është

---

\* Albulenë Kastrati është Ekonomiste në Departamentin për Stabilitet Financiar dhe Analiza Ekonomike në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Pikëpamjet e paraqitura në këtë artikull janë të autores dhe jodomsoshmërisht përfaqësojnë pikëpamjet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Verzioni original i këtij artikulli është i publikuar në verzionin e gjuhës angleze të "Raporti i Stabilitetit Financiar 3".

relativisht i ri, dhe sipas njohurive të autores, koncepti i SIFI-ve u shfaq jo më herët se në vitin 2009.

Qëllimi i këtij artikulli është të analizojë rëndësinë sistemike të institucioneve financiare në sistemin bankar të Kosovës dhe të tërheqë e vëmendjen mbi kostot financiare dhe ekonomike që mund të shkaktohen nga mos-funksionimi i këtyre institucioneve. Në këtë artikull gjithashtu do të prezantohet analiza për identifikimin e institucioneve financiare me rëndësi sistemike në sistemin bankar të Kosovës (*angl. Systemically Important Banks: SIB*). Pjesa analitike e këtij artikulli kryesisht bazohet në udhëzimet e raportit të përbashkët të Bordit të Stabilitetit Financiar (*angl. Financial Stability Board: FSB*), Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës për Marrëveshje Ndërkombëtare (*angl. Bank for International Settlements: BIS*) të vitit 2009, që paraqet edhe iniciativën fillestare mbi masat e ndërmarra për të identifikuar dhe adresuar SIFI-t. Udhëzimet dhe kriteret e propozuara në raportin e BSF, BIS dhe FMN (2009) janë thjeshtëzuar, me qëllim të përshtatjes ndaj karakteristikave të sistemit bankar të Kosovës. Ky artikull është i organizuar si vijon. Pjesa e parë i përkushtohet elaborimit të konceptit të SIFI-ve dhe paraqet një përmbledhje të literaturës në këtë fushë. Pjesa e dytë parashtron kriteret për të identifikimin e SIFI-ve në sistemin bankar të Kosovës, pasuar nga analiza e rezultateve.

## 9.2. Çka paraqet rreziku sistematik?

Bordi Evropian i Rrezikut Sistemik (2010) definon rrezikun sistematik, si një ngjarje shqetësuese (mosfunksionim apo krizë) në sistemin financiar, efektet negative të së cilit kanë potencial të përcillen në tregun e brendshëm dhe në tërë ekonominë reale. Acharya *et al.* (2010) definon rrezikun sistematik si një rrezik potencial për shfaqjen e një krize financiare që mund të përhapet në të gjithë ekonominë, siç ishte rasti i krizës globale financiare që filloi në 2007/2008. Rrjedhimisht, ngjarja sistemike në sistemin financiar mund të marrë përmasa makroekonomike, dhe për pasojë, kostot që dalin nga rreziku sistematik janë po të këtyre përmasave. FMN, FSB dhe BIS (2009) përkufizojnë një ngjarje me rëndësi sistemike, bashkë me një grup të faktorëve që mund të kenë ndikim në tërë sistemin (ekonominë), si vijon:

“...çrregullimi apo mosfunksionimi i rrjedhës së shërbimeve financiare, ku një pjesë e shërbimeve financiare përkohësisht mund të mos jenë në dispozicion, si dhe situatat ku kosto e shfrytëzimit të shërbimeve financiare rritet ndjeshëm. Rreziku sistematik gjithashtu përfshinë ndërprerjet/pengesat që vijnë si nga jashtë sistemit financiar, ashtu edhe brenda tij. Mirëpo, një ngjarje me rëndësi sistemike nuk duhet të ngatërrohet me disa nga rastet tjera që kanë ndikim në rishpërndarjen e pasurisë, e që jo domosdo dëmtojnë sistemin financiar...”

Në anën tjetër, rastet kur institucionet financiare hasin në vështirësi në kryerjen e funksioneve të përditshme shkaku i një investimi me rrezikshmëri të lartë, ose një banke të caktuar i largohen depozitorët, nuk mund të konsiderohen si ngjarje me rëndësi sistemike. Këto paraqesin raste të rrezikut josistemik, pasi që kostot e përcjella nga një çrregullim i tillë financiar, p.sh. i një banke, nuk dalin jashtë vlerës së transaksioneve midis palëve të përfshira (p.sh. huadhënësit dhe huamarrësit e asaj banke), prandaj edhe rreziqet dhe kostot e kësaj natyre janë të një rëndësie (përmase) mikroekonomike.

Rreziku sistematik mund të definohet në aspekt të dy dimensioneve, përkatësisht dimensionin ndër-sektorial dhe dimensionin kohor. Dimensionin ndër-sektorial trajton çështjen e shpërndarjes së rrezikut në sektorin financiar apo prej sektorit financiar në sektorët tjerë, si p.sh. përmes ekspozimeve të përbashkëta apo borxhit të ndërvarur mes bankave. Ndërsa, dimensionin kohor i rrezikut sistematik i referohet rrezikut sistematik prej një periudhe në një periudhe tjetër, përkatësisht, rrezikut sistematik në kuptimin ciklik të fjalës. Për shembull, në periudhat e rritjes ekonomike, në vendet me zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik, trendi i huadhënies bankare zakonisht është i lidhur me normën reale të rritjes ekonomike

(prociklike). Në kohët e rritjes ekonomike, fitimet financiare të industrisë bankare janë në rritje, bankat ulin normat e interesit bashkë me kriteret për huamarrje me qëllim të zgjerimit të kredidhënies, ndërkohë që niveli i përceptuar i rrezikut për moskthimin e kredisë është i ulët. Huamarrësit në anën tjetër, me që preferojnë kredi më të lira, gjithashtu rrisin kërkesën për kredi. Pasi që ekonomia është duke kaluar një periudhë me normë pozitive të rritjes, edhe politikëbërësit mund të inkurajojnë zgjerimin e huadhënies nga ana e bankave. Kështu, duke u akumuluar nga periudha në periudhë, rreziku sistematik bëhet prociklik.

### 9.3. Çka janë institucionet me rëndësi sistemike (SIFI)?

Definicioni i institucioneve financiare me rëndësi sistemike (SIFI) nuk është i drejtpërdrejtë. Kjo për arsye se vende të ndryshme kanë si rregullativa dhe institucione të ndryshme që adresojnë SIFI-t, ashtu edhe nivele të ndryshme të zhvillimit të sistemit financiar. SIFI-t mund të definohen nga këndvështrimi i mbikëqyrjes mikroprudenciale dhe mbikëqyrjes makroprudenciale. Nga këndvështrimi mikroprudencial, një institucion financiar mund të kualifikohet si SIFI, atëherë kur dështimi/bankrotimi i tij u shkakton humbje depozitorëve, huamarrësve dhe gjithë pjesëmarrësve të përfshirë, mirëpo efektet negative nuk shtrihen jashtë vlerës së transaksioneve të palëve të involvuara. Në anën tjetër, nga aspekti i mbikëqyrjes makroprudenciale, SIFI-t janë institucione financiare me rol esencial në ekonomi, dështimi i së cilave do të shkaktonte pasoja jo vetëm në sektorin financiar, por edhe në tërë ekonominë.

Për të përcaktuar nëse një institucion financiar është i rëndësishëm për sistemin financiar dhe ekonominë në përgjithësi, Weistroffer (2011) jep dy pikëpamje. Pikëpamja e parë i konsideron si SIFI ato institucione financiare që janë të rëndësishme dhe domosdoshme për mirëqenien e sektorit financiar dhe ekonomisë. Pikëpamja e dytë i konsideron si SIFI ato institucione financiare, mosfunksionimi apo falimentimi i së cilave ka potencial të shkaktojë kosto të larta në sektorin financiar dhe t'i transferojë ato edhe në sektorin real.

Konceptet e rrezikut sistematik dhe të SIFI-ve janë ngushtë të lidhura me konceptin e efektit shpërndarës (*angl.* Contagion). Ky efekt në sektorin financiar përfaqëson një proces të përhapjes së rrezikut apo krizës njëkohësisht për disa apo të gjitha institucionet financiare në treg (De Bandt dhe Hartman, 2000). Për shembull, mosfunksionimi i një banke relativisht të madhe, e cila ka ekspozim të lartë në bankat e tjera në vend, mund të shkaktojë humbje në asetet dhe detyrimet e bankave tjera të përfshira në tregun ndër-bankar. Për rrjedhojë, falimentimi i një banke, mund të përhapë falimentimin e bankave tjera përmes humbjeve të shkaktuara në tregun ndër-bankar, apo përmes humbjeve në likuiditet të cilat pastaj mund të përhapen në tërë sektorin financiar (Iazzetta dhe Mana, 2009). Efekti i shpërndarjes në sektorin financiar, që ndryshe njihet edhe si 'efekti domino', mund të shkaktojë në të njëjtën kohë edhe humbjen e besimit në tregjet financiare, që rrjedhimisht çon në tërheqje të depozitave nga depozitorët, humbje në plasmanët ndër-bankare, rënie të kredidhënies, rënie të çmimeve të aksioneve, etj. Si pasojë, një pjesë e konsiderueshme e sektorit financiar mund të tronditet, duke përcjellë kostot e kësaj tronditjeje në tërë ekonominë (Upper, 2010).

### 9.4. Pse SIFI-t janë të rëndësishme?

Të kuptuarit e natyrës, shkaqeve dhe ndikimit të SIFI-ve në ekonomi janë parakushte për krijimin e politikave dhe mbikëqyrjes adekuate, si dhe për krijimin e instrumenteve që ndihmojnë apo zbusin periudhat krizës financiare. Kjo për arsye se, SIFI-t janë të domosdoshme dhe të pazëvendësueshme për mbarëvajtjen e sektorit financiar, mirëpo një tronditje e papritur dhe e pakontrolluar ndaj tyre gjithashtu mund të dëmtojë seriozisht

sistemin financiar dhe ekonominë në tërësi. Prandaj, identifikimi i SIFI-ve në sektorin financiar në çdo kohë, vlerësimi i kontributit të tyre në një ngjarje sistematike dhe adresimi paraprak e efikas përmes masave korrektive, mund të zvogëlojë përhapjen e rrezikut nga SIFI-t në rast të krizave. Masat që mund të ndërmerren për të zvogëluar rëndësinë e SIFI-ve, sipas propozimit të ESRB (2010), janë kryesisht masa kundër-ciklike (p.sh. rritja e kërkesës për kapital të bankave në periudhat me rritje ekonomike, rënia e kërkesës për kapital në periudhat me rënie ekonomike), parandalimin në mospërputhjen e maturitetit, kufizimin pritjeve për 'bail-out' (shpëtimin e bankave nga qeveria), kufizimin e ekspozimit ndaj institucioneve tjera, skemat e sigurimit të depozitave të bazuara në rrezik, etj. Këto paraqesin disa nga masat parandaluese ndaj krizave potenciale dhe që mund kontribuojnë në forcimin e infrastrukturës financiare dhe zvogëlojnë rëndësinë e një institucioni financiar për të gjithë sistemin (Thomson, 2009).

Për të kufizuar ndikimin negativ që mund të vijë nga ana e SIFI-ve në rast të një ngjarje sistematike (p.sh. krizës financiare), së pari këto institucione duhet të identifikohen. Duke marrë parasysh se SIFI-t shkaktojnë kosto jashtëzakonisht të mëdha në rast të tronditjeve financiare, siç edhe është mësuar nga rasti i krizës financiare globale, qeveritë dhe institucionet tjera ndërkombëtare mund të ndërhyjnë për shpëtimin e SIFI-ve nga falimentimi. Duke u mbështetur në mundësinë e mbështetjes nga institucionet shtetërore, SIFI-t mund të jenë të prirura të shkaktojnë probleme të natyrës së 'dëmit moral' (*angl. moral hazard*).

## 9.5. Matja e rëndësisë sistematike

Ndryshe nga qasja e mbikëqyrjes mikroprudenciale, ku të dhënat e nivelit bankar raportohen dhe përpilohen për mbikëqyrje të nivelit mikro, krijimi i një modeli për të identifikuar SIFI-t në ekonomi, mund të jetë veçanërisht i dobishëm sepse merr parasysh një kornizë më të gjerë, ku të dhënat e nivelit bankar analizohen në kontekst të të gjithë ekonomisë, që edhe njëherë tregojnë për natyrën makroekonomike të SIFI-ve. Literatura propozon dy qasje që mund të jenë të dobishme në identifikimin e SIFI-ve në sektorin financiar (Weistroffer, 2011; Bramer dhe Gische, 2012). Qasja e parë është një teknikë e bazuar në treg, e cila kryesisht mbështetet në modelet financiare dhe të dhënat e tregjeve financiare për të vlerësuar rëndësinë sistematike të institucioneve financiare. Këto modele zakonisht janë komplekse dhe vështirë zbatohen në praktikë, që len të nënkuptohet se edhe komunikimi i rezultateve për publikun nga kjo metodë është më kompleks (Drehmann dhe Tarashev, 2011). Qasja e dytë bazohet në indikatorët e institucioneve financiare, e cila zakonisht mbështetet vetëm në të dhënat e bilancit të gjendjes së bankave (FMN, FSB, BIS, 2009). Përveç faktit se paraqet një qasje më të thjeshtë dhe praktike, kjo metodë gjithashtu ka përparësinë se mbështetet në indikatorë relativisht më të qëndrueshëm, krahasuar me indikatorët e tregjeve financiare. Megjithatë, një disavantazh i metodës bazuar në indikatorët e bankave është se kërkon që ndarja e indikatorëve të bëhet në mënyrë arbitrare (Weistroffer, 2011).

Në korrik të vitit 2011, Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrje Bankare (BCBS), që vepron nën ombrellën e BIS-it, lëshoi një verzion preliminar të kriterëve që mund përdoren për identifikimin e SIFI-ve. Raporti liston pesë kriterë përkatëse, si: madhësia, ndërlidhja, zëvendësueshmëria, kompleksiteti dhe aktiviteti ndër-juridiksional (BCBS, 2011). BCSB i jep peshë të barabartë secilit kriter (p.sh. 5 kriterë, secili peshon 20%).

Ky studim trajton tri kriteret e para të propozuara nga FSB, FMN, BIS (2009), përkatësisht, madhësia, ndërlidhja dhe zëvendësueshmëria, të cilat kriterë mund të konsiderohen si më të përshtatshme për vendet me sektor financiar më pak të zhvilluar. *Madhësia* e institucioneve financiare zakonisht përfaqëson një nga faktorët më të rëndësishëm për identifikimin e rëndësisë sistematike. Rëndësia sistematike e një institucioni financiar, p.sh. e një banke, për funksionim të rregullt të sistemit bankar rritet varësisht



nga sasia apo vëllimi i shërbimeve financiare që ajo bankë ofron, në krahasim me bankat tjera në treg. Sipas kriterit të madhësisë, sa më e madhe të jetë një bankë, aq më e madhe është rëndësia sistemike e saj, meqë varësia e klientëve, huamarrësve dhe akterëve të përfshirë ndaj saj, është po ashtu më e madhe. Prandaj, edhe kostot që ndërlidhen me mosfunksionimin e një banke të madhe janë krahasimisht më të mëdha se sa kostot që rrjedhin nga mosfunksionimi një banke të vogël (Upper, 2010).

Rreziku sistematik që vjen nga *ndërlidhja* mes institucioneve financiare, ku rreziku i efektit shpërndarës zë vendin kryesor, paraqet rrezikun më të rëndësishëm sidomos në vendet me sisteme financiare të zhvilluara (ECB, 2011). Ndërlidhja e fortë dhe komplekse ndërmjet institucioneve financiare dhe institucioneve financiare me sektorët e tjerë ekonomik, po ashtu paraqet indikator të rëndësishëm sistemike. Kjo për arsye se ndërlidhjet e mëdha (pjesëmarrja e transaksioneve të një banke ndaj gjithsej transaksioneve të sistemit bankar) dhe kompleksiteti i ndërlidhjeve (ndërlidhjet me shumë institucione të tjera financiare) mund të shkaktojnë akumulimin e rreziqeve josistemike, që eventualisht mund të eskalojnë në një ngjarje sistemike, duke tërhequr edhe institucionet e tjera në humbje. Për shembull, rreziku sistematik mund të lindë përmes lidhjeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta midis bankave në tregun ndërbankar, ku problemet individuale të një banke mund të krijojnë pasoja mbi sistemin bankar nëpërmjet efektit shpërndarës. Meqë ndërlidhja mes institucioneve financiare rritë rëndësinë sistemike, e cila në rast të turbulencave pa dyshim që është e kushtueshme për ekonominë në shumë nivele, pyetja që lind është, pse institucionet financiare ekspozohen ndaj njëra-tjetrës, përmes investimeve me rrezik të lartë dhe borxheve të ndërvarura që përfundimisht mund të rrezikojnë gjithë sistemin? Para së gjithash, ndërlidhjet mes institucioneve financiare mundësojnë diversifikimin e rrezikut dhe mbrojtjen e investimeve të tyre nga humbjet potenciale (Battiston *et al.*, 2009). Megjithatë, këtu duhet pasur parasysh se vendimi i secilit institucion financiar për të investuar është i shtyrë nga stimuj individualë, që jo domosdoshmërisht diversifikojnë edhe rrezikun sistematik/makroekonomik. Prandaj, ndërlidhja mes institucioneve financiare jo çdoherë përfaqëson një situatë ideale për sistemin financiar ose të ekonomisë, pasi që institucionet individuale mund të mos llogarisin apo vlerësojnë pjesëmarrjen/kontributin e tyre në rrezikun sistematik në mënyrë adekuate. Së dyti, institucionet financiare mund të mos jenë të vetëdijshme për ekspozimet e institucioneve të tjera financiare, ose për nivelin e atyre ekspozimeve.

Një tjetër faktor i rëndësishëm që përdoret për të përcaktimin rëndësisë sistemike të institucioneve financiare lidhet me shkallën e *zëvendësueshmërisë* së produkteve dhe shërbimeve bankare të ofruara nga institucionet individuale. Rëndësia sistemike e një banke rritet kur, në rast falimentimi, bankat e tjera nuk mund të sigurojnë produkte të ngjashme me të. Me fjalë tjera, edhe nëse një produkt apo shërbim ofrohet vetëm nga një bankë në treg, rëndësia e sistemike e kësaj banke do të ishte më e vogël, *ceteris paribus*, nëse bankat ekzistuese apo hyrjet e reja në treg lehtësisht mund të zëvendësojnë të njëjtat shërbime, po që se banka në fjalë pëson vështirësi në ofrimin e tyre (Thomson, 2009).

Secila nga këto tri kritere (madhësia, ndërlidhja dhe zëvendësueshmëria) paraqesin një mjet të dobishëm për identifikimin dhe analizën e rëndësisë sistemike. Gjithsesi, vlerësimet për SIFI-t janë më të qëndrueshme kur të tri kriteret kombinohen dhe merren parasysh së bashku.

## 9.6. Identifikimi i SIFI-ve në sistemin bankar të Kosovës

### 9.6.1. Sistemi referencial

Sistemi referencial apo tregu krahasues për identifikimin dhe vlerësimin e SIFI-ve, mund të jetë lokal, rajonal, kombëtar ose ndërkombëtar (FSB, FMN dhe BIS, 2009). Meqë Kosova ka një sistem bankar me një strukturë relativisht të thjeshtë, ne do të identifikojmë SIFI-t

në sistemin bankar të Kosovës duke marrë si sistem referimi tregun e brendshëm apo kombëtar.

### 9.6.2 Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë

Duke marrë parasysh se më shumë se 70 përqind e sektorit financiar në Kosovë përbëhet nga sistemi bankar, pjesa analitike e këtij artikulli do të përqendrohet në identifikimin e bankave me rëndësi sistemike (*angl. Systemically Important Banks: SIB*) në Kosovë. Për këtë analizë, ky artikull merr për bazë udhëzimet në raportin e përpiluar nga FSB, FMN dhe BIS (2009), duke aplikuar një verzion të thjeshtësuar, për t'iu përshtatur karakteristikave të sistemit bankar të Kosovës. Meqë asnjë nga bankat që operojnë në Kosovë nuk janë të listuara në tregjet financiare ndërkombëtare, analiza e SIB-ve në sistemin bankar të Kosovës do të bazohet në indikatorët e e bilancit të gjendjes, që paraqet një qasje më praktike në aspektin e mbikëqyrjes mikroprudenciale dhe makroprudenciale, si dhe gjeneron rezultate më gjithëpërfshirëse në rastet e vendimmarrjes. Analiza të ngjashme ku SIB-it identifikohen bazuar në indikatorët e bankave individuale mund të hasen edhe në rastin e bankave qendrore të Republikës Çeke, Moldavisë dhe Australisë (Komrakova *et al.*, 2011; Moore dhe Zhou, 2012; Bramer dhe Gischer, 2012).

### 9.7. Metodologjia

Ky artikull realizon analizën për identifikimin e SIB-ive bazuar në metodën ndër-sektoriale të indikatorëve individual të bankave. Burimi i të dhënave për këtë studim janë bilancet e gjendjes së vitit 2011. Të dhënat janë të nivelit të bankave, për secilën nga 8 bankat që operojnë në Kosovë. Në identifikimin e bankave me rëndësi sistemike në Kosovë, bankat janë kontrolluar sipas tri kriterëve (madhësia, zëvendësueshmëria dhe ndërlidhja) dhe sipas indikatorëve të secilës kategori (Tabela 1).

Për të tri kriteret e përdorura, peshat janë caktuar si vijon: madhësia = 40%, zëvendësueshmëria = 40% dhe ndërlidhja = 20%. Siç tregohet në tabelën 1, gjithsej 18 tregues janë marrë parasysh. Secilit tregues brenda një kriteri (p.sh. madhësisë) i është caktuar peshë e barabartë. Për shembull, një treguesi që i përket kriterit të madhësisë apo kriterit të zëvendësueshmërisë i është caktuar pesha prej 5% (sepse madhësia/zëvendësueshmëria = 40% pjesëtuar me 8 tregues = 5%), ndërsa treguesve në grupin e kriterit të ndërlidhjes u është përlllogaritur pesha prej 6.67% (20% pjesëtuar me 3 tregues = 6.67%).

Në vazhdim janë përlllogaritur vlerat mesatare të çdo treguesi për të tërë sistemin, të cilat kanë shërbyer si pika referimi për treguesit individualë të secilës bankë. Për shembull, nëse mesatarja e peshuar e një treguesi (p.sh. depozitave) të një banke ka qenë më e madhe se mesatarja e sektorit, atëherë ajo bankë është konsideruar me rëndësi sistemike për indikatorin e caktuar. Ngjashëm me indikatorët individualë është vepruar edhe me kriteret. Për shembull, nëse mesatarja e peshuar e një banke ka rezultuar më e lartë se mesatarja e sektorit në njërin nga kriteret (p.sh. madhësia), atëherë ajo bankë është konsideruar me rëndësi sistemike. Bankat, mesatarja e peshuar e së cilave ka rezultuar më e ulët se mesatarja e sektorit, janë cilësuar si jo të rëndësishme sistemikisht. Kjo procedurë është aplikuar për secilën bankë veçmas.

**Tabela 1. Indikatorët e bilancit të gjendjes për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike në Kosovë**

Kriteri	Indikatorët
Madhësia = 40%	1. Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK 2. Depozitat 3. Kapitali vetanak i bankës/Gjithsej kapitali vetanak I sistemit 4. Plasmanet e bankës nga bankat tjera 5. Letrat me vlerë 6. Fitimi i mbajtur 7. Numri i depozitorëve të bankës/Gjithsej numri I depozitorëve të sistemit 8. Aseteve likuide të bankës/Gjithsej asetet likuide të sistemit
Zëvendësueshmëria = 40%	9. Kreditë bujqësore të bankës/Gjithsej kreditë e sistemit 10. Kreditë e ekonomive familjare të bankës/Gjithsej kreditë e sistemit 11. Kreditë tregtare/Gjithsej kreditë e sistemit 12. Kreditë e industrisë së energjisë/Gjithsej kreditë e sistemit 13. Depozitat qeveritare të bankës/Gjithsej depozitat e sistemit 14. Depozitat e ndërmarrjeve publike të bankës/Gjithsej depozitat e sistemit 15. Gjithsej kreditë e bankës/Gjithsej asetet e sistemit
Ndërlidhja = 20%	16. Plasmanet e bankave në bankat tjera 17. Letrat me vlerë 18. Borxhi i ndërvarur

## 9.8. Rezultatet

Në përgjithësi, tri bankat më të mëdha në Kosovë rezultuan qartë me rëndësi sistemike në tri kriteret e konsideruara, përkatësisht në kriterin e madhësisë, zëvendësueshmërisë dhe ndërlidhjes. Po ashtu, edhe disa nga bankat më të vogla rezultuan me rëndësi sistemike në disa tregues. Më saktësisht, kriteri i madhësisë, apo madhësia a bankave, doli të jetë si kriteri me rëndësinë më të madhe sistemike, ku tri bankat më të mëdha në vend, në secilin rast dolën të jenë të rëndësishme sistemikisht (Tabela 2). Brenda kriterit të madhësisë, treguesit individualë (të agreguar për të gjitha bankat) që rezultuan me rëndësi sistemike ishin: depozitat, kapitali vetanak, plasmanet e bankave, pjesëmarrja e numrit të depozitorëve dhe fitimi i mbajtur.

Lidhur me kriterin e zëvendësueshmërisë, pesë banka rezultuan me rëndësi sistemike, ku tri prej tyre ishin banka të mëdha, dhe dy të tjera relativisht më të vogla. Kjo do të thotë se në disa tregues, bankat e vogla gjithashtu janë sistemikisht të rëndësishme dhe dominojnë në ofrimin e produkteve apo shërbimeve të caktuara në treg. Treguesit që dolën me rëndësi sistemike brenda kriterit zëvendësueshmërisë, janë: pjesëmarrja e kredive bujqësore, pjesëmarrja e kredive të konsumit, pjesëmarrja e kredive të industrisë dhe tregtisë, dhe pjesëmarrja e pagesave përmes sistemit të pagesave.

Bankat që qartë rezultuan me rëndësi sistemike, për kriterin e ndërlidhjes, janë tri bankat më të mëdha, ndërsa dy bankat më të vogla qëndrojnë afër klasifikimit. Kjo do të thotë se tri bankat më të mëdha kanë më shumë ndërlidhje me bankat tjera, ndërsa bankat tjera që dolën si sistemikisht të parëndësishme, kanë nivel të ulët të ndërlidhjes ose nuk janë fare të ndërlidhura me institucionet tjera. Megjithatë, duhet të theksohet se niveli i ndërlidhjeve ndërmjet bankave është relativisht i ulët për të gjitha bankat në vend, kështu që edhe rreziku sistematik potencial që mund të vije nga ndërlidhja konsiderohet i ulët.

**Tabela 2. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në sektorin bankar të Kosovës**

*Bankat/Kriteri	Madhësia	Zëvendësueshmëria	Ndërlidhja
Banka A			
Banka B		√	
Banka C		√	
Banka D			
Banka E	√	√	√
Banka F			
Banka G	√	√	√
Banka H	√	√	√

\*Vërejtje: radhitja e bankave është e rastësishme.

Treguesit që shfaqën rëndësi sistemike brenda kriterit të ndërlidhjes ishin: plasmanët e bankave dhe letrat me vlerë. Vlenë të ceket se ndërlidhja mes bankave në Kosovë, nëpërmjet plasmanëve bankare apo produkteve tjera, është mjaft e ulët; ndërlidhja është më e shprehur në mes të bankave vendore me bankat jashtë vendit, dhe atë kryesisht me bankat amë.

## 9.9. Përmbledhje

Përkundër faktit se koncepti i rrezikut sistematik fitoi vëmendje kryesisht pas ndodhjes së disa krizave financiare (p.sh. kriza financiare aziatike, gjatë viteve të '90-ta), koncepti i institucioneve financiare me rëndësi sistemike (SIFIs apo SIB-ve) erdhi në shprehje vetëm pas krizës së fundit financiare, që filloi në vitin 2007/2008. Esenca e debatit për SIFI-t qëndron në faktin se institucionet mbikëqyrëse, siç janë bankat qendrore apo institucionet tjera, duhet t'i kushtojnë vëmendje institucioneve financiare jo vetëm nga aspekti individual (mikro), por të vënë ato në një perspektivë më të gjerë, ku ndikimi i SIFI-ve shihet si i ndërlidhur me tërë ekonominë. Rëndësia e kësaj analize qëndron në faktin se mosfunksionimi i këtyre institucioneve (SIFI-ve apo SIB-ve) mund të paraqesë kërcënim serioz për stabilitetin financiar dhe atë makroekonomik, duke shkaktuar krizë financiare dhe rrjedhimisht edhe kosto të mëdha për tërë ekonominë, siç është vënë re në krizën e fundit financiare.

Pas elaborimit të koncepteve të SIFI-ve dhe SIB-ve, ky artikull konkretisht ka analizuar bankat me rëndësi sistemike në sistemin bankar të Kosovës (SIB). Me qëllim të realizimit të kësaj analize, modeli për identifikimin e SIB-ve në Kosovë është mbështetur në tri kriteret, përkatësisht, madhësia, zëvendësueshmëria dhe ndërlidhja. Në lidhje me kriterin e madhësisë, rezultatet sugjerojnë se tri bankat më të mëdha në Kosovë qartë cilësohen si të rëndësishme për sistemin. Sa i përket kriterit të zëvendësueshmërisë, përveç tri bankave më të mëdha në vend, dy banka të tjera relativisht të vogla po ashtu u cilësuan me rëndësi

sistemike. Përkundër nivelit relativisht të ulët të ndërlidhjes mes bankave në Kosovë në përgjithësi, tri bankat më të mëdha në vend rezultuan me rëndësi sistemike.



## Shtojcë Statistikore





Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sistemi i bankar	Grupi bazë i indikatorëve	2009	2010	2011	Qer 2012
<b>Mjaftueshmëria e kapitalit</b>	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	18.1	18.8	17.6	17.2
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	15.2	15.8	14.8	14.4
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	2.9	3.7	4.4	5.2
<b>Cilësia e asetëve</b>	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	4.3	5.2	5.8	6.5
	Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive				
	<i>Korporatat tjera financiare</i>	0.2	0.4	0.5	1.0
	<i>Korporatat publike jofinanciare</i>	0.02	0.43	0.09	0.08
	<i>Korporatat tjera jofinanciare</i>	73.1	69.6	69.2	68.1
	<i>Ekonomitë familjare</i>	26.7	29.5	30.1	30.7
	<i>Gjithsej</i>	100.0	100.0	100.0	100.0
<b>Profitabiliteti</b>	Kthimi në asetëve (ROA)*	1.5	1.8	1.7	1.0 **
	Kthimi në kapital (ROE)*	15.0	18.8	17.4	9.7 **
	Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto	74.4	74.5	75.2	75.4
	Shpenzimet jo-interes ndaj të hyrave bruto	80.2	74.3	76.8	86.6
<b>Likuiditeti</b>	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	34.6	32.3	26.6	22.6
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	37.3	36.8	31.3	28.9
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	43.6	40.6	33.7	28.3
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	47.0	46.2	39.6	36.2
<b>Senzitiviteti ndaj riskut të tregut</b>	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	12.4	0.1	2.5	2.4
	<b>Grupi i zgjeruar i indikatorëve</b>				
	Kapitali ndaj asetëve	9.8	10.1	10.2	10.3
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	64.6	72.4	77.8	80.9
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointerеси	39.4	39.4	38.7	38.4
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	10.1	10.9	10.2	9.9
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	129.8	126.2	117.5	112.2
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	5.4	4.9	4.9	4.6

\* Janë konsideruar të hyrat neto para taksës.

\*\* ROA dhe ROE për qershor 2012 janë të përvitësuar.

Udhëzuesi: Financial Soundness Indicators, Compilation Guide, IMF (2006)

Tabela 2. Bilancet e gjendjes së bankave komerciale, qershor 2012, në milionë euro

## Procredit Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	85.1	Bilanci nga bankat tjera	1.5
Bilanci me bankat komerciale	54.0	Depozitat	632.3
Letrat me vlerë	100.0	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	535.8	Detyrimet tjera	62.6
Asetet fikse	19.0	Borxhi i ndërvarur	24.5
Asetet tjera	12.6	Mjetet vetanake	85.5
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>806.4</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>806.4</b>

Burimi: BQK (2012)

## Raiffeisen Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	70.7	Bilanci nga bankat tjera	1.4
Bilanci me bankat komerciale	58.5	Depozitat	518.2
Letrat me vlerë	65.6	Huamarrjet tjera	8.4
Kreditë	455.0	Detyrimet tjera	55.6
Asetet fikse	7.6	Borxhi i ndërvarur	0.0
Asetet tjera	6.1	Mjetet vetanake	80.0
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>663.6</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>663.6</b>

Burimi: BQK (2012)

## Banka për Biznes

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	26.3	Bilanci nga bankat tjera	0.0
Bilanci me bankat komerciale	9.5	Depozitat	103.2
Letrat me vlerë	4.6	Huamarrjet tjera	5.0
Kreditë	81.4	Detyrimet tjera	7.7
Asetet fikse	2.2	Borxhi i ndërvarur	0.0
Asetet tjera	3.0	Mjetet vetanake	11.0
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>126.9</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>126.9</b>

Burimi: BQK (2012)

**Banka Ekonomike**

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	24.4	Bilanci nga bankat tjera	3.2
Bilanci me bankat komerciale	19.6	Depozitat	132.2
Letrat me vlerë	3.1	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	102.3	Detyrimet tjera	10.4
Asetet fikse	2.3	Borxhi i ndërvarur	0.0
Asetet tjera	7.2	Mjetet vetanake	13.2
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>159.0</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>159.0</b>

Burimi: BQK (2012)

**Banka Kombëtare Tregtare**

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	16.5	Bilanci nga bankat tjera	8.3
Bilanci me bankat komerciale	0.7	Depozitat	125.9
Letrat me vlerë	8.5	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	115.4	Detyrimet tjera	11.3
Asetet fikse	4.4	Borxhi i ndërvarur	0.0
Asetet tjera	2.6	Mjetet vetanake	2.6
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>148.1</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>148.1</b>

Burimi: BQK (2012)

**NLB Prishtina**

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	34.2	Bilanci nga bankat tjera	0.2
Bilanci me bankat komerciale	86.6	Depozitat	337.4
Letrat me vlerë	33.2	Huamarrjet tjera	11
Kreditë	252.1	Detyrimet tjera	30.2
Asetet fikse	9.1	Borxhi i ndërvarur	-
Asetet tjera	2.6	Mjetet vetanake	39.1
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>417.7</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>417.7</b>

Burimi: BQK (2012)

## TEB Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	31.2	Bilanci nga bankat tjera	6.0
Bilanci me bankat komerciale	6.0	Depozitat	208.5
Letrat me vlerë	0.5	Huamarrjet tjera	-
Kreditë	208.5	Detyrimet tjera	12.5
Asetet fikse	3.4	Borxhi i ndërvarur	7
Asetet tjera	3.2	Mjetet vetanake	19.2
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>252.7</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>252.7</b>

Burimi: BQK (2012)

## Komercijalna Banka

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	9.9	Bilanci nga bankat tjera	0.0
Bilanci me bankat komerciale	30.4	Depozitat	35.9
Letrat me vlerë	0.0	Huamarrjet tjera	3
Kreditë	3.9	Detyrimet tjera	1.1
Asetet fikse	0.0	Borxhi i ndërvarur	-
Asetet tjera	0.6	Mjetet vetanake	5.1
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>44.8</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>44.8</b>

Burimi: BQK (2012)

Tabela 3.1. Pasqyra e korporatave financiare - asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto								Kërkesat e brendshme								
	Kërkesat ndaj jorezidentëve		prej të cilave:					Minus: detyrimet ndaj jorezidentëve	Kërkesat ndaj qeverisë qendrore			Kërkesat ndaj sektorëve tjerë	Kreditë prej të cilave:				
			Ari monetar dhe DST-të	Depozita	Letrat me vlerë përveç aksioneve	Kuota në FMN	Asetet dhe ekuitetet tjera		Kërkesat ndaj qeverisë qendrore	Minus: detyrimet ndaj qeverisë	Depozita		Korp. tjera jo financa	Ek. familjare			
2005 Dhjetor	827.3	890.9	—	422.6	242.4	—	145.3	63.6	348.9	-225.7	—	225.7	225.7	574.6	565.6	439.6	126.0
2006 Dhjetor	1,173.6	1,245.7	—	660.0	341.3	—	170.8	72.1	231.7	-475.0	—	475.0	475.0	706.6	694.3	548.2	146.1
2007 Dhjetor	1,622.4	1,704.6	—	955.0	408.9	—	175.4	82.3	124.5	-853.3	—	853.3	853.3	977.8	965.9	765.1	200.6
Qershor	1610.7	1,789.3	—	654.7	862.5	—	132.1	178.6	501.2	-900.6	—	900.6	900.6	1,401.8	1,384.0	1,072.7	311.2
Shtator	1,740.1	2,009.2	60.8	768.0	895.1	—	138.3	269.1	535.3	-871.9	—	871.9	871.9	1,407.2	1,387.8	1,055.6	329.7
2009 Dhjetor	1,700.5	2,036.2	60.3	910.1	724.5	64.3	144.3	335.7	571.5	-846.3	—	846.3	846.3	1,417.8	1,396.1	1,052.3	343.5
Mars	1,759.2	2,116.8	62.4	1,003.7	635.3	66.5	211.5	357.6	589.3	-878.3	—	878.3	878.3	1,467.6	1,446.1	1,052.9	386.2
Qershor	1,732.6	2,098.1	67.0	961.2	568.5	71.4	252.3	365.5	601.1	-940.7	—	940.7	940.7	1,541.8	1,518.9	1,100.0	412.3
Shtator	1,956.3	2,345.2	63.0	1,196.7	566.1	67.3	244.7	389.0	561.0	-993.2	—	993.3	993.3	1,554.2	1,531.5	1,102.2	422.8
2010 Dhjetor	1,957.5	2,387.7	64.0	1,257.8	525.2	68.5	269.3	430.2	766.8	-824.8	—	824.8	824.8	1,591.6	1,568.3	1,127.7	434.2
Mars	2,027.1	2,456.6	61.8	1,250.7	586.5	66.2	294.0	429.5	734.3	-913.5	—	913.5	913.5	1,569.9	1,542.6	1,181.2	438.8
Qershor	1,988.0	2,421.3	60.9	1,171.3	640.0	65.4	293.9	433.3	840.1	-905.2	—	905.2	905.2	1,745.3	1,716.2	1,233.3	482.1
Shtator	2,108.2	2,511.5	63.3	1,297.5	539.1	68.0	332.7	403.3	862.2	-905.5	—	905.5	905.5	1,767.7	1,740.8	1,235.1	504.2
2011 Dhjetor	2,080.3	2,454.3	65.1	1,369.2	230.0	70.1	533.1	374.0	989.0	-798.4	—	798.4	798.4	1,787.4	1,761.7	1,244.1	514.6
Mars	2,087.9	2,449.5	63.8	1,179.7	346.9	68.8	580.9	361.6	1,000.8	-788.9	29.9	818.8	818.8	1,789.7	1,762.0	1,238.7	521.1
2012 Qershor	2,081.2	2,445.1	66.4	1,257.2	239.1	71.9	598.7	363.9	1,057.1	-801.1	29.9	831.0	831.0	1,858.3	1,832.9	1,281.9	548.6

Burimi: BQK (2012)

Tabela 3.2. Pasqyra e korporatave financiare - detyrimet

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Depozitat									Kreditë	Rezerva teknike të sigurimit			Asetet dhe ekuitete tjera	Zëra tjerë (neto)
	Dep. e transferu eshme	prej të cilave:			Dep. tjera	prej të cilave:			Ek. neto i ek. familjare ne fondet e pens.		Pagesa e premive dhe rezervave				
		Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare		Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare							
2005 Dhjetor	830.6	315.0	67.6	76.8	155.5	515.6	181.3	33.7	298.9	3.0	174.5	152.4	22.1	165.8	2.2
2006 Dhjetor	886.4	300.5	34.8	96.4	156.2	586.0	193.3	27.6	359.5	3.4	251.4	223.9	27.5	209.3	54.7
2007 Dhjetor	1,110.9	386.1	49.6	133.5	187.5	724.8	188.4	43.8	489.3	...	316.1	286.2	29.9	273.8	46.0
Qershor	1,393.2	381.9	25.4	136.4	211.2	1,011.3	245.4	72.2	690.7	...	337.7	303.6	34.1	328.3	52.6
Shtator	1,512.3	435.4	39.9	157.6	225.7	1,076.9	256.8	75.7	742.3	...	385.3	350.0	35.4	324.4	53.5
2009 Dhjetor	1,444.3	483.2	50.1	184.0	237.7	961.0	73.9	82.9	801.9	...	422.3	380.8	41.5	326.1	79.3
Mars	1,474.3	457.8	51.4	145.2	251.6	1,016.5	91.4	75.6	848.6	...	454.5	412.6	41.9	340.4	79.3
Qershor	1,454.8	477.8	44.8	153.8	270.2	977.0	31.3	76.7	868.1	...	456.2	412.5	43.8	351.4	71.3
Shtator	1,573.1	520.4	55.9	170.3	281.4	1,052.8	38.6	76.8	936.4	...	500.8	454.7	46.1	346.3	97.0
2010 Dhjetor	1,744.2	621.2	83.8	218.6	303.5	1,123.1	42.8	83.4	995.9	...	540.5	493.7	46.8	361.0	78.6
Mars	1,737.8	596.2	107.5	178.2	295.9	1,141.6	34.7	80.0	1,025.9	...	572.6	524.2	48.3	364.9	86.2
Qershor	1,757.4	591.4	72.0	185.9	315.2	1,166.0	48.0	75.0	1,039.9	...	602.7	551.5	51.1	373.1	94.7
Shtator	1,900.9	662.1	99.1	205.0	336.9	1,238.8	51.7	81.0	1,102.9	...	598.5	545.9	52.6	377.3	93.7
2011 Dhjetor	1,940.2	665.1	75.5	208.1	360.9	1,275.1	60.8	79.7	1,129.6	...	647.8	593.3	54.5	395.1	86.2
Mars	1,905.7	626.7	32.2	212.4	363.2	1,279.0	46.2	73.1	1,154.6	...	698.6	642.9	55.7	405.1	79.4
2012 Qershor	1,931.6	651.7	24.7	223.2	379.6	1,279.9	59.5	75.8	1,141.1	...	717.3	659.1	58.3	389.0	100.3

Burimi: BQK (2012)

Tabela 4.1. Bilanci i gjendjes së KTD-ve - asetet

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Asete gjithsej													
	Paraja e gatshme		Bilanci me bankat komerciale			Letrat me vlerë	Kreditë bruto	prej të cilave në euro:				Kreditë bruto në valutën jo euro	Asetet fikse	Asete tjera
			Në valutën euro	Në valutat jo euro	Korp. tjera financiare			Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare				
2001 Dhjetor	519.8	265.1	212.8	212.8	.	7.5	25.9	—	—	25.9	—	—	4.5	3.9
2002 Dhjetor	473.7	81.3	292.7	292.7	.	...	86.5	—	—	80.8	5.7	—	9.5	3.7
2003 Dhjetor	589.2	106.2	106.2	106.2	.	119.6	232.8	—	0.2	193.5	39.0	—	12.3	12.2
2004 Dhjetor	816.5	116.5	186.0	169.2	16.8	112.3	373.7	—	...	289.9	83.7	—	15.9	12.2
2005 Dhjetor	984.4	131.7	221.9	201.0	21.0	82.9	513.9	—	...	387.9	126.0	—	16.9	17.0
2006 Dhjetor	1,161.2	141.1	243.3	218.8	24.5	99.4	636.6	—	...	490.5	146.1	—	23.0	17.9
2007 Dhjetor	1,435.0	189.0	208.1	173.4	34.7	78.9	892.1	—	0.2	691.3	200.6	—	27.2	39.7
2008 Dhjetor	1,808.2	218.2	283.9	236.3	47.6	40.5	1,183.4	0.6	0.1	901.7	281.0	—	39.0	43.1
2009 Dhjetor	2,204.1	322.7	405.6	326.7	78.8	97.0	1,289.0	2.3	0.3	942.9	343.5	—	43.1	46.7
Maj	2,208.1	258.3	372.8	306.8	66.1	122.5	1,380.8	4.1	6.4	965.3	400.9	2.8	42.5	31.2
Qershor	2,218.8	268.1	351.6	282.6	69.0	114.0	1,404.6	4.0	6.4	977.6	412.3	3.1	42.6	37.8
Korrik	2,215.5	283.5	322.2	259.2	63.0	115.8	1,413.1	3.9	6.3	980.1	418.6	2.9	42.4	38.3
Gusht	2,270.5	311.9	355.5	293.7	61.8	115.3	1,406.8	3.8	6.3	972.8	419.1	3.0	42.2	38.7
Shtator	2,295.4	280.1	368.7	306.0	62.7	155.0	1,418.6	3.9	6.3	981.6	422.8	2.3	42.3	30.6
Tetor	2,273.0	270.8	331.3	266.4	64.9	166.4	1,428.1	6.6	9.8	980.1	427.7	2.1	43.2	33.1
Nëntor	2,352.0	270.9	385.7	311.9	73.8	168.4	1,452.6	6.5	9.8	1,000.2	431.3	3.0	43.3	31.1
2010 Dhjetor	2,455.0	307.5	439.0	367.2	71.8	173.4	1,458.7	5.7	6.3	1,008.3	434.2	2.5	44.0	32.3
Janar	2,422.4	273.4	445.8	369.9	75.9	165.6	1,460.2	6.7	6.3	1,008.8	434.2	2.4	43.6	33.7
Shkurt	2,452.8	279.0	445.4	364.5	80.9	169.9	1,484.0	6.0	0.3	1,037.2	436.0	2.7	43.7	30.9
Mars	2,466.4	278.1	425.1	343.3	81.8	170.1	1,513.2	7.0	0.2	1,062.8	438.8	2.5	43.3	36.7
Prill	2,465.0	281.7	383.5	320.8	62.7	168.1	1,541.0	5.5	0.6	1,077.1	453.6	2.3	45.0	45.7
Maj	2,496.8	265.6	357.6	271.1	86.5	187.8	1,599.9	5.5	0.4	1,104.0	468.5	2.4	44.9	41.1
Qershor	2,501.1	265.3	319.5	243.9	75.6	205.6	1,624.9	5.8	0.3	1,115.0	482.1	2.4	45.0	40.8
Korrik	2,553.8	290.0	354.9	286.1	68.8	191.3	1,629.1	5.6	0.5	1,110.7	490.5	2.3	45.1	43.4
Gusht	2,659.9	330.4	355.9	287.1	69.8	188.7	1,630.9	6.2	0.4	1,108.8	490.0	6.1	44.9	49.0
Shtator	2,631.9	292.5	392.5	311.2	81.3	204.8	1,656.3	6.8	0.4	1,122.7	499.4	7.1	44.9	40.9
Tetor	2,613.0	291.0	358.6	274.0	84.6	198.2	1,678.8	6.8	1.5	1,126.3	504.4	6.4	45.9	40.6
Nëntor	2,629.4	297.3	357.6	271.0	86.6	196.1	1,686.2	7.3	1.5	1,129.0	508.3	6.4	46.1	46.1
2011 Dhjetor	2,649.7	331.5	329.5	251.8	77.7	202.0	1,698.1	8.3	1.5	1,136.1	510.9	7.3	47.4	41.3
Janar	2,648.3	329.6	358.6	276.9	81.6	189.7	1,683.1	16.6	1.4	1,116.1	509.4	7.1	48.0	39.4
Shkurt	2,660.6	340.5	337.5	260.3	77.2	200.3	1,692.2	16.1	1.3	1,127.3	508.0	6.6	48.0	42.0
Mars	2,634.3	308.5	291.4	212.8	78.6	222.9	1,717.1	16.1	1.4	1,142.4	517.5	6.8	48.7	45.6
Prill	2,619.2	297.2	279.6	200.9	78.7	206.3	1,740.8	16.7	1.4	1,157.3	527.4	6.9	48.5	46.7
Maj	2,638.8	299.1	278.2	205.6	72.6	209.9	1,755.3	17.3	1.5	1,160.1	537.7	7.1	48.7	47.6
2012 Qershor	2,652.3	298.4	265.3	203.3	62.0	215.6	1,776.3	18.3	1.5	1,172.5	544.7	7.6	49.9	46.9

Burimi: BQK (2012)

Tabela 4.2. Bilanci i gjendjes së KTD-ve - detyrimet

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Detyrime gjithsej											
	Bilanci me bankat tjera	Depozitat					Provizionet (write-downs)	Detyrime tjera	Borxhi i ndërruarur	Burimet vetanake	prej të cilave:	
		Dep. e transferueshme	Dep. tjera	Depozita të kursimit	Huamarrje tjera	Kapitali aksionar						
2001 Dhjetor	519.8	.	492.3	365.4	126.8	-	5.0	...	2.0	...	20.4	18.4
2002 Dhjetor	473.7	.	427.2	295.9	131.3	-	5.4	...	6.6	13	33.2	30.8
2003 Dhjetor	589.2	18	514.0	290.5	223.5	-	8.9	...	17.5	2.0	45.0	44.1
2004 Dhjetor	816.5	14.3	694.5	281.0	413.5	-	14	...	27.9	9.3	69.1	57.7
2005 Dhjetor	984.4	23.0	836.7	296.6	540.1	-	6.4	...	37.3	7.0	74.0	62.4
2006 Dhjetor	1,161.2	30.3	924.3	308.9	615.4	-	4.2	...	92.1	7.0	103.3	78.4
2007 Dhjetor	1,435.0	25.8	1,143.1	380.7	762.4	-	2.7	...	103.7	7.0	152.7	114.9
2008 Dhjetor	1,808.2	34.9	1,444.1	429.8	1,014.2	-	...	...	129.8	7.0	192.5	145.9
2009 Dhjetor	2,204.1	58.5	1,744.9	517.8	1,229.5	-	...	...	171.7	24.4	204.6	159.4
Maj	2,208.1	68.6	1,749.3	536.2	914.9	298.2	...	1.1	146.7	24.4	218.0	163.4
Qershor	2,218.8	65.1	1,751.5	525.8	923.6	302.0	...	1.1	152.4	24.4	224.3	164.4
Korrik	2,215.5	75.2	1,733.9	560.6	864.8	308.5	...	0.9	153.2	24.4	227.8	164.4
Gusht	2,270.5	74.3	1,796.4	576.3	901.6	318.5	...	0.7	152.9	24.5	221.7	169.4
Shtator	2,295.4	74.3	1,804.4	558.6	927.0	318.7	...	0.7	166.7	25.5	223.9	169.4
Tetor	2,273.0	91.3	1,757.3	563.2	876.9	317.1	...	0.4	164.0	32.0	228.1	169.4
Nëntor	2,352.0	88.3	1,836.2	600.7	905.9	329.5	...	0.1	165.3	32.0	230.2	169.4
2010 Dhjetor	2,455.0	94.0	1,936.9	671.0	923.2	342.7	...	0.1	160.0	33.5	230.5	170.4
Janar	2,422.4	89.6	1,902.1	623.6	929.9	348.6	...	0.1	161.9	33.5	235.2	170.4
Shkurt	2,452.8	100.2	1,918.2	648.2	923.0	346.9	...	0.1	166.8	33.5	234.0	170.4
Mars	2,466.4	105.3	1,919.4	645.0	928.8	345.7	...	0.1	172.4	33.5	235.6	170.4
Prill	2,465.0	109.2	1,909.5	632.6	936.2	340.7	...	0.1	174.4	33.5	238.3	170.4
Maj	2,496.8	93.4	1,949.4	638.8	968.6	342.0	...	0.1	184.4	33.5	236.0	170.4
Qershor	2,501.1	86.6	1,957.8	640.9	978.1	338.8	...	0.1	183.1	33.5	239.9	170.4
Korrik	2,553.8	86.0	2,005.8	679.9	982.2	343.7	...	0.1	184.1	33.5	244.2	169.1
Gusht	2,659.9	77.2	2,113.7	756.1	1,011.0	346.6	2.2	0.1	188.7	36.0	242.0	176.6
Shtator	2,631.9	44.2	2,098.0	718.0	1,035.4	344.6	32.3	0.1	182.6	31.0	243.5	176.6
Tetor	2,613.0	43.1	2,073.6	694.1	1,037.7	341.8	32.2	0.1	184.7	31.0	248.2	176.6
Nëntor	2,629.4	45.9	2,075.6	695.1	1,035.1	345.5	32.6	0.2	193.4	31.0	250.6	176.6
2011 Dhjetor	2,649.7	40.0	2,104.0	699.0	1,056.8	348.2	30.4	0.2	189.9	31.0	254.2	176.6
Janar	2,648.3	33.7	2,113.5	678.4	1,084.1	351.1	30.4	0.2	182.2	31.0	257.2	176.9
Shkurt	2,660.6	28.3	2,123.4	681.2	1,084.7	357.5	30.7	0.2	189.2	31.0	257.7	176.6
Mars	2,634.3	26.3	2,087.5	657.4	1,074.3	355.8	31.3	2.0	191.3	31.0	264.2	179.6
Prill	2,619.2	27.7	2,078.3	644.5	1,082.8	350.9	31.6	2.0	191.9	31.0	256.0	181.1
Maj	2,638.8	26.6	2,097.0	667.8	1,081.4	347.8	29.6	2.0	194.1	31.0	257.7	181.1
2012 Qershor	2,638.8	26.6	2,097.0	667.8	1,081.4	347.8	29.6	2.0	194.1	31.0	257.7	181.1

Burimi: BQK (2012)



Tabela 5.1. Depozitat në KTD-të - depozitat në euro

